

РЕСПУБЛИКА ТУРЦИЯ
ОФИС ПРЕМЬЕР-МИНИСТРА
УПРАВЛЕНИЕ ПО ДЕЛАМ РЕЛИГИИ
ПРАВЛЕНИЕ ВЫСШЕГО СОВЕТА РЕЛИГИОЗНЫХ ДЕЛ

ДВИЖЕНИЕ ЗЛОУПОТРЕБЛЕНИЯ РЕЛИГИЕЙ ФЕТО/ПДЙ

РЕШЕНИЯ ЧРЕЗВЫЧАЙНОГО РЕЛИГИОЗНОГО СОВЕТА





REPUBLIKA E TURQISË
KRYEMINISTRIA
KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE
KRYESIA E KËSHILLIT TË LARTË TË ÇËSHTJEVE FETARE

STRUKTURIMI PARALEL SHTETËROR
FETO/PDY
(NJË LËVIZJE KEQPËRDORUESE E ISLAMIT)

VENDIMET E KËSHILLIT KONSULTATIV FETAR TË
JASHTËZAKONSHËM



Botimet e Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë: 1399
Seria e librave profesionalë: 316

Përgatiti për botim
Kryesia e Këshillit të Lartë të Çështjeve Fetare

Titulli në origjinal

Dini İstismar Hareketi

Titulli në shqip

Strukturimi Paralel Shtetëror FETO/PDY

(Një lëvizje keqpërdoruese e Islamit)

Koordinimi

Drejtoria e Përgjithshme e Botimeve Fetare

Kjo vepër botohet në bazë të vendimit të
Kryesisë së Këshillit të Lartë të Çështjeve Fetare: 02.11.2017/62

ISBN: 978-975-19-6789-3
2017-06-Y-0003-1399

Certifikimi: 12931

Botimi i dytë • Ankara 2017

Shtypshkronja:
Yorum Matbaacılık
+90 312 395 21 12

© KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË

Kontakt me Drejtorinë e Përgjithshme të Botimeve
Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü
Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı
Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı No: 147/A
06800 Çankaya - ANKARA / TÜRKİYE
Tel.: +90 312 295 72 81 • Fax: +90 312 284 72 88
E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr

PASQYRA E LËNDËS

FJALIMET PËRSHËNDETËSE

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË TURQISË

RECEP TAYYIP ERDOĞAN..... 5

KRYETARI I PARLAMENTIT TË MADH KOMBËTAR TË TURQISË

İSMAİL KAHRAMAN..... 17

ZV. KRYEMINISTRI I REPUBLIKËS SË TURQISË

PROF. DR. NUMAN KURTULMUŞ..... 23

KRYETARI I KRYESISË SË ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË

PROF. DR. MEHMET GÖRMEZ..... 31

VENDIMET E KËSHILLIT..... 41



PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË TURQISË

RECEP TAYYİP ERDOĞAN

KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË
FJALIMI I HAPJES SË KËSHILLIT FETAR TË JASHTËZAKONSHËM TË
KONSULENCËS

(03 gusht 2016, ANKARA)

Bismillahirrahmanirrahim

I nderuar Kryetar i Parlamentit,

Miq të nderuar,

Vëllezër të nderuar,

Ju përshëndes me ndjenjat më të përzemërta, me dashuri dhe respekt.

Esselamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuh.

Uroj që Këshilli Konsultativ Fetar i Jashtëzakonshëm, i organizuar nga Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, të sjellë mirësi në vetvete.

Uroj të gjithë dijetarët, pedagogët dhe specialistët, të cilët me mendimet, vlerësimet dhe sugjerimet e veta, do të japin kontributin e tyre në Këshillin Konsultativ.

Falënderoj Kryesinë e Çështjeve Fetare të Turqisë, si një institucion që është në urdhër të popullit dhe në shërbim të fesë së qartë, Islamit, për organizimin e këtij këshilli.

Vëllezër të nderuar,

Siç dihet, shteti ynë, gjatë tri viteve të fundit është bërë skenë për zhvillime të rëndësishme.

Përpjekja e armatosur për puç, të cilën e përjetuam natën e 15 korrikut, përbën dimensionin më të përgjakshëm dhe guximtar të këtij procesi.

Veçoria e Organizatës Terroriste FETO, e cila është në qendër të këtyre zhvillimeve që na interesojnë së afërmi, si shtet dhe si popull, që i interesojnë të ardhmes sonë, është fakti se e ka prezantuar veten si një strukturë fetare, një xhemaat, një institucion që ka shërbyer në aspektin edukativ arsimor.

Në të vërtetë, kjo strukturë tradhtare ia ka dalë që, për 40 vjet, të jetojë brenda shoqërisë sonë si një fole kanceri, si një virus ngjites dhe rritja e saj e vazhdueshme është bërë e mundur në sja të identitetit që nxori në plan të parë këto vlera fetare.

Herë pas here dëgjonim kur thuhej se kjo nuk është një organizatë e armatosur. Sigurisht që ne u thoshim se po shprehim një konstatim të gabuar, se kjo është një organizatë që mund ta përdorë më së miri armën, sapo t'i vijë koha. Ndërsa kur na pyesnin se si mund të ndodhte kjo, u përgjigjeshim se organizata në fjalë është formësuar me elemente nga brenda Forcave të Armatosura, të cilët zotërojnë një karakter të tillë që, kur të vijë çasti, armët në Forcat e Armatosura të mund t'ia drejtojnë popullit. Nuk besonin, nuk arrinin ta besonin. Sigurisht, nuk kishim arritur në fazën kur mund t'i thoshim hapur këto fjalë. Ishin veçse biseda që bënim në mbledhjet tona private. Tani, kur kjo doli në shesh, miqtë në fjalë filluan të vijnë e të na thonë se kishim pasur të drejtë.



Pedagogë të nderuar, vëllezër të respektuar,

Populli ynë, cilado qoftë mënyra e sjelljes apo e jetesës, ndaj çdokujt që thotë “Allah”, që thotë “Pejgamber”, që plotëson adhurimet, që punon për mirësi dhe humanizëm, të paktën ndaj të gjithë atyre që shfaqen kështu, ashtu si ndaj çdo grupi, edhe ndaj kësaj strukture i është afruar me qëllim të mirë, i ka mbrojtur pjesëtarët e saj dhe i ka mbështetur ata.

Që nga periudha njëpartiake, në kohët kur ushtrohej presion mbi xhemaatet fetare, “me paranojën e konservatorizmit”, duke përdorur mundësitë e shtetit në një mënyrë krejt të gabuar, ashtu si çdo strukturë tjetër, edhe kjo e ka vijuar ekzistencën nën krahët e popullit tonë.

Të ndjerët Özal, Demirel, Ecevit, madje edhe ne, pavarësisht se ishim politikanë dhe burra shteti të pikëpamjeve të ndryshme, e mbështetëm me qëllim të mirë këtë strukturë.

Po flas hapur: edhe unë, pavarësisht se kishin mjaft aspekte që nuk i pranoja, duke menduar se bashkoheshim në disa pika me ta, i ndihmova ashtu siç ndihmova çdo shtresë tjetër.

Në kuadër të përpjekjes që të përfshij në qendër të gjitha shtresat e tjetërsuara, të cilat më parë ishin përjashtuar, shtresa këto të cilësuar si “qark dhe ambient” nga Şerif Mardin, bëra të mundur që të përfitonte edhe kjo shtresë.

Pavarësisht të gjitha hezitimeve tona mbi individët dhe kuadrit që gjendej në krye të kësaj organizate, u treguam tolerantë, për shkak të veprimtarive të tyre brenda dhe jashtë vendit, të cilat në dukje ishin të përqendruara në fushën e edukimit informal, ndihmesës dhe solidaritetit. Madje treguam tolerancë vetëm sepse thoshin “Allah”. Menduam se kishim një anë të përbashkët. Por, më besoni, te kjo strukturë, të cilën e pamë si një organizatë, si një prej rrugëve të ndryshme, por me destinacion të njëjtë, për një kohë të gjatë nuk pamë, nuk arritëm të shihnim se kishte synime krejt të ndryshme, se ishte mjet i hesapeve të fshehta, se kishte një mbulesë mbi vete.

Nëse e shohim në brendi, mund të them se, që prej vitit 2010, kam pasur shokë drejtues të nivelit të lartë, me të cilët kam ndarë këto konstatime. Sigurisht, duke filluar prej atij

viti, qëndrimi ynë ndryshoi. Rezervat tona në lidhje me këtë strukturë i shprehëm qartë sidomos pas vitit 2012.

Po ashtu, kam pasur dyshime të thella në lidhje me operacionet dhe proceset gjyqësore kundrejt kuadrove të Forcave të Armatosura të Turqisë, që u shpejtuan në këtë periudhë, dhe ua shpreha këto dyshime autoriteteve.

Nuk më bindnin arsyet dhe argumentet e fajësimeve a të arrestimeve të disa komandantëve që i njihja nga shumë afër dhe me të cilët kisha punuar për vite të tëra.

Në të njëjtën mënyrë, në sektorin publik dhe në atë privat, ndieja shqetësim të thellë nga përqendrimi dhe grumbullimi i fuqisë që përqipeshin të arrinin persona, të cilët ishin pjesëtarë të strukturës. Po ashtu, ndieja shqetësim edhe nga fakti se nuk u njihnin të drejtë jetese atyre që nuk ishin anëtarë të kësaj strukture.

Mirëpo në atë kohë e kisha të vështirë të shprehesh mbi këtë çështje, madje edhe të shokët e mi.

Përpjekja për puç, të cilën e përjetuam në vitin 2013, në datat 17-25 dhjetor, ishte lëvizja kur kjo strukturë tradhtarë shfaqti për herë të parë, me gjithë lakuriqësinë, fytyrën e vërtetë të saj. Madje, edhe këtë nuk arritëm ta shprehim ndaj shumë shokëve tanë. Kur çdo gjë ishte shumë e qartë, na u paraqit skema sikur në krye të kësaj organizate, nën çatinë e kësaj strukture, isha unë, më pas kryeministri, z. Binali, po ashtu, ministri i Energjisë, djali im, si dhe shumë biznesmenë që i dini e i njihni mjaft mirë edhe ju. Madje, edhe kur e tregonim këtë, mjaft shokë sërish nuk besonin. Na thoshin të mos flisnim ashtu, pasi këta nuk e bënin një veprim të tillë, ndërkohë që ata po hidhnin hapat e një operacioni shumë të rëndësishëm. E di se ka ende nga ata që nuk besojnë. Madje, për fat të keq, e di se ka edhe nga ata që shohin, por nuk arrijnë të dallojnë. Pas kësaj pike, pedagogë të nderuar, periudha e “dyshimit” mori fund. Filloi periudha e “luftës”.

Dua të theksoj këtu se, po të mos ishin masat parandaluese që morëm pas datës 17-25 dhjetor, në veçanti nëse nuk do të ishin masat parandaluese që morëm në gjyqësor, me shumë mundësi kjo tentativë për puç, do të shndërrohej në një kërcënim shumë të madh për ne, me pjesëmarrjen e policisë, gjyqësorit, burokracisë dhe përbërësve të tjerë, e jo



vetëm me pjesëmarrjen e një grupi të armatosur terrorist brenda Forcave të Armatosura. Pavarësisht të gjithave, ndiej pikëllim për faktin se nuk kam arritur të çjerr e të tregoj fytyrën e vërtetë të kësaj strukture tradhtare. Si rrjedhojë, e di se kemi gjykim për të dhënë, qoftë ndaj Zotit, qoftë ndaj popullit tonë. Na faltë si Zoti, ashtu edhe populli ynë.

Vëllezërit e mi të nderuar,

Dua të citoj shprehjen e Pejgamberit tonë: “Muslimani është personi që falënderon kur i ndodh një gjendje e gëzuar dhe që shpreh durim kur has në vështirësi.” Sepse kjo është e hairit dhe e mirë për të.

Data 15 korrik është njëra prej vështirësive më të mëdha që përjetuam si popull në historinë tonë të afërt.

Në saje të përpjekjes dhe kundërpërgjigjes që kemi treguar të gjithë së bashku, 79 milionë, me durim, guxim, maturi dhe vendosmëri, apo qoftë edhe falënderime, e eliminuam këtë vështirësi.

Pa dyshim, sado keq të ketë filluar nata e 15 korrikut, po aq i ndritshëm ka qenë mëngjesi i saj.

Tashmë ka ardhur koha që të kërkojmë llogari ndaj shkaktarëve të këtij sulmi tradhtar të drejtuar kundër shtetit dhe popullit tonë, po ashtu, të bëjmë edhe vetëgjykim.

Siç thotë një profesor shembëlltëror e keq: “Nuk del populli në rrugë, kjo punë nuk është ashtu siç mendohet.” Mirëpo ata nuk e paskan njohur këtë popull. Ata nuk qenkan bërë njësh me shpirtin e këtij populli. Unë, ama, i kam besuar popullit tim. Meqë i kam besuar popullit tim, e ftova atë në sheshe dhe në aeroporte. U thashë se do të isha mes tyre dhe jo se do të ikja në ishujt e Rodosit apo në vende të ndryshme. U thashë se do të isha dhe unë me ta. Dhe, elhamdulillah-lah, kur zbritëm në Aeroportin Ataturk të Stambollit, pashë se në platformë dhe para terminalit ishin mbledhur dhjetëra mijëra njerëz brenda tri orëve. Ky popull është popull i madh. Ky popull, elhamdulillah-lah, është një popull me besim vërtet të fortë. Nuk ka një shembull të tillë dhe historia e puçeve do ta shkruajë ndryshe këtë popull,

do ta tregojë ndryshe atë. Sepse nuk ka në vend tjetër një popull të tillë, që të qëndrojnë me flamur në dorë përballë atyre që u drejtuan me armë të tilla si F-16, F-4 apo tanke.

Disa e njesojnë këtë me organizatën terroriste PKK. Ç'lidhje ka? Organizata terroriste PKK nuk ka armë të tilla. Ndërsa FETO, pra Organizata Terroriste Fetullah, me këta F-16, F-4, tanke, topa dhe helikopterë, që u blenë me taksat e popullit, hodhi plumba dhe bomba mbi popullin e vet. Gjithsesi, sa herë që nevojitet, ata janë bashkë, bashkë me PYD, bashkë me PKK. Këtë gjë e pamë gjithmonë gjatë zgjedhjeve. E dimë se ata ishin bashkë në shtabet elektorale, por e dimë këtë veçanërisht nga veshjet e tyre. Erdhi një çast kur shihnim se, ndërsa na kthenin shpinën, ata qëndronin bashkë në shtabet elektorale. Këta i shihnim, i dinim dhe i njihnim. Dihej se ku, me kë dhe si do të vepronin. Ishin me shumë fytyra. Mirëpo, për pjesëtarët e kësaj strukture, tashmë nuk kishte asnjë shpjegim dhe përligjje që të vijonin të qëndronin atje, pavarësisht skandaleve ligjore në fushën e sigurisë të përjetuara gjatë datave 17-25 dhjetor, padrejtësive që dolën në shesh, kërcënimeve, njëmijë e një maskarallëqeve dhe barbarizmit që dëshmuam më 15 korrik.

Vëllezërit e mi,

Zoti ynë thotë në Kur'an se disfatistët, të cilët nuk janë të vetëdijshëm për bëmat e tyre, e quajnë veten "përmirësues, rregullues". Situata e këtyre është pikërisht kështu.

Nga kjo sallë po deklaroj se, pas këtij momenti, të gjithë ata që ua vënë veshin delireve të sharlatanit, të kryeterroristit që ndodhet në Pensilvani, do të thotë se kanë pranuar automatikisht atë që do t'u ndodhë.

Sigurisht, veçoria më e rëndësishme e kësaj strukture është që ta shndërrojë dyfytyrësinë, gënjeshtrenë, syefaqësinë, shëtitjen e vazhdueshme me maskë dhe pashpirtshmërinë, në karakter të pjesëtarëve të saj, nën emrin "tedbir (masë paraprake)" dhe "takije (fshehja e besimit përballë kundërshtarëve me qëllim që të parandalohen dëmet fetare, shpirtërore dhe botësore).

Ju kërkoi ndjesë, por kauzat devijuese të këtyre njerëzve, të cilët nëse i pështyni në fytyrë thonë "ra shi", nëse fyeni më të shenjtët e tyre heshtin, që nuk ndiejnë respekt, madje as ndaj privatësisë së familjeve të veta, janë shndërruar në fenë e tyre.



Mirëpo feja është e vetme dhe, besimtari që urdhëron ajo fe, e ka një profil.

Cila kauzë mund ta çojë pjesëtarin e saj, jo në neglizhim, por në mohim të urdhëresave fetare?

Fakti që një rrjet tradhtie përdor motivet fetare, a mund të mjaftojë që ta përligjë atë dhe ta tregojë të pafajshëm?

Më besoni, të gjithë devijuesit në botë janë të sinqertë në besimet e tyre.

Fakti që pjesëtarët e Organizatës Terroriste Fetullah janë të sinqertë në vartësinë e tyre ndaj kësaj strukture, që pranojnë çdo gjë që u thuhet pa gjykuar, nuk tregon se ata kanë të drejtë, por që janë në rrugë të gabuar nga pikëpamja e besimit.

Në Kur'an dhjetëra herë urdhërohemi që të përdorim mendjen. "A nuk mendoni aspak, e nuk arsyetoni?" Të gjitha këto urdhërohen për ne. Personi që nuk ia lë hipotekë mendjen dhe vullnetin Allahut, por një personi të vdekshëm, për më tepër dikujt që jeton në Amerikë, nëse nuk sheh pas dhe nuk gjykon, për atë person tashmë nuk ka mbetur gjë për të bërë. Meqë do të ringjallemi bashkë me ata që duam, atëherë të gjithë janë të lirë të ikin në rrugën e tyre.

Ne, për vite të tëra e kemi plotësuar këtë detyrë paralajmërimi. I përshkruam këta si një organizatë, tabani i së cilës është adhurim, e mesmja e saj tregti, ndërsa tavani i saj tradhti, pra shtresën e poshtme e cilësuam si adhurim, të mesmen si tregti, ndërsa të sipërmen si tradhti. Pas kësaj hezitoj të them se shtresa e poshtme, pra baza e kësaj organizate mund të cilësohet me adhurim. Përse? Sepse ende ka nga ata që ndiejnë shqetësim në plotësimin e kësaj detyre. Përse? Sepse nga njeriu, i cili ia ka hipotekuar mendjen, ndërgjegjen dhe çdo gjë të tij, një sharlalani si ky, ju kërkoi ndjesë por, atë që thashë pak më parë, si rrjedhojë e dispozitës së vendosur nga Zoti në formën "a nuk mendoni, nuk gjykoni?", unë e shoh me pikëpyetje, me dyshim. Tani e tutje, kjo periudhë, në çdo kuptim, është periudha e përpjekjes dhe e luftës, është periudha e gjykimin në çdo aspekt.

Nuk dëshiroj të vazhdoj më tutje pa e thënë edhe këtë: Ngaqë në brumin e kësaj strukture gjendet dyfytërsia, kemi hezitime serioze në lidhje me ata që thonë se janë penduar.

A janë penduar në të vërtetë? Nuk e them me idenë e një hakmarrjeje, por a u penduan vërtet? E kemi të vështirë të kuptojmë nëse janë brenda një hipokrizie, që u shndërrua në cilësinë dalluese të rrjetit të tradhtisë, brenda të cilit ata gjenden, apo jo. Pa dyshim që thelbësore është ajo që shprehet, por më falni, nuk do ta ulim mburojën ndaj këtyre lloj njerëzish. Sepse besimtari nuk e bën dy herë të njëjtin gabim.

Vëllezër të nderuar,

Vjedhja është e keqe. Por vjedhja më e madhe është të vjedhësh fenë, besimin, sinqeritetin dhe shpresën e njerëzve. Organizata Terroriste Fetullah, si rrjeti më i madh i vjedhjes në histori, ka vjedhur të shkuarën dhe të ardhmen e dhjetëra mijëra njerëzve.

Në histori kanë ekzistuar mjaft organizata të tilla. Hash'hashitët, të cilët u shkëputën nga medh'hebi ismailit dhe që u organizuan nga Hasan Sabbahu, gjë që e shpreh prej shumë vitesh, janë një ndër shembujt më të spikatur prej këtyre.

Hash'hashitët, njësoj si pjesa dërrmuese e pjesëtarëve të Organizatës Terroriste Fetullah, ishin persona të edukuar mirë, që kishin bërë karrierë, që kishin arritur ta fshihnin veten për vite të tëra, që kishin marrë si parim bindjen absolute ndaj liderëve të tyre. Kështu ishin Hash'hashitët.

Kjo situatë nuk është pengesë që të njëjtët persona, kur të vijë koha dhe të marrin urdhër nga liderët e tyre, të shndërrohen në komplotistë, vrasës dhe në kamikazë.

Tani disa thonë gjëra të ngjashme edhe për pjesëtarët e organizatës FETO.

Po, këta kanë dosje dhe ekzekutime të pazgjidhura (faili meçhul) dhe tani po dalin të gjitha. Çfarë tjetër mund të pritët në besimin tonë nga ai që hedh bomba me F-16, me F-4, duke synuar vdekjen e gjithë njerëzimit nëpërmjet vdekjes së një njeriu? Ja, u bombardua Parlamenti i Madh i Republikës së Turqisë. U bombardua Kompleksi i Presidencës. E kam shprehur në disa vende, një motrës sonë i është ndarë koka nga trupi dhe e gjetëm në çatinë e Qendrës së Kongreseve. A mund të flasim për një pandërgjegjshmëri të tillë? A ka vend kjo në fenë tonë? Kundrejt kujt e bënë këtë? Bombardon rastësisht mbi njerëzit që gjenden atje dhe nga ky bombardim bien 5 dëshmorë, 3 prej tyre nga e njëjta familje dhe



njëri prej tyre motra për të cilën ju fola. Mirëpo, pavarësisht kësaj, kur takoheni me familjet e tyre, asnjë nuk pyet se ç'ndodhi. Ende thonë “qofshin falë jetët tona në këtë udhë.” Kjo bëhet vetëm për një kauzë, për një besim, kjo nuk është një çështje kaq e lehtë. Kanë rënë 238 dëshmorë dhe kjo nuk është një ngjarje e zakonshme. Po ashtu, janë plagosur rreth 2200 të tjerë.

Ja, u telefonoj gjatë mbrëmjeve. Mbrëmjen e kaluar telefonova njërin prej tyre, në krahun e majtë të të cilit kishin mbetur 10 centimetra, pasi pjesa tjetër i ishte këputur. Flas për një vëlla nga Gümüshan. Unë mendoja se do të ishte i hidhëruar. Vura re se fliste me gëzim. Pyeti për shëndetin tim. Tha se i mjafton që po dëgjon zërin tim. Dhe e mbylli bisedën duke thënë se ka një nënë 88-vjeçare, e cila i kërkonte të fliste me mua. Edhe pse nuk mund të më shihte, dëshironte të paktën të dëgjonte zërin tim. Më kërkoi, pra, të flisja me nënën e tij, pasi ajo do të lumturohej shumë. Dhe unë fola me të në telefon. Aman, o Zot, sikur nuk i kishte humbur krahun i biri. Ajo më këshillon ende mua, më kuron psikologjikisht. Dhe më pyet: “Presidenti im, ti si je?”

Po ashtu, një koloneli i ishte bërë trupi shoshë nga plumbat. Kishte marrë 7 plumba, por edhe ai gëzon të njëjtin dinamizëm. Ai është një kolonel që tregoi aftësitë e tij në qendrën ushtarake Topçu në Stamboll, një kolonel që u mundua të ndalojë tanket. Shoh se edhe ai është në të njëjtën situatë. Më thotë: “Mos na mendoni ne, por dijeni se këta nuk kanë përfunduar, Presidenti im. Ka edhe më shumë nga këta brenda ushtrisë, mos t’ju mashtrojë kjo ndodhi.” Përsëri më këshillon të ruaj veten dhe, mendoni që ai ndodhet në këtë situatë. Elhamdulillah-lah që kemi një popull të tillë, që e hedh veten para tankeve, që u kundërvihet këtyre pa u lodhur. Me lejen e Allahut do t’i tejkalojmë këto vështirësi dhe shtetin tonë do ta udhëzojmë drejt një pike shumë më të mirë në këtë konkurrencë qytetërimi.

Ata që bëjnë sikur nuk shohin fytyrën gjakatare të kësaj strukture, fytyrën që vjen erë urrejtjeje dhe barbarizmi, që mendojnë ende se është strukturë edukative-arsimore dhe humanitare, që është shkollë dhe shërbim, këtyre njerëzve ose nuk u funksionon perceptimi, nuk u shohin sytë, ose me zemër janë në anën e tyre. Prandaj futëm në dorë të gjitha shkollat e kësaj organizate. Ishim në një situatë që duhet t’i shtinim në dorë dhe i kaluam ata në përdorimin e universiteteve që janë ekuivalent me ta.

Po ashtu, edhe në Forcat e Armatosura, siç e dini, i mbyllëm të gjitha gjimnazet ushtarake. Pas kësaj, të gjitha gjimnazet, gjimnazet profesionale dhe gjimnazet që janë ekuivalente me këto, kanë fituar mundësinë e hyrjes në shkollat ushtarake. Të gjithë mund të hyjnë. Dhe, nën çatinë e shkollave ushtarake, tani themeliam Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare. Bashkë me Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare shfuqizuar edhe akademitë ushtarake. Në vend të tyre (le të themi se këto ishin shkolla ajrore, detare dhe tokësore të nivelit universitar), duke hapur Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare në trajtën e një universiteti që jep arsim në nivel master, reformuar sistemin pikërisht në këtë mënyrë dhe sipas kësaj hodhëm edhe hapin tonë.

Sigurisht, bashkë me të gjitha këto, siç e dini, xhandarmërinë e lidhëm me Ministrinë e Brendshme dhe sistemin e xhandarmërisë e bëmë të njëjtë me atë të policisë. Tashmë, statuti i nëpunësit, skedimet, kjo apo ajo, të gjitha janë të lidhura me Ministrinë e Brendshme. Dje në mbrëmje hodhëm edhe hapat e fundit në lidhje me nënstrukturën e kësaj dhe inshallah, me ngarkime të reja në detyrë brenda 48 orëve, edhe xhandarmëria do të fillojë punimet e saj. Çdo vit kjo ndodhte në datën 30 gusht, tani e shfuqizuar 30 gushtin dhe tashmë filloi procesi i Forcave të Armatosura në formë të plotë.

Nga data 17-25 dhjetor, kishte nga ata që shqiptonin gjithmonë një fjali. Vinin miqtë, flisnim: “Aman, Kryeministri im, mos e prekni Gajretullahun” (një emër i përdorur shpesh nga Fetullah Gylen dhe që përdoret për të nga përkrahësit e tij). Edhe tani, në periudhën e Presidencës, gjithmonë ishte e njëjta shprehje.

Në të vërtetë, t’i konsiderosh ende si të pafajshëm këta vrasës, që vranë 238 të persona më 15 korrik, që plagosën 2197 të pafajshëm, kjo sigurisht që shkakton zemërimin e Allahut. Do ta shohim këtë.

Nëse errësojmë mendjen dhe zemrën e gjithë këtyre njerëzve, nëse legjitimojmë gjithë këta njerëz, kjo bëhet shkak për zemërimin e Allahut!

Të shprehësh dhembshuri ndaj mizorit, është padrejtësi për të shtypurin. Këtë duhet ta dimë.



Turqia ka nevojë që, duke u nisur nga kjo përvojë që përjetoi, ashtu si në çdo fushë, edhe në çështje e jetesës dhe të institucioneve fetare, të hetojë veten, të realizojë një riorganizim në vetvete.

Unë, për shkak të fjalimit të sotëm të Kryetarit të Kryesisë së Çështjeve Fetare, (ai gjithmonë mban fjalime të bukura), por sot, e falënderoj shumë për shkak të fjalimit të tij shumë më ndryshe, shumë më domethënës. Dhe them se, në veçanti Kryesia e Çështjeve Fetare, e cila ka një kuadër prej rreth 100 mijë personash, nuk duhet ta vijojë veprimtarinë në mënyrë të tërthortë. Ndërkaq, duhet të dimë edhe që, objektivi ynë nuk është vetëm Organizata Terroriste Fetullah, por është edhe organizata terroriste përçarëse PKK. Ja, siç e shihni, në Bingöl ranë dëshmorë 7 policë. Po ashtu, para kësaj ngjarjeje, 6 ushtarë ranë dëshmorë nga organizata terroriste përçarëse PKK. Përballë të gjitha këtyre duhet të vijojmë luftën në mënyrë të vendosur. Unë nuk besoj se motrat dhe vëllezërit kurd do ta mbështesin këtë organizatë terroriste. Ne në këtë shtet jemi vëllezër me të gjithë, me turqit, kurdit, arabët, lazët, çerkezët, romët, boshnjakët dhe shqiptarët. Shkurtimisht, me të gjithë. Mirëpo kush do i afrojë ata me njëri-tjetrin? Së pari, besoj se janë mendimtarët dhe, në veçanti, vëllezërit e mi imamë dhe muezinë.

Ja, pra, nëse atë mbrëmje, më 15 korrik, nuk do të ishin kënduar ezane dhe sala nga minaret, ne do të ishim privuar nga atmosfera shpirtërore. Ç'ndodhi me natyrën shpirtërore të popullit? U forcua. Siç e dini, disa u shqetësuan nga këta. Sepse ekzistojnë edhe këta, dhe përsëri do të jenë, por edhe ne do të vijojmë rrugën në formë të vendosur. Sepse ne kemi thënë: "Këta janë ezanet, shehadetet e të cilave janë themeli i fesë" dhe kështu kemi besuar, po kështu do të ecim në rrugën tonë. Ja, pra, kjo fatkeqësi është bërë një mundësi për ne. Duke vlerësuar në formën më të bukur përvojën 1400-vjeçare, duke i rihedhur një sy strukturës dhe trupit tonë, do të përjetojmë bashkërisht një proces, ku do të plotësojmë mangësitë tona, do të rregullojmë gabimet tona. Nëse nuk e bëjmë tani këtë, nesër do të vijojmë të angazhohemi me herezi të tilla. Këtë ia kemi borxh popullit tonë, që u hodh para tankeve, helikopterëve dhe avionëve, kur dëgjuan salatë që u lartësuan natën e 15 korrikut. Sa i nderuar është ky popull. Duke u dalë zot të gjitha njëjse, si materiale, ashtu edhe shpirtërore, jemi të detyruar që të bashkohemi poshtë flamurit të teuhidit dhe uahdetit përballë çdo lloj kërcënimi fetar, etnik dhe ideologjik, kërcënim që tregon shenjë e shndërrimit në një fole fitne dhe përçarjeje. Dhe këtë duhet ta arrijmë me sukses në këtë.

Besoj se Këshilli ynë konsultativ do të jetë një platformë, ku do të përmenden, meditohen, njëkohësisht ku do të diskutohen të gjitha këto çështje.

Unë ju falënderoj që tani për kontributin tuaj. Përgëzoj personat që kanë bërë përpjekje për organizimin e këshillit. Uroj mëshirë nga Allahu për të gjithë dëshmorët tanë, uroj durim për familjet e tyre. Përsëri uroj shërim për gazinjtë nga Zoti ynë. Allahu qoftë ndihmësi dhe ndihmëdhënësi ynë.

Ne do ta vijojmë rrugën me hapa të sigurt, me hapa të besueshëm. Por duhet të dimë edhe këtë: Perëndimi, edhe sa i përket këtij procesi, nuk ka qenë kurrë pranë nesh. Perëndimi ka qëndruar pranë puçistëve. Nuk ka qëndruar pranë qeverisë së këtij shteti, që iu kundërvu puçit. Ju i njihni mjaft mirë këta me shpjegimet në fermanet hyjnore. As ne nuk do t'u besojmë atyre. Një i parë i nderuar ka një shprehje të bukur. Ishte i sëmurë dhe vajta ta vizitoja. Tani ai gjendet në botën e amshueshme. Më tha: "Nëse ata kanë avionë, tanke dhe topa, edhe ne kemi Allahun". Po, edhe ne kemi Allahun. Pa dyshim që edhe ne kemi tanke dhe topa. Ashtu siç këta të poshtër ndodhen brenda Forcave të Armatosura, kemi edhe komandantë, oficerë dhe ushtarë që qëndrojnë përballë këtyre, që janë të ndershëm, atdhedashës dhe kombdashës. Kërkoj, pra, që dihet veçanërisht edhe kjo. Në këtë luftë, edhe këta dhanë provën më të bukur të kundërvënies ndaj tyre.

Përsëri ju shpreh falënderimet dhe respektin më të përzemërt! Mbetshi me shëndet! Allahu qoftë ndihmues dhe ndihmëdhënësi ndaj jush!



KRYETARI I PARLAMENTIT TË MADH KOMBËTAR TË TURQISË

İSMAİL KAHRAMAN

KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE

FJALIMI I HAPJES SË KËSHILLIT FETAR TË JASHTËZAKONSHËM TË
KONSULENCËS

(03 gusht 2016, ANKARA)

I nderuar Presidenti im,

Të nderuar të ftuar,

Anëtarë të Këshillit Konsultativ,

Ju përshëndes me respekt!

Më 15 korrik përjetuam një ditë të errët. Me dëshirën që të mos përballemi më kurrë me një fatkeqësi të tillë, së pari dua të shpreh urimin: Qofshin të shkuara për të gjithë ne!

Mendoj se ky këshill, i cili po organizohet nën këto kushte të jashtëzakonshme të shtetit tonë, do të jetë mjaft i dobishëm. Me këtë rast përgëzoj të nderuarin, Kryetarin e Kryesisë së Çështjeve Fetare, Prof. Dr. Mehmet Görmez dhe në personalitetin e tij të gjithë kolegët e tij të nderuar.

I uroj sukses dhe mbarësi në punë të gjithë personelit të Kryesisë së Çështjeve Fetare. Besoj se punimet që do të realizohen në kuadër të unitetit, solidaritetit dhe perspektivës së ardhshme përballë keqpërdorimit të Islamit me një konstatim mjaft të qëlluar nga ky këshill konsulence, që organizohet menjëherë pas kësaj tentative të përgjakshme për puç nga Organizata Terroriste Fetullah, do të jenë udhërrëfyese dhe shpresëdhënëse për të nesërmen tonë.

Presidenti im i nderuar,

Pas puçit që u përpoqën të realizojnë tradhtarët e atdheut, pjesëtarë të Organizatës Terroriste Fetullah, të veshur me uniformë ushtarake, duke keqpërdorur dhe shfrytëzuar Islamin, fenë tonë më të fundit dhe më të plotësuar, në mënyrë tinëzore tentuan t'i vënë thes në kokë popullit tonë. Me ndihmën dhe dhuntinë e Allahut u kthyem nga buza e një gremine të madhe. Kur kishte mbetur shumë pak nga rënia jonë në një pus të pafund dhe të errët, shteti ynë shpëtoi nga një fatkeqësi e madhe nëpërmjet guximit të lartë dhe besimit të Presidentit tonë të nderuar, Recep Tayyip Erdoğan, si dhe besimit e vullnetit të popullit tonë. Populli e mposhti puçin. Tregoi se pranoi demokracinë dhe puçi u pengua. Në këtë pengesë populli ynë u bë i tëri njësh. U bashkuan të gjitha organizatat e shoqërisë civile, në sheshe filluan radhët e demokracisë. Shtypi zuri krah pranë demokracisë. Bashkërisht korrëm një fitore historike përballë puçit dhe thirrja e Presidentit tonë: "Dilni nga shtëpitë tuaja e zbrisni në rrugë, mblidhuni nëpër sheshe, qëndroni përballë armiqve të popullit dhe atdheut!" u bë fillesa e çdo gjëje.

Parlamenti i Madh i Republikës së Turqisë, si përfaqësues i popullit, si vendpasqyrimi i vullnetit kombëtar, fitoi për së dyti titullin gazi. U mbledhëm që nga çasti kur nisi përpjekja për puç, zbardhëm ditën në Kuvend, u bëmë zëri i popullit tonë të nderuar, duke pasur të njëjtin shpirt e besim, pa dallime partiake, nën zhurmat e bombave dhe të shtënave të armëve. Pavarësisht se nuk ishte dita e seancës plenare, deputetët u mbledhën në Parlament. Të gjitha partitë që u gjendën aty natën e shtunë të 16 korrikut, dolën me një deklaratë të përbashkët, të firmosur prej tyre, ku shprehnin vartësinë ndaj demokracisë dhe shtetit ligjor dhe theksonin se nuk do t'u jepnin udhë puçeve.



Këta pjesëtarë ogurzinj të kësaj çete të urreyer dhe të shitur, këta tradhtarë të atdheut dhe të popullit, drejtuan ndaj kraharorit të popullit avionët, helikopterët dhe armët. Bombarduan zemrën e popullit, Parlamentin tonë, e gjuajtën atë. U bënë shkak për rënien dëshmor të vëllezërve tanë dhe të tyre, i plagosën ata. Populli, me gjoksin e tij u bë mburojë ndaj plumbave. Ashtu siç thoshte i ndjeri Ali Ulvi Beu: “Ndryshoja drejtimin mohimit, godite me gurë njësoj si përmytje vërshuese që shkumëzon. Qëndro si gazi (veteran), ose vdis e bjer dëshmor në këtë luftë.”.

Dhamë dëshmorë. Kërkojmë mëshirë për ta. Ngushëllime për popullin tonë, familjet e tyre dhe për të gjithë ne. Ata u bënë fqinj me të Dërguarin e Allahut. Urojmë shërim për gazinjët tanë dhe për të plagosurit, dëshirojmë jetë të gjatë për ta!

Nëse natën e 15 korrikut terroristët do të arrinin objektivat e tyre, të gjithë mund të përpëliteshim në gropa të errëta, brenda errësirave të privuara nga rrezet e diellit, në varfëri dhe gërmadhë, mund të ishim duke përjetuar pikëllimin e soditjes së atyre që dëshirojnë copëtimin e shtetit tonë, ndërkohë që po realizonin objektivat e tyre. Allahu i Lartmadhëruar qoftë i kënaqur nga bijtë e popullit tonë, të cilët e shndërruan atë natë dhe ata orë të mbushura me makth në një mëngjes të ndritur.

I nderuar Presidenti im,

U kthjem nga pragu i një fatkeqësie të madhe. Kemi përballë një tablo të bukur që ka paraqitur populli ynë në këtë fatkeqësi të madhe. Pas kësaj Turqia nuk do të jetë më shtet puçesh. Me lejen e Allahut nuk do të ekzistojë më ideja e përpjekjes për puç. Sepse ishte populli ai që u kundërvu, që nuk u përkul dhe nuk dëshiroi shembjen e një sistemi që ka pranuar dhe përvetësuar.

Tani duhet të kurojmë, në një kohë shumë të shkurtër, plagët sociale, politike, ekonomike, psikologjike dhe ushtarake, të cilat u shkaktuan nga një i çmendur, një tradhtar, që në mënyrë të paturpshme e konsideron veten si musliman, që ka ofruar në shërbim të imperializmit mendjen dhe mundin e tij. Do të tregojmë vullnet në këtë pikë. Besoj dhe shpresoj që me lejen e Allahut ky veprim nuk do të na marrë shumë kohë.

Personat që u përfshinë dhe u bënë pjesë në përpjekjen për puç të datës 15 korrik, të cilët u përpoqën të ndajnë kokën tonë nga trupi, harruan se ngadhënjyesi i vetëm është Allahu. Nuk ditën, nuk mundën të dinë se përballë planit të tyre, edhe Krijuesi e ka një plan. Si rezultat, prangat që deshën t'i vendosnin në këmbët e popullit tonë, u vendosën në këmbët e tyre. Në këtë sukses çdokush ka pjesën e tij. Ne, duke qëndruar në Parlamentin e Madh të Republikës së Turqisë, nëpunësit fetarë nëpër xhami, nëpër minare, policët nëpër rrugë, shtetasit duke treguar rezistencë në çdo vend, i dhamë botës një mësim demokracie.

Me thirrjet e ezaneve dhe salave që u lartësuan nga minaret e Kryesisë së Çështjeve Fetare, i gjithë populli u zgjua dhe u gjallërua. Kemi një popull të gatuar me brumë mjaft të fortë. I falënderuar qoftë Allahu! Pavarësisht çdo lloj ngatërrese dhe përçarjeje, nuk arritën të lëndojnë ndjenjën e vartësisë dhe lidhjes së popullit ndaj besimit, flamurit dhe atdheut.

I nderuar Presidenti im,

Të gjithë kemi përgjegjësi të mëdha; kemi një fe, së cilës duhet t'i dalim për zot, një popull, ndaj të cilit jemi të detyruar ta tregojmë në mënyrën më të drejtë fenë tonë. Jemi të detyruar ta transmetojmë në formën më të drejtë fenë tonë, pa qenë as mashtrues dhe as të mashtruar. Në mënyrë që ngjarjet që përjetuam të mos përsëriten më dhe që brezat e ardhshëm të jetojnë në siguri, mbi të gjithë ne bien shumë përgjegjësi. Duhet të plotësojmë përgjegjësinë tonë pa lënë asnjë hapësirë boshe. Në të kundërt, hapësirat që lëmë do të mbushen sërish nga disa sharlatanë dhe të tjerë që do të vetëquhen "imamë gjithësie" do të vijojnë shfrytëzimet dhe keqpërdorimet e tyre.

Siç e dini, urdhëresa e parë në Kur'an është në formën: "Lexo!" Po ashtu, Pejgamberi ynë (s.a.s.), si prijësi ynë i madh, na urdhëron duke thënë: "Dija është pasuria e humbur e besimtarit, të cilën mund ta marrë kudo që ta gjejë". Jemi njerëz që kemi si përgjegjësi të dimë dhe të njohim Krijuesin dhe urdhëresat e Tij, jemi të detyruar të pajisemi me informacion mbi këtë çështje. Nuk duhet të harrojmë se muslimani i paditur është një person që nisët pa dritë drejt një tuneli të errët. Një musliman, i cili me dijen e tij nuk arrin të shohë udhën përpara, është i prirë për t'u mashtruar. Sot, në shtetin tonë dhe në botë gjenden shumë muslimanë të mashtruar në këtë mënyrë.



Sigurisht që nuk duhet të mjaftohemi vetëm duke folur për të djeshmen, duhet të ndajmë me njëri-tjetrin mësimet e marra nga ajo që kemi përjetuar, në mënyrë që të njëjtat ngjarje të mos përsëriten nesër. Të gjithë ata që mbajnë anën e demokracisë, të vullnetit kombëtar, janë të detyruar të veprojnë me ndjenjën e një përgjegjësie të madhe, pa thënë “ti, unë, ai, kjo, ajo”. Njerëzit tanë të ndritur, liderët fetarë, shkrimtarët, artistët tanë duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që u bie mbi supë. Dhe, për të mos rënë sërish në kurthin që ramë nga rasti i FETO, natyrisht duhet që të nxjerrim mësim. Turqia nuk është qendra e rëndësës vetëm për botën Islame, jo vetëm për botën turke, por është për të gjithë botën. Jam i mendimit se, ashtu siç pa ne nuk mund të shkruhet e djeshmja e botës, po ashtu nuk mund të shkruhet as e nesërmja e saj. Për këtë arsye jemi të detyruar të jemi mirë, vigjilentë dhe të parapërgatitur. Në përputhje me këto kritere duhet ta përgatisim veten ndaj së ardhmes. Në debatet nëse parësore është sasia apo cilësia, çështja kryesore, nga e cila muslimanët mashtrohen, ka të bëjë me faktin se ata nuk duhet të neglizhojnë cilësinë. Duhet ta plotësojmë këtë mangësi. Pati një përpjekje për puç nga një grusht njerëzish, të cilët futën në dorë shtresën politike dhe atë të drejtësisë. Po të mos i kishim hapur sytë dhe të mos ishte përpjekja që dha më vete Presidenti ynë që nga viti 2010, këtë grusht të mjerësh do ta kishim në krye, ashtu si Partia e Rigjallërimit në Siri. Si rezultat, Turqia jonë sot do të ishte në pozitën e përçarjes dhe gjithë bota, bota islame, e gjithë bota që pret shpresë nga ne, do të mbetej pa krye dhe e pashpresë.

Erdhi për vizitë Kryetari i Parlamentit të Azerbajxhanit, njeriu i nderuar, profesor Asaf Hacıyev dhe na tha “Të shkuara”. Ishte një vizitë mbështetjeje. U përkul dhe e puthi tri herë flamurin tonë, e vendosi në kokë dhe tha: “Shpëtuam ne, jo ju, ne shpëtuam.” Ky është mentaliteti i botës, i gjeografisë përreth që ka lidhur shpresat me ne. Në këtë kuadër, ka deklarata të burrave të ndryshëm të shtetit, të shteteve, Allahu qoftë i kënaqur nga ata.

Kështu, shteti u shpëtua dhe bashkë me popullin tonë u shkrua një legjendë. Iu dha fund paralelizmit në shtetin tonë dhe inshallah nuk do t'i shohim më këto ditë.

Mos të harrojmë se gjeografia e Anadollit është shtëpia jonë dhe, të vendosim siguri në shtëpi, është detyra jonë. Vendosja e sigurisë vetëm me masat parandaluese ushtarake dhe policore nuk mjafton. Siguria sociale, politika fetare dhe siguria psikologjike janë kriteret mbi të cilat duhet të qëndrojmë fort. Kur lëmë pas dore përmasën sociale dhe psikologjike të sigurisë shohim se F-16, me të cilët lëvdohemi kur shohim se fluturojnë në qiell, hedhin

bomba mbi ne. Ashtu siç e shkuara jonë është e përbashkët, edhe e ardhmja jonë është po ashtu e përbashkët. Nuk mund të krijojmë një të ardhme për veten tonë duke vendosur protektorat mbi njëri-tjetrin, jashtë asaj që është legjitime. Muslimanët nuk mund ta ndërtojnë të ardhmen e tyre duke vendosur autoritet mbi njëri-tjetrin.

Ashtu si barbarizmi që paraqet DEASH-i në Irak, Siri dhe në shtetet e tjera të botës nuk miratohet në emër të Islamit, edhe terroristët, të cilët na bombarduan më 15 korrik, nuk i pranojmë si muslimanë. Sepse terrori dhe dhuna nuk mund të jetë gjuha e muslimanëve. Asnjë punë që nuk merr miratimin e popullit, nuk ka mundësi të jetë e suksesshme. Në të vërtetë, edhe kriminelët që e kishin humbur veten aq shumë sa të bombardonin Kompleksin e Presidencës dhe Parlamentin e Madh Kombëtar të Republikës së Turqisë, nuk kishin si synim të arrinin sukses. Synimi i vërtetë ishte të krijonin kaos dhe rrëmujë. Pra, synimi ishte të krijonin konflikt të brendshëm dhe një situatë të volitshme për përçarjen e Turqisë, veçse nuk arritën sukses në këtë. Ata nuk arritën të kenë sukses, por edhe për ne punimet sapo filluan. Ajo që duhet të bëjmë tani e tutje, në mënyrë që këto fole përçarjeje të mos rigjallërohen, është të përqendrohemi te zhvillimi dhe progresi material e shpirtëror, të mos e lëmë pas dore zhvillimin shpirtëror. Në mënyrë që e nesërmja të jetë më e sigurt dhe më e besueshme, duhet të edukojmë të rinj dhe breza që të jenë të lidhur me rrënjët e tyre shpirtërore. Synimi ynë është që, duke realizuar periudhën e artë, ta bëjmë Anadollin përsëri qendër të botës. Duhet të plotësojmë misionin e pritur nga ne.

Përpjekja për puç që përjetuam ka ngritur edhe perden që kishim para syve. Sa i përket kësaj, një shumicë dërrmuese është ndritur rishtazi dhe ka ardhur në vete. Dhe ka pasur njerëz që janë zgjuar nga gjumi i thellë. Inshallah ditët e nesërme do të jenë më të bukura.

Uroj që mbledhja e Këshillit të Konsulencës, vendimet dhe punimet e këshillit të jenë shkak për mirësi. Allahu na përçoftë në sukses, na mbajttë larg nga ditë të tilla të errëta. Allahu i Lartmadhëruar mos e poshtëroftë shtetin dhe popullin tonë! Allahu qoftë i kënaqur nga të gjithë ata që kanë bërë mund në parandalimin e kësaj errësire! Kërkoj nga Krijuesi mëshirë për dëshmorët tanë dhe uroj shërim të shpejtë për gazinjët dhe të plagosurit! Jetë të gjatë paçin!

Ju përhëndes të gjithëve me respekt dhe me dashuri! Paqja, mëshira dhe begatia e Allahut qofshin mbi ne!



ZV. KRYEMINISTËR I REPUBLIKËS SË TURQISË

PROF. DR. NUMAN KURTULMUŞ

KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË

FJALIMI I HAPJES SË KËSHILLIT FETAR TË JASHTËZAKONSHËM TË
KONSULENCËS

(03 gusht 2016, ANKARA)

I nderuar Presidenti im,

I nderuar Kryetar i Parlamentit të Madh të Republikës së Turqisë,

*I nderuar kryetar i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë, kryetarë të nderuar të
Kryesive të Çështjeve Fetare dhe Bashkësive Islame,*

Të nderuar profesorë,

*Ju përshëndes të gjithëve përzemërsisht. Paqja, mëshira, begatia, falja e Allahut qoftë
mbi të gjithë ne dhe mbi shtetin tonë!*

Uroj që Këshilli Fetar i Jashtëzakonshëm i Konsulencës, takim ky i organizuar pas
tentativës së 15 korrikut dhe, të jetë shkak për mirësi, në veçanti për faktin që këtu do të

ndahen mendimet, idetë, fetvatë në lidhje me strukturën fetare të organizatës terroriste FETO, në mënyrë që t'i përcillen publikut të Turqisë dhe botës Islame.

Në fillim të fjalëve të mia dua të falënderoj edhe një herë me vlerësim, falënderim dhe respekt Presidentin e nderuar, i cili natën e errët të 15 korrikut, në çastet më të vështira të natës, pa pasur as edhe hezitimin a shqetësimin më të vogël, doli përballë popullit, e ftoi atë në sheshe, në demokraci, kërkoi që të zotërojë të drejtat e veta dhe, me shembullin e një heroizmi e guximi të madh, u bë shkak që të kthehet historia e popullit tonë.

Në besimin tonë, si unë, ashtu edhe Presidenti i nderuar, e dimë se ç'është të thotë të lëvdosh dikë në prani të tij. Por këtë po e them për t'i dhënë ulla meriton. Nëse në atë fjalim, në ato fjalë, që ftonin popullin nëpër sheshe, do të kishte sadopak hezitim, sadopak shqetësim, populli ynë do ta ndiente këtë dhe nuk do të tregonte një guxim të tillë nëpër sheshe.

E dimë se me atë guxim, me atë besim, në vijim të fjalëve të Kryekomandantit, të Presidentit tonë, njerëzit që dolën nëpër sheshe shkruan mjaft legjenda.

I gjithë ky popull, çdonjëri prej nesh, ka dëgjuar legjendat e heroizmat e dëshmorëve të Çanakalësë, të Luftës Çlirimtare, të dëshmorëve në Malin Allahuekber, të dëshmorëve në të gjitha frontet, nga Tripoli lindor e deri në atë perëndimor. Por faktin se sa hero është ky popull, e pamë me sytë tanë natën e 15 korrikut. E vërtetua edhe një herë se sa popull i nderuar jemi, një popull që doli përballë tankeve, që u mundua të bëhet pengesë ndaj tankeve me makina, që vuri si mburojë gjokset përballë plumbave. Falënderimet qofshin për Allahun! Kërkojmë mëshirë për dëshmorët. Vendi i çdonjërit prej tyre qoftë i lartë!

Përveç kësaj, dua të shpreh falënderime edhe për mijëra gazinj, të cilët dolën atë natë nëpër sheshe me synimin që të bëhen dëshmorë dhe çdonjëri prej tyre ka fituar sevapin e dëshmorit. Po ashtu edhe miliona njerëzit që mbushën sheshet, çdonjëri prej tyre doli aty me të njëjtin mendim, me të njëjtin synim: "Nëse vdesim bëhemi dëshmorë, nëse mbetemi jemi gazinj." Nuk kemi dyshim se Zoti do t'u japë atyre shpërblime në të njëjtën mënyrë.



Mysafirë të nderuar;

Çështja që do të trajtohet në këtë këshill konsulence ka një rëndësi historike. Bota Islame, që nga harixhitët e deri te vetëflijuesit e Hasan Sabbahut, gjatë gjithë historisë ka parë mjaft tradhti, ka qenë dëshmitare e periudhave kur njerëz që besonin në devijime janë munduar të godasin me thikë botën Islame. Por e them pa e ekzagjeruar aspak, që nga ditët e para të Islamit e deri në çastet e para të historisë së renegatëve, kjo lëvizje është lëvizja më e organizuar, më e poshtër, më e ulët e renegatëve. Ja, pra, për këtë arsye duhet që kjo strukturë të dalë në pah me të gjitha fytyrat e saj.

Populli ynë nuk duhet, kurrsesi, të ketë dyshim mbi këtë çështje; qeveria dhe shteti ynë në lidhje me këtë çetë do të gjejë dhe do të nxjerrë çdo gjë, këdo që ka lidhje dhe është i infiltruar në të, të gjithë do t'i gjykojë, do t'ua nxjerrë për hundësh të gjithëve, duke filluar kryesisht nga "FETO". Kjo është detyra e shtetit dhe e qeverisë sonë. Por detyra që bie mbi rrethin dhe shtresën fetare, mbi dijetarët, me anë të Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë dhe Këshillit të Konsulencës, është të shkulum nga historia dhe bota ideore islame këto mendime tradhtarë, t'i hedhim në koshin e plehrave të historisë.

Me këtë rast shpresoj dhe uroj që mbledhja jonë e këtushme, këshilli ynë i konsulencës, që do të zgjasë dy ditë, të arrijë rezultate që bartin mirësi. Po ashtu, dua të shprehem edhe se kjo është një mbledhje e vonuar. Nëse ne, si autoritete fetare, si klerikë fetarë, të mund të kishim treguar, përpara se të shfaqeshin tradhtitë e kësaj strukture, se sa mendime devijuese kishte ajo, kështu do të mund të parandalonim që mijëra, dhjetëra mijëra të pafajshëm të hynin brenda kësaj organizate me besime devijuese. Tani e tutje duhet ta lëmë të shkuarën dhe pas kësaj të punojmë me shumë kujdes, me shumë vullnet, në mënyrë që këta dhe të ngjashmit me ta që kanë mendime të ngjashme, të shkulen nga ideatimi i Islamit dhe të hidhen në mbeturina.

I nderuar President,

Nëse më lejoni, edhe unë, me qëllim që të shërbejë si kontribut në diskutimet e këtushme, e konsideroj si detyrë të citoj disa gabime themelore, të cilat i shohim të rëndësishme në aspektin fetar të kësaj organizate, në veçanti gabimet ontologjike dhe epistemologjike.

Së pari, ne jemi robërit e Allahut dhe fjalitë ndaj nesh në Kur'an nisin me shprehjen: "Ja ejuhel'ledhine amenu" (O ju që besoni), ose "Ja ejuhe'n-nas" (O njerëz). Ne jemi besimtarë të kësaj feje që Ai shpall. Këta e kanë cenuar ontologjikisht këtë fushë dhe duke eliminuar idenë e barazisë mes muslimanëve dhe njerëzve, kanë përcaktuar si besimtar ata që janë brenda xhemaatit të tyre, që janë të lidhur me këtë bashkësi, ndërsa ata që janë jashtë tyre, i kanë përkufizuar si 'muel-lefe-i kulub' (persona ndaj të cilëve ka përpjekje për t'i afruar me Islamin), madje një pjesë të mirë të tyre edhe si renegatë. Kjo nuk është diçka e re. E dimë se ky grup vepron kështu prej vitesh dhe se duke shfuqizuar parimin e barazisë mes besimtarëve, shfuqizon njërin prej parimeve themelore të Islamit, parimin e barazisë.

Çështja e dytë është çështja e "transparencës". Është realiteti fakti se të gjitha besimet dhe doktrinat e Islamit, në veçanti pas periudhës së Mekës, po ashtu edhe urdhëresat e Pejgamberit, janë krejtësisht të hapura dhe transparente. Nga kjo pikëpamje, edhe elementi i përbashkët i dy institucioneve themelore të traditës islame së këtyre tokave ku jetojmë, pra elementi i përbashkët i 'medreseve dhe e dergaheve' është të jenë transparente dhe të hapura ndaj popullit. Ndërsa këta, bashkë me 'shtëpitë e dritës' që formuan, i hapën këto vende në formë të censuruar ndaj atyre që erdhën dhe ikën. E thënë ndryshe, duke shfuqizuar institucionin e transparencës, si njërin prej institucioneve më themelore të Islamit, i shndërruan këto në mesxhide sherri dhe përçarjeje. Ndërsa për vite të tëra, për fat të keq, në këndvështrimin e tyre kanë arritur t'i largojnë muslimanët nga tërësia e xhamisë. Me këtë veçori, me një model të mbyllur plotësisht nga brenda, të organizuar në vetvete, mund të themi se këta ishin gjoja një organizim fetar, që u shfaq si organizatë masonizmi. Tani i shohim më qartë fytyrat e tyre.

Shkatërrimi më i madh i tretë në aspektin ontologjik është mendimi i "i liderit të tyre si i pagabueshëm". Për ne është më se e qartë që askush nuk e ka atributin 'ismet' (i pagabueshëm), përveç pejgamberëve. Por këta, prej vitesh, madje me mjetet më të hapura, kanë trumbetuar idenë e liderit të tyre si i pagabueshëm, idenë se ai është larg nga çdo gabim. Duke bërë kështu, në të vërtetë kanë rënë në gabime shumë të mëdha. Në këtë mënyrë, mund të themi se u shndërruan në faraonë. Ndërsa dihet se, njëra prej veçorive më të rëndësishme të Faraonit, ishte fakti se ai besonte që ishte me pa të meta, se bëmat e tij ishin larg gjyqimit dhe ngulte këmbë për këtë.



Po ashtu, njëri prej devijimeve më të mëdha i tyre në aspektin ontologjik, njëra prej fushave më të rëndësishme që bie në kundërshtim me Islamin, është besimi devijues që trumbetuan, me pretendimin e dialogut ndërfetar, si një besim shumë devijues. Të gjithë e dimë se, këtij grupi, i cili prej vitesh mbron faktin se është i mjaftueshëm besimi në një Zot të vetëm, për fat të keq autoritetet fetare të Turqisë nuk kanë arritur t'i kundërpërgjigjen një herë e një kohë. Ideja se është e mjaftueshme të thuash “La ilahe il’lallah”, gjë që përbën thelbin e dialogut ndërfetar, nuk mund të pranohet në asnjë mënyrë. Herë pas here, në doktrinën e tyre kanë dhënë si shembull shkrimin në formën: “La ilahe il-lallah Ibrahim Halilullah”, i shkruar nga osmanët mbi portën Jafa. Ajo që synohet në atë shkrim është diçka tjetër dhe nuk mund të thuash se është i mjaftueshëm citimi i fjalës “la ilahe il-lallah”. Në këtë pikëpamje, duke parashtruar në fakt një fe të re, duke e bërë njësh fenë e fundit të Allahut me fetë e tjera, këta kanë arritur në devijime shumë të mëdha.

Devijimi i parë epistemologjik i kësaj organizate është t'i pranojnë dhe t'i perceptojnë muslimanët e tjerë ndryshe nga vetja. Të gjithë vijmë nga një besim, ku mendojmë se ehlu kible nuk mund të fajësohet me tekfirizëm, pra me mohim, se te cilido person ka vetëm një vepër ndër qindra vepra të tij, e cila nënkupton besimin tek ai person dhe ai do të konsiderohet si besimtar. Por, për fat të keq, këta, edhe nëse te një njeri gjenden 99 shenja që tregojnë se ai është besimtar, për sa kohë që nuk është njëri prej tyre, nuk e konsideruan pjesë e rrethit të tyre, as si individ që i përket ligjit islam, nuk e panë si vëlla besimtar në kuadër të ligjit islam.

Ndërsa devijimi i dytë më i madh i tyre në aspektin epistemologjik është fakti që kanë sjellë “takijen”, si një veçori shumë e rëndësishme që ndahet nga trupi i ehlu's-sunnetit dhe që është kusht i besimit. Mendoj se të gjithë ne e dimë që këta jo sot, jo dje, por prej dyzet vjetësh janë një strukturë, e cila ka ndjekur të njëjtën metodë. Ndërkohë që njëra prej veçorive themelore të ehlu's-sunnetit është të mos fshehësh cilësinë e besimtarit, përveç kushtit të shprehjes së besimit me gojë dhe të mos mohosh Allahun. Pra, takija është refuzuar dhe ndaluar rreptësisht, përveç rasteve kur bëhet fjalë për rrezikimin e jetës. Ndërsa te këta, takija është një ndër metodat më të rëndësishme, qoftë në qendër të besimit të tyre, ashtu edhe në qendër të organizimit të tyre.

Së fundi, në lidhje me devijimet e tyre epistemologjike dua të them se kjo organizatë, e cila si sistematikë mendimi prej vitesh është e mbushur me gabime dhe mangësi, për fat të keq, gabimin më të madh, që i tejkaloi të gjitha gabimet e tjera, e shprehu duke u shndërruar në një rrjet vrasar.

“Ai që vret një njeri është sikur ka vrarë të gjithë njerëzimin.” Ky është një ndër parimet dhe kriteret më të mirënjohura të Islamit. Këta të poshtër morën gjakun e 241 të pafajshmëve. FETO dhe të poshtrit nën urdhrin e tij, të verbuar ashtu si vetëflijesit e Hasan Sabbahut, vranë 241 njerëzit të pafajshëm, dhe thurën plane për të vrarë edhe shumë të tjerë. Allahu i prishi planet dhe kurthet e tyre. Dua që t’u rikujtoj dispozitën: “Gjaku, jeta, pasuria dhe nderi i muslimanit është haram (e ndaluar) për muslimanët e tjerë.” Ndërsa këta, për shkak se kanë vepruar në kundërshti me këtë urdhër dhe dispozitë fetare, në kundërshti me ajetet dhe hadithet që krijojnë këtë dispozitë, janë në një devijim më se të qartë.

Këta vrasës, këta kriminelë do të hidhen në grumbullin e errët të mbeturinave, si një organizatë dashakeqëse në historinë islame, si një organizatë e errët. Nuk ka dyshim se në historinë e popullit tonë janë bërë shkaktarë të një fatkeqësie të madhe dhe se kanë formuar plagë të thella në mendjen e këtij populli. Tani është koha që të gjithë së bashku të kurojmë këto plagë.

Duhet ta shprehim shumë hapur këtë. Nga njëra anë do t’i mjekojmë këto plagë, por kurrsesi nuk do të jemi të mëshirshëm dhe të tregojmë dhembshuri ndaj atyre që kanë lidhje me këtë krim. Sepse drejtësia vendoset jo duke treguar mëshirë dhe dhembshuri ndaj fajtorit, por ndaj të shtypurit dhe atij që i është kryer padrejtësi. Ndërkaq, askush që është i pafajshëm nuk duhet të shqetësohet, sepse nuk do të bëhet padrejtësi ndaj askujt që nuk ka lidhje me këta, nuk do të dhunohen këta persona. Detyra jonë si shtet dhe qeveri është t’i pastrojmë këta tërësisht nga shteti në kuadër të parimit të drejtësisë, të pastrojmë institucionet shtetërore. Ndërsa detyra juaj si rreth fetar, si institucion i Kryesisë së Çështjeve Fetare dhe detyra e dijetarëve të Islamit në Turqi është t’i dënojnë në historinë e ideimit dhe të mendimit islam këta njerëz, t’i shkulin dhe t’i heqin plotësisht nga zemra dhe mendja e popullit. Unë besoj se ky këshill konsulence do ta realizojë një detyrë të tillë.

Në fund dua të falënderoj edhe një herë Presidentin e nderuar, për shkak të guximit dhe vendosmërisë që pati për të ndriçuar mëngjesin e asaj nate të errët, guximin e popullit



tonë, largpamësinë e tyre dhe shpirtin e përpjekjes, punët plot vullnet të organizatave të shoqërisë civile, të partive politike dhe, në veçanti, të medias. Po ashtu, e ndiej si borxh të falënderoj personelin e Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë, të cilët atë natë u bënë shkak për këndimin e salave nëpër minare, që njerëzit t'i dalin zot demokracisë, atdheut, flamurit, popullit dhe besimit nëpër sheshe, me besim dhe zemër të fortë.

Allahu qoftë i kënaqur nga të gjithë ata që kanë dhënë kontribut në organizimin e këtij këshilli! Allahu mos mundësoftë që populli ynë të përjetojë më ditë të tilla të errëta, periudha të tilla të errëta dhe inshallah e ardhmja jonë qoftë e ndritur!

Ju përshëndes të gjithëve me dashuri dhe respekt!



KRYETARI I KRYESISË SË ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË

PROF. DR. MEHMET GÖRMEZ

FJALIM HAPJEJE NË KËSHILLIN FETAR TË JASHTËZAKONSHËM TË KONSULENCËS“

“Përpjekja për puç më 15 korrik dhe bashkimi kundër keqpërdorimit të fesë Islame, solidariteti dhe perspektiva e së ardhmes”

(03-04 gusht 2016, ANKARA)

Bismillahirrahmanirrahim

Falënderime të pafund qofshin për Krijuesin e Madhëruar, që na nderoi me mirësinë e Islamit dhe që, krahas Librit e Sunnetit, na dhuroi mendjen, zemrën dhe gjykimin e qartë, që na dha mundësinë të përdorim lirisht mendjen dhe vullnetin tonë, të dallojmë të drejtën nga e gabuara.

Salate dhe selame pafund për Pejgamberin tonë të dashur, Hz. Muhammed Mustafain (s.a.s.), i cili e shpalli Librin me urtësi dhe e shndërroi atë urtësi në praktikë të jetës!

I nderuar Presidenti im,

I nderuar kryetar i Parlamentit të Madh të Republikës së Turqisë,

Të nderuar anëtarë të Këshillit Fetar të Konsulencës,

Profesorë të nderuar,

Anëtarë të nderuar të medias,

Zonja dhe zotërinj,

Fillimisht dua t'ju përshëndes me dashuri dhe respekt. Paqja, mëshira dhe begatia e Allahut qoftë mbi ju.

I nderuar President,

Në emrin tim, në emër të anëtarëve të Këshillit Fetar të Konsulencës dhe të pjesëmarrësve, shpreh falënderimet e mia më të përzemërta për pjesëmarrjen tuaj në Këshillin Fetar të Jashtëzakonshëm të Konsulencës.

Prej tani kërkoj dhe i lutem Allahut që Këshilli i Jashtëzakonshëm i Konsulencës, i emërtuar “Bashkimi Kundër Keqërdorimit të fesë Islame, Solidariteti dhe Perspektiva e së Ardhmes” të lindë rezultate dobiprurëse dhe shpreh falënderimet në emër të Kryesisë për të gjithë pjesëmarrësit.

Presidenti ynë i nderuar, anëtarë të nderuar të Këshillit të Konsulencës,

Fillimisht dëshiroj të kërkoj nga Allahu mëshirë për dëshmorët tanë të nderuar, të cilët arritën në nivelin e të qenit dëshmorë në këtë natë të exhelit, në datën 15 korrik. Të gjendur përballë një çete tradhtare, e vendosur për errësimin e gjithë horizontit të atdheut tonë, e verbuar për qëllimet e veta, këta dëshmorë, bashkë me lartësimin e thirrjeve të salave, njësoj si në ditët e Luftës së Çlirimit, i dhanë përgjigje të menjëhershme ftesës për të ruajtur nderin dhe identitetin e popullit, pa hezitur qoftë edhe për një çast. Drita e këtyre dëshmorëve ka ndriçuar edhe një herë horizontin e popullit tonë.

Vëllezërit e motrat tona, që arritën në nivelin e të qenit gazinj, janë kurorë për popullin dhe ummetin musliman. I lutem Allahut të Madhëruar që t'u japë shërim sa më të shpejtë gazinjve tanë, i përshëndes ata me mirënjohjen dhe respektin e popullit tonë!



Dua të shpreh lumturinë e të qenit pjesëtar i një populli fisnik, i cili me qëndrimin guximtar dhe të qartë ndaj përpjekjes tradhtare dhe të përgjakshme të puçit, u bë shembull për të gjithë botën; që i doli zot atdheut, vullnetit kombëtar dhe rregullit e sistemit ligjor.

Që në çastet e para të tmerit të natës së 15 korrikut, me qëllim që të mbahet e gjallë ana shpirtërore e popullit tonë të vyer përballë puçistëve dhe rrjeteve tradhtare, përgëzoj nga zemra të gjithë vëllezërit e mi vullnetarë fetarë, që nga myftinjtë e deri tek imamët, nga muezinët e deri te mësuesit e Kur'anit, të cilët përçuan te populli ynë xhamitë, minaret, salatë dhe ezanet. Falënderoj Allahun, i cili prej puçeve që i detyruan ezanet të heshtin, na dhuroi sala që i detyrojnë puçet të heshtin.

I nderuar President, të nderuar anëtarë të Këshillit të Konsulencës,

Si Kryesi organizojmë për herë të parë një Këshill të Jashtëzakonshëm të Konsulencës, me një nen të vetëm në rendin ditor. Sepse ata që, nën emrin e fesë, për 40 vjet mbjellin farat e fitnes dhe të përçarjes në këto toka, bashkë me përpjekjen për puç, kanë shkaktuar një dëm shumë të madh, jo vetëm ndaj shtetit dhe popullit tonë, por edhe ndaj fesë së qartë, Islamit.

Ky rrjet tradhtar nuk ka organizuar komplot vetëm ndaj popullit, por edhe ndaj besimit, sigurisë, mëshirës, dhembshurisë, nderit dhe urtësisë, pra, ndaj të gjitha shenjave dalluese dhe të vyera të fesë e të qytetërimit tonë, të trashëgimisë e dijes, të diturisë, marifetit dhe urtësisë së ummetit, ndaj ndihmës dhe solidaritetit, duke e shndërruar fenë tonë dhe të qenit fetar në një urrejtje që mund t'i shitet armikut veçse me një qindarkë, si në aspekt të të qenit bij të këtij populli, ashtu edhe nga pikëpamja e njerëzimit. Çka është më dërrmuese, ka të bëjë me faktin se kjo organizatë e prezantoi sektin e saj ndaj klientëve të vyer në bursat e politikës globale, duke e përkufizuar si "Islami i moderuar, muslimanizmi protestant, dialogu ndërfaqet, toleranca, muslimani që bën kompromise", por me tradhtinë që paraqitën në natën e 15 korrikut, kur bombarduan Parlamentin tonë, qytetet tona, rrugët tona, duke nisur një komplot ndaj atdheut tonë të nderuar, Turqisë sonë të begatë dhe popullit tonë, nuk janë shmangur nga tmerri i dukshëm i DEASH-it, që përleu me gjak Irakun dhe Sirinë dhe nuk ndiejnë aspak turp. Kjo skenë vrastare dhe tmerruese, duke bombarduar qytetet e popullin me armët dhe teknologjitë e po këtij populli, nuk u mjaftua

vetëm me shkatërrimin e ekzistencës sonë materiale, por goditi edhe vlerat dhe shenjat më themelore të fesë sonë, ndjenjën e solidaritetit dhe të besimit të popullit tonë.

Presidenti im i nderuar, anëtarë të nderuar të Këshillit të Konsulencës,

Jemi në një pikëllim të thellë, për shkak se e kemi perceptuar me mjaft vonesë urtësinë që paralajmërohet në Librin tonë nga Allahu, kur thotë: “Kini kujdes! Ata mashtrues nuk duhet t’ju mashtrojnë ju me Allahun!”, duke na vënë përpara një sprove të rëndë, si shtet, por edhe si popull, si rreth i Kryesisë dhe i Fakulteteve të Teologjisë.

Sepse për shumë vite janë shfaqur sikur janë në anë të së drejtës, duke u mbuluar me veshjen e himmetit (ndihmës), janë paraqitur si pjesëtarë të pafajshëm të popullit, duke i fshehur ambiciet e vërteta pas shërbimit ndaj Zotit, të vërtetës dhe të popullit, por natën e 15 korrikut u shfaqën si një shkatërrim dhe sulm i pafre ndaj çdo gjeje që kemi në dorë, në emër të popullit, qyteteve dhe qytetërimit.

Janë përpjekur të vrasin popullin, si një barbarizëm i zgjidhur nga zinxhiri i tij. Me modesti të shtirur dhe fjalë të buta, me lot dhe gjoja ligjërata e këshilla të rreme, kanë shndërruar në mjet për të arritur synimet e tyre çdo shpresë dhe ndjenjë malli; ata që kanë përfutur nga bijtë e popullit i kanë pajisur me synime të fshehta, bindje absolute dhe një infiltrim tinëzar.

Ky rrjet robotësh të bindur ndaj urdhrave në dukje me karakter të butë, e ka mashtruar popullin tonë me Allahun, Pejgamberin dhe sahabet e tij. Për synimet dhe qëllimet e tyre kanë përdorur si mjet ajetet e Allahut, hadithet e Rasulullahut, trashëgiminë e dijes së dijetarëve të urtësisë dhe të irfanit, të gjitha vlerat e këtyre tokave, duke filluar kryesisht nga Mevlana dhe Junus Emre.

Një kalë Troje, i cili kur para nesh imitonte xhemaatin fetar, duke keqpërdorur fenë Islame, formimin e xhemaateve, aktivitetet e humanizmit, jo vetëm që ka përgatitur fundin e tyre të tmerrshëm, por ka mashtruar popullin tonë, gjithë gjeografinë e shtypur të muslimanëve të ummetit të Muhammedit dhe të gjithë njerëzimin. Duke ofruar në dukje shërbim ndaj së mirës dhe ndihmë ndaj njerëzve, kanë përdorur mundësi dhe pasuri të mëdha për shërbim ndaj forcave përçarëse.



Ky mashtrim jo vetëm nuk është kufizuar vetëm me shkatërrimin e popullit tonë, por edhe ka kanalizuar në vende të gabuara qytetërimin e Maveraunnehrit në Azi, i cili shpëtoi nga hegjemonia mizore, mendjen dhe mendimtarinë islame, i cili do të rigjallërohet përsëri në qendrat e tyre. Po ashtu, ka marrë në dorëzim dhe nënshtrim edhe mendjet muslimane, që do të shfaqen në periudhat post-koloniste në kontinentin e shtypur të Afrikës.

1 nderuar President, të nderuar anëtarë të Këshillit të Konsulencës!

Pjesëtarët e kësaj organizate terroriste, krahas marrëzisë dhe barbarizmit që shfaqën natën e 15 korrikut, treguan se fetarizmi i atyre që nuk mendojnë dhe që nuk gjykojnë, i atyre që i kanë dhënë dikujt tjetër me qira mendjen e tij, mund të shtyjë drejt fatkeqësisë jo vetëm ata, por edhe një popull të tërë. Dhe përsëri treguan që, pavarësisht se janë mbledhur nën çadrën e fesë, ata që tentojnë të përparojnë me hilet e politikës, nuk e kanë problem ta shndërrojnë fenë dhe moralin e tyre në një hile dhe dredhi.

Feja islame merr për bazë përcaktimin e fesë posaçërisht për Allahun dhe kryerjen e adhurimit posaçërisht për të, pa njohur zota të tjerë, duke e shprehur shërbimin ndaj njerëzimit në përputhje me pëlqimin e tij. Feja islame nuk pranon një autoritet, strukturë dhe udhërrëfyes tjetër të pafajshëm dhe të padiskutueshëm përveç Hz. Pejgamberit.

Askush dhe asnjë strukturë nuk mund ta shohë veten si përfaqësues të fesë Islame dhe nuk mund t'i ftojë njerëzit në bindje e vartësi absolute ndaj tij. Udhëzimi fetar është vetëm një pjesë e procesit edukativ-arsimor në aspektin e dijes e të moralit dhe nuk mund të ketë në vetvete asnjë privilegj tjetër.

Në fenë islame, vartësia absolute është mbi parimet, korniza e të cilave është përkufizuar nga Kur'ani dhe Sunneti. Ndërkohë që morali është vlera më themelore e fesë sonë dhe Pejgamberi ynë i dashur ka urdhëruar: "Unë u dërgova me qëllim që të plotësoj moralin e bukur". Por, kjo organizatë është orientuar drejt metodave të bazuara në imoralitet, siç është fshehja e vetvetes, duke u dukur ndryshe nga ç'janë, duke u sjellë me dy fytyra, duke folur me dy gjuhë, duke kryer haramin si domosdoshmëri e taktikës, duke përdorur emra të koduar, duke jetuar në një vend me besim tjetër, duke gënjyer, duke kryer aktivitete përgjuese, duke cenuar privatësinë, duke kërcënuar dhe duke ngritur kurthe.

Sjellje të tilla nuk kanë asnjë lidhje me Islamin. Sjellje të tilla nuk mund të komentohen as me parimin “Besimtari është një person, nga i cili të tjerët janë të sigurt.” Fakti që të gjitha këto bëhen nën emrin e lëvizjes së vullnetarëve të arsimit të themeluar në dashuri, tolerancë dhe afritet, tregon se ky është një mashtrim i madh.

Kjo organizatë është përpjekur të rekrutojë bijtë e popullit, të cilët i përfshinë në rrjedhën e tyre, duke zhdukur lidhjet familjare dhe duke ndërhyrë më pas në identitetin e tyre fetar (ummet) e kombëtar. Islami nuk lejon kurrë që në ndonjë vend a për ndonjë arsye, të formohen karaktere njerëzish dyfytirësh, me dy gjuhë, të huajëzuar ndaj vetes, pa karakter dhe pa identitet.

I nderuar President, të nderuar të ftuar,

Një gjynah tjetër i kësaj strukture, po aq i rëndë sa këta që përmendëm, është fakti që, ndërsa në Perëndim lartësohet dallga dhe identiteti i islamofobisë, ndërsa karikaturizohet imazhi i muslimanit, duke e shejtanizuar, këta, në vend që të dalin kundër kësaj dhe të synojnë lartësimin e nderit të Islamit, duke përdorur si mbulesë tolerancën dhe dialogun ndër fetar, janë munduar që të duken të ëmbël, duke thënë: “Ne kemi Islamin që do t’ju pëlqejë.”

Parimet e përgjithshme të marrëdhënieve të feve të tjera me Islamin janë përcaktuar në kuadër të Kur’anit dhe Sunnetit, duke ardhur deri në ditët e sotme nëpërmjet praktikash e modelesh që kanë shoqëruar gjithë historinë. Thelbësore është të jetosh bashkë me pjesëtarët e fesë të pranuar si Ehlul’s-Sunnet pa lënduar liritë e tyre fetare. Përveç kësaj, në çdo punë që do të jetë e dobishme për njerëzimin, ekziston mundësia e solidaritetit dhe ndihmesës në një pikë të përbashkët.

Mirëpo, nuk mund të pranohet përpjekja për të formuar unitet në teologjinë fetare, ose në kulturën fetare të përbashkët, nën emrin e dialogut. Për më tepër, nuk mund të formohet një marrëdhënie duke u treguar indiferent ndaj profetësisë së Hz. Muhamedit dhe duke copëtuar fjalën e teuhidit. Nuk është e mundur të qortohet një qëndrim i tillë në aspektin fetar. Të qenit besimtar i Islamit realizohet vetëm me besimin dhe miratimin tërësisht të fjalës së teuhidit.



I nderuar President, të nderuar anëtarë të Këshillit të Konsulencës,

Të japësh mësim mbi Kur'anin dhe Sunnetin, të tregosh parimet themelore dhe moralin ndaj besimtarëve e njerëzve, pa dyshim që është një ndër aktivitetet e shpalljes së Islamit. Mirëpo, ta shndërrosh këtë aktivitet në një rrjet force dhe interesi, të formosh nga këtu një strukturë botërore, politike dhe tregtare, ta bësh atë të hapur ndaj çdolloj marrëdhënieje të pistë, kjo nuk përputhet me parimet universale të Islamit. Të përfitosh interes në emër të fesë Islame dhe të krijosh autoritet, nuk ka një bazë fetare të pranueshme. Po ashtu, të mbash një qëndrim kundrejt këtyre strukturave është një përgjegjësi si morale, ashtu edhe islame.

Në aktivitetin e thirrjes në Islam dhe shpalljes, thirrja bëhet në emër të Allahut dhe Hz. Pejgamberit. Nuk mund të bëhet thirrje ndaj personave duke përdorur emrin e Allahut. Të ftosh robërit në robërim duke i mashtruar me Allahun, është mizoria më e madhe. Askush nuk mund t'ia dorëzojë mendjen, vullnetin dhe personalitetin dikujt tjetër. Nuk mund të ketë bindje ndaj krijesës në çështjen e rebelimit ndaj Krijuesit.

Strukturat e formuara në emër të fesë, në emër të Allahut, duke shfrytëzuar dhe keqpërdorur ndjenjat shpirtërore të njerëzve, shkojnë tërësisht në kundërshtim me Islamin. Struktura të tilla nuk kanë gjetur përkrahje në shoqëritë islame.

I nderuar President, të nderuar anëtarë të Këshillit të Konsulencës,

Organizatën terroriste FETO nuk mund ta shohim si fetare. Kjo për shkak se, prej shumë vitesh ekzistence, kjo organizatë, për qëllimet e veta, ka konsideruar si të lejueshme çdo metodë, ka abuzuar me fenë dhe ndjenjat njerëzore, ka grabitur me këto ndjenja zekatin, sadakanë, ndihmesën dhe fëmijët e popullit tonë, ka vjedhur vlerat dhe konceptet themelore të fesë sonë, ka përfutur potencial njerëzor dhe mundësi nëpërmjet çdo lloj qëndrimi dhe sjelljeje antiislame, ka përdorur përçarje, gënjeshtër dhe dredhi, është infiltruar në të gjitha strukturat e shtetit, duke u përpjekur të marrë nën hipotekë të ardhmen e popullit, por që, me tentativën e fundit për puç, u kapën duke kryer një akt kriminal nga populli. Po ashtu, është e pamundur që liderin e kësaj organizate ta pranojmë si dijetar të Islamit dhe si një lider fetar. Ky person, lider i kësaj organizate, i përkufizuar si imam dhe që vetëquhet si imam i gjithësisë, duhet të trajtohet në kuadër të dispozitës "Ai që vret një njeri, ka vrarë

të gjithë njerëzimin.” Një organizatë që bombardon brenda një nate një popull të tërë, që vret njerëz të pafajshëm, nuk mund të ketë marrëdhënie as me Islamin, as me njerëzimin.

I nderuar President, të nderuar anëtarë të Këshillit të Konsulencës,

Të bashkojmë eksperiencën e teologjisë në shtetin tonë dhe të Kryesisë, të nxjerrim mësim nga kjo ngjarje e dhimbshme, të marrim masat e nevojshme përballë kësaj strukture dhe të ngjashmeve që keqpërdorin fenë, të konstatojmë mangësitë ekzistente, duke filluar kryesisht nga rregullimet ligjore në fushën e shërbimeve fetare, arsimit dhe edukimit fetar dhe, sipas kësaj, të përcaktojmë hapat që do të hedhim, të bëjmë atë që duhet si rreth i teologjisë dhe i Kryesisë së Çështjeve Fetare, të rishikojmë nga fillimi mekanizmat e edukimit të njeriut, të mundësojmë ofrimin e një edukimi të shëndetshëm fetar ndaj shoqërisë, të nisim punimet e nevojshme për veprimin sipas parimeve universale të Islamit.

Ndërkaq dua të them se heshtja fetare dhe akademike përballë kësaj organizate, që pretendoi të fusë në dorë të gjithë Turqinë, nuk ka një shpjegim. Sa i përket kësaj çështjeje, qoftë rishikimi i kuadrit të Kryesisë së Çështjeve Fetare, qoftë rishikimi i Fakulteteve të Teologjisë, është një punë emergjente. Nga ana tjetër, si Kryesi, në lidhje me këtë organizatë terroriste që ia ka kushtuar veten keqpërdorimit të fesë islame dhe përfundimit të së ardhmes së këtij populli, është domosdoshmëri të bëjmë rregullimet dhe hetimet e nevojshme.

I nderuar President, të nderuar mysafirë,

Njëri prej kriterëve më të rëndësishme është të shohim dhe të kuptojmë madhësinë e nihilizmit ku do të shtyhen të rinjtë tanë në çështjen e fesë dhe të anës shpirtërore, si rezultat i zhvillimeve traumatike qoftë në mësimin e fesë dhe të mbështetjes në shërbimet dobiprurëse, qoftë nëse këta të rinj janë të distancuar ndaj fesë dhe anës shpirtërore, madje janë edhe kundërshtarë.

Në supet tona është ngarkuar si një përgjegjësi hyjnore eliminimi i potencialit të futjes në depresion së të rinjve dhe i rrugëzgjdhjes së këtij sulmi tradhtar, që nuk shmanget nga ndotja e fesë islame dhe anës shpirtërore. Tani e tutje si do t’u besojnë të rinjtë njerëzve që japin këshilla fetare ndaj tyre? Përse dhe si do të besojnë këta të rinj në anaforën e



pikëllimit dhe të mungesës së shpresës, si do t'i mbrojmë ata nga nihilizmi i mundshëm, si do t'i bindim se ekziston një thirrje e Islamit për paqe, drejtësi, vëllazëri dhe moral të lartë? Me cilin besim, besueshmëri dhe entuziazëm do të mund t'i ruajmë nga ky lëmsh të rinjtë?

Duke i shpëtuar këta të rinj nga depresioni, pikëllimi dhe vorbulla e nihilizmit, një udhërrëfyes për ne do të jenë vendimet e Këshillit Fetar të Konsulencës që do të realizojmë në rrugën e përcimit të të vërtetat e larta të Islamit.

Presidenti im i nderuar, të nderuar miq,

Pas reagimeve që patëm nga gjaknxehtësia e atyre që përjetuam, tani erdhi koha të mendojmë me gjakftohtësi. Me qëllim që procesi që kemi përpara të mos shndërrohet në një fitne të pazgjidshme, kemi nevojë për gjykim të shëndoshë dhe mendje të pastër e të qetë dhe kjo nuk ka nevojë për komentim. Ky rebelim fisnik i popullit do të marrë vendin e tij në histori nëse kurorëzohet me një drejtësi të lartë. Ashtu siç e theksonin shpeshherë të parët tanë, mund ta superojmë këtë proces jo me hakmarrje, por me drejtësi. Besoj se me forcën e konsulencës dhe të meditimit, Këshilli i Konsulencës do të na falë shpresë, dëshirën për të ndjekur rrugën e mesme, largpamësi dhe drejtësi.

Dua të shpreh besimin se të nesërmet tona do të jenë më të bukura se të sotmet. Falënderime të pafundme qofshin për Allahun, falë të cilit këto toka janë toka muslimanësh për shekuj të tërë. Ky popull është bir i dëshmorëve. Këto ezane dhe këto sala janë shenja të Islamit. Kjo fe ka një libër, në të cilin nuk ka ndryshuar as edhe një shkronjë. Kjo fe ka një Pejgamber, që zotëron cilësinë e të qenit shembulli më i bukur. Kemi një mendje dhe një zemër që Allahu na e ka falur ne. Kemi vlera të pandryshueshme, një eksperiencë të gjerë prej 14 shekujsh.

Presidenti im i nderuar,

Edhe unë dua të shpreh falënderimet e mia më të thella ndaj udhëheqjes me guxim dhe ndershmëri që treguat përballë puçit, në emër të popullit tonë, të mijëra nëpunësve fetarë, dua t'u shpreh falënderime ndaj xhemaateve të xhamive që kënduan me lot në sy sala gjatë asaj nate. Në këtë Këshill Konsulencë të mbledhur në mënyrë të jashtëzakonshme, mund të

themi që, në emër të dijetarëve dhe të profesorëve të nderuar, nga fatkeqësia që përjetuam si popull, do të lindin mirësi të mëdha që do t'i shërbejnë së ardhmes.

Një portë që hapet drejt errësirës është mbyllur për të mos u hapur kurrë më. Allahu qoftë i kënaqur me ju dhe me popullin tonë. Jini të sigurt se bijtë e këtij populli plot besim, të cilët e shohin veten përgjegjës përballë gjithë njerëzimit, në emër të Allahut, edhe këtë plagë tradhtie do ta kurojnë me shpejtësi.

Do të vijojmë të kapim për dore brezat që refuzojnë robërimin ndaj robit dhe që bëjnë robëri ndaj Allahut, pa krijuar plagë në fenë islame, veprimet fetare, vlerat e shenjta dhe në popullin tonë; do të vijojmë të shërbejmë ndaj fëmijëve dhe të rinjve tanë. Si shoqëri do ta ruajmë më shumë ligjin dhe marrëdhënien mes njëri-tjetrit; do t'i dalim më shumë zot njëri-tjetrit. Do të rimarrim të gjithë konceptet, termat, vlerat dhe bijtë që ka grabitur FETO dhe organizatat e tjera, të cilat kanë keqpërdorur ndjenjën dhe mendimin fetar. Nuk ka dhe nuk mund të ketë as edhe një musliman që do t'u falet organizatave terroriste. Do të vijojmë mbi udhën e drejtë dhe të pandryshueshme të Islamit. Kur'ani dhe Sunneti do të vazhdojnë të ndriçojnë rrugën tonë duke qëndruar larg çdo lloj ekstremiteti, teprice dhe larg komentimeve të fshehta, po ashtu jetesa jonë fetare do të vazhdojë pa u dobësuar dhe pa u rrudhur aspak.

Ndërkohë që po përfundoj fjalimin, i lutem Allahut që të ruajë popullin tonë të nderuar nga dhimbjet e thella, sprovat e rënda, plagët e pakuruara. Allahu mos u krijoftë mundësi atyre që kanë si objektivi unitetin dhe gjallërinë tonë, atyre që mundohet të gjuajnë me plumb ndaj nderit tonë. Na mbajttë larg çdo lloj fitneje të brendshme dhe të jashtme që mund të tronditë të ardhmen e fesë, të shtetit dhe të popullit tonë! U bëftë Këshilli ynë i Konsulencës shkak për mirësi!

Ju përshëndes me përshëndetjet më të përzemërta dhe iu them përsëri mirë se erdhët!



VENDIMET E KËSHILLIT TË KONSULENCËS

Pas përpjekjes së përgjakshme të natës së 15 korrikut 2016, të kryer nga një organizatë që e keqpërdor fenë (FETO/PDY), me qëllim që të vlerësojmë procesin brenda të cilit gjendemi si shtet dhe si popull; që të përcaktojmë dëmet e shkaktuara nga kjo organizatë dhe organizatat e ngjashme me të ndaj shtetit, popullit dhe fesë islame; që të konsultohemi në aspektin fetar sa i përket kësaj çështjeje dhe të konstatojmë hapat konkret që do të hidhen, si domosdoshmëri e nenit 5 të Statusit të Këshillit Fetar të Konsulencës, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, me një nen të vetëm të rendit të ditës, në datat 3-4 gusht 2016 ka mbledhur në Ankara Këshillin e Jashtëzakonshëm Fetar.

Të gjithë vëllezërit tanë vullnetarë fetarë, të cilët me qëndrimin dinjitoz, të guximshëm dhe të ndershëm përballë tentativës tradhtarë dhe të përgjakshme të puçit, u bënë shembull për të gjithë botën, i dolën për zot atdheut, popullit, vullnetit kombëtar dhe rregullit ligjor. Natën e 15 korrikut ata mbajtën të gjallë entuziazmin shpirtëror të popullit tonë dhe për këtë do të përmenden me falënderim e mirënjohje gjatë gjithë brezave. Urojmë dhe kërkojmë mëshirë nga Allahu për dëshmorët e nderuar, të cilët, ashtu si në ditët e luftës së Çlirimit, iu përgjigjën menjëherë ftesës për t'i dalë zot nderit dhe dinjitetit të popullit dhe arritën në nivelin e dëshmorit. Po ashtu, urojmë shërim të shpejtë për gazinjtë e plagosur!

Të përpiqesh të rrëzosh me armë një qeveri legjitime të bazuar në vullnetin e popullit, duke u organizuar nën maskën e fesë, të shumëzosh me zero vullnetin e popullit, është një grabitje e së drejtës. Nga pikëpamja fetare ky nuk mund të konsiderohet një veprim legjitim. E mallkojmë ashpër dhe me urrejtje këtë përpjekje.

Në Këshillin e Konsulencës që zgjati për dy ditë u konsultua rendi i ditës nga anëtarët, pjesëmarrësit dhe të ftuarit, ndërkohë u pranuan me shumicë votash vendimet e marra dhe u konsiderua e përshtatshme që këto vendime të ndahen me publikun:



FETO/PDY NUK MUND TË CILËSOHET SI STRUKTURË DHE FORMACION FETAR

1. Organizata Terroriste Fetullah, e cila e konsideroi si të lejueshme çdo lloj metode për të arritur objektivat e veta të fshehta dhe të errëta, që keqpërdori fenë dhe ndjenjat fetare; që vodhi zekatin, sadakanë, ndihmat dhe kurbanët e popullit; që mori fëmijët e tyre dhe i orientoi në udhë të gabuar, ndryshoi dhe shkatërroi vlerat e konceptet themelore të fesë sonë; që rekrutoi njerëz dhe përfitoi mundësi për vete me qëndrime dhe sjellje joislame, jomorale, me përçarje, gënjeshtër dhe dredhi, duke u infiltruar kudo ku pati mundësi brenda shtetit tonë, duke u munduar të marrë nën hipotekë të ardhmen e vendit tonë dhe që u kap nga populli gjatë kryerjes së krimit bashkë me tentativën e fundit, nuk mund të cilësohet si një organizatë dhe formacion fetar. Kreu i kësaj organizate nuk mund të pranohet si “dijetar fetar” ose “hoxhë efendi”.

Fetullah Gylen, i cili me një gjuhë dhe stil të posaçëm për veten, që nga vitet gjashtëdhjetë mbledhi rreth vetes përkrahësit e tij me ligjërata entuziaste, më pas, duke përdorur edhe shtresën përkrahëse të Risale-i Nurit, me mund e përpjekje të angazhuar, shtoi efektivitetin me shkolla, qendra kursesh dhe qendra studimi. Mirëpo, me kalimin e kohës u kuptua se pas këtyre aktiviteteve gjendej një rend i fshehur dite: “nëpërmjet përkrahësve donte të shtinte në dorë institucionet më kyçe të shtetit”. Mendjet e reja, të cilat u zgjodhën për këtë arsye dhe që u vetëquajtën “brezi i artë” dhe “të shenjtët e dytë”, me thirrje dhe propagandë mjaft të cekët nëpërmjet punonjësve të quajtur “vëllezër të mëdhenj” dhe “motra të mëdha”, por po aq edhe të ndjeshme, kaluan nga procesi i pastrimit të trurit dhe u pajisën me një tip dhe karakter të vetëm. Duke i përgatitur përkrahësit e tyre si militantë, i futën brenda institucioneve, për vite të tëra u mësuan metodat e vetëfshesjes dhe i programuan që të kalojnë në veprim bashkë me urdhrin e tyre kur të vinte çasti. Organizata Terroriste Fetullah/Strukturimi Shtetëror Paralel (FETO/PDY) vijoi në këtë mënyrë për vite të tëra strategjinë e shtirjes në dorë të shoqërisë, por edhe të politikës. Supozohet se kjo strategji afatgjatë u formësua në mënyrë të qartë bashkë me ndërhyrjen e forcave

të huaja që nga viti 1986. Si rrjedhojë, Gylen, në një ligjëratë të quajtur si ligjëratë private, e cila gjendet në internet, shpreh qartësisht filozofinë kryesore të kësaj strategjie:

“ ...

Jini elastik, përfshihuni brenda strukturave të tyre jetësore pa u dukur, pa rënë në sy. Nga ky aspekt, të zgjosh imazhin e përdorimit të këtyre ligjeve dhe rregullave brenda elasticitetit që tregova pak më parë, bën që të zgjohet imazhi i të qenit njeri i këtyre ligjeve dhe rregullave, pra të thuhet se këta i respektojnë një më një ligjet. Duhet thënë se ky është një kriter dallues pas atyre emërimeve të mëdha. Kjo duhet të ndodhë edhe në emërimin tuaj në një periudhë të mëtejshme në vende më të rëndësishme. Pra, të mund të përparosh pa u ndier, pa e ndier ekzistencën e tyre, ja kjo, ashtu si në këto dy institucione, bëhet fjalë edhe në disa institucione dinamike jetësore. Çështja e përparimit në mënyrë të mëtejshme, qarkullimi i tyre brenda këtyre strukturave jetësore dhe, nëse do të kthehen pas, të kthehen pa marrë plagë, pa u ndier, janë çështje mjaft të rëndësishme në emër të së ardhmes sonë. **Zbuloni pikat kritike të sistemit për të ecur drejt së ardhmes.**

... Ndërsa ana tjetër është që, qoftë në gjykatë, qoftë në jetesën civile, shokët tanë, në vendet ku do të ikin, të mund të punojnë më lehtësisht, edhe nëse janë nënprefektë a gjykatës të thjeshtë, të jenë gjykatës të përgëzuar dhe të vlerësuar...

...

Nëse nuk zotëroni ekuilibër force, atëherë mos u drejtoni drejt forcës. Do të planifikoni shumë mirë dhe sipas kësaj do të veproni. Nga jashtë do të na fajësojnë duke na thënë frikacakë. Allahu do të jetë zgjidhës i problemeve tona.

Në vend të heroizmit të pavend, parapëlqej shtënien në dorë.

Bëhet fjalë për një detyrim në veprimin dhe sjelljen e bazuar në marrjen e masave paraprake. Çdonjëri prej atyre që duan të shërbejnë duke qenë pjesë e kësaj lëvizjeje tyre duhet të veprojnë si një diplomat që do të drejtojë i vetëm botën, në këtë mënyrë duhet të mundohet të zgjidhë problemet edhe në shtetin e tij, pasi të ketë zgjidhur çështjet sipas planit të tij.

Pikërisht në një periudhë të tillë, deri në çastin kur do të gjejmë thelbin tonë, ku do të arrijmë në pjekuri, deri në çastin dhe kohën kur do të marrim botën mbi shpinë dhe të kemi forcën për



ta mbajtur atë, deri në çastin kur të kemi në dorë gjërat që do të përfaqësojnë këtë forcë, **sipas masës së strukturës shtetërore të Turqisë, deri në çastin kur do të tërheqim në fronin tonë të gjithë forcën dhe pushtetin e institucioneve kushtetuese, çdo hap i hedhur konsiderohet i hershëm.**

Këto shtëpi janë shtëpi mbushjeje dhe zbrazetje. Njerëzit mblidhen këtu, më pas shkojnë e hidhen në hapësirat boshe... Pikërisht në një kohë kur çdo gjë mbyllet, kur të gjithë portat mbyllen me kyç, këto shtëpi kanë marrë mbi vete një mision më të madh se ai që kishin në të ardhmen. Sepse disa nga detyrat që kryejnë këto shtëpi janë kryer në të shkuarën nga medreseja. Disa i kryen mektebi. Disa i kryen teqeja. Disa i kryen zavija. Ja që kur hidhet themeli i këtyre shtëpive dhe ky themel hidhet me dorën e njërit prej personave më të ndershëm të asaj periudhe, tashmë nuk ka më medrese, mektebi është larguar nga misioni i tij. Portës së teqesë i është vendosur kyç, në pjesën e pasme të portës së zavijes është vendosur syrgjyn. Të hapësh ato porta dhe të hysh brenda nuk është e mundur. Këto shtëpi përballojnë gjithë këtë mision të madh e këto detyra të rënda. Allahu i lejoi këto shtëpi. Lejen e dha Allahu.

...

Është e dhimbshme, në fakt, mirëpo përballë të gjitha këtyre, të mos nxisësh palën përballë, të tregosh me një stil më të butë dhe këto që lexojmë, është shumë e rëndësishme. Pasi të tejkalohet kjo, duhet të llogarisim se cili është qëndrimi i botës mbi këtë çështje, nuk duhet të hidhet hapi i fundit pa arritur sukses në të gjitha planet që mund të përballen në çdonjërin prej platformave. Qoftë edhe një gabim bën që të përjetojmë diçka false dhe nuk mund ta kompensojmë më pas humbjen e pësuar nga gabimi. Behet gabim, nuk e kompensojmë dot. Këtë herë këta e kapin atë dhe e zënë ngushtë. Dhe nuk krijojnë mundësi që të drejtohem më edhe një herë tjetër...

Ato që bëjmë në këtu janë çështje të përballjes me botën në një plan mikro. Është një përballje me të gjithë botën. Njerëzit që një ditë do të ballafaqohen me botën, kanë si detyrë të mësojnë rrugët e ballafaqimit me të. Kjo është çështje arsimit dhe edukimit.

Unë ua tregova ju këtë ndjenjë dhe mendim në privatësi. Por, e tregova duke u mbështetur te besnikëria juaj, te ndjenjat tuaja në lidhje me privatësinë. E di se, kur të dilni jashtë, njësoj siç do të hidhni në mbeturina kutitë boshe të lëngjeve të frutave që keni në dorë, kështu do t'i hidhni edhe

këto mendime – me anën e tyre të hapur. A munda t'ua tregoj? Sekretit është robi juaj. Nëse e thoni, ju bëheni rob i tij.

Shërbimi ynë, gjithsesi, e mëson këtë në aspektin e filozofisë dhe doktrinës themelore. Pra, në vende të tilla hapëm nga një shtëpi. E thurëm rrjetën atje me durimin e merimangës, thurëm rrjetën dhe pritëm njerëzit që ranë atë ditë brenda në të, u treguam diçka atyre që ranë në të, u treguam rrugët që i çonin ata në mosngrënie, mospërfundim, në ringjallje...”

Për të realizuar këtë objektiv të fshehtë Gyleni ka mbajtur një qëndrim pragmatist, sipas kohës dhe vendit dhe ka zhvilluar një aktivitet të përshtatshëm me mjedisin. Kur shihen fjalimet dhe aktivitetet e tij dyzvetjçare, me mjeshtëri ia ka dalë të ketë shumë maska, që mund të cilësohen si sunit, alevit, sufit, hurufit, radikal, demokrat, laik, antikomunist, liberal, humanist, dialogist bashkëkohor, modernist, nacionalist. Gyleni, me kalimin e kohës, erdhi në një gjendje ku, për hir të këtij qëllimi të fshehtë, u bë shkak për kryerjen e çdo lloj përçarjeje dhe punëve të fokusuara në fesat, të cilat kurrë nuk përshtaten me moralin Islam. Ndërsa fillimisht shfaqej në cilësinë e një xhemaati fetar, me kalimin e kohës u shndërrua në një organizatë që përfshinte projekte të fshehta, u huajëzua. Si rrjedhojë, disa emra që vinin në rend të parë të bërtamës së kësaj organizate, kur panë këtë qëndrim “tjetërsimi” dhe “organizimi”, u larguan nga struktura dhe deshifruan anën e tij të brendshme.

Sipas deklaratave të atyre që u ndanë nga organizata dhe panë realitetin, struktura në fjalë u kthye në një organizatë të pistë, me hierarkinë e tipit piramidë, ku individët lidheshin me njëri-tjetrin nëpërmjet rrjeteve dhe interesave ndërkombëtare, me organizatat e huaja të shërbimeve informative, nëpërmjet një strukturimi të fshehtë. Synimi nuk ishte të kryenin një shërbim në rrugën e Islamit, në vende të ndryshme, kryesisht duke filluar nga Turqia, por të shtinin në dorë një sovranitet botëror në emër të forcave të errëta. Si rrjedhojë, fjala e Gylenit e thënë vite më parë në formën: “Edhe nëse ne e pushtojmë të gjithë sipërfaqen e tokës, duhet të kërkojmë rrugët për të pushtuar edhe qiellin, pa ngecur në tokë”, tregon se sa ëndërrimtar dhe ambicioz është ai. Me përpjekjen për puç, ku përlyen me gjak shtetin ku lindi Gyleni dhe përkrahësit e tij, me vrasjet pa autor që kryen në të shkuarën, shantazhet që kryen kundrejt shtresave të ndryshme të shoqërisë, ata u shndërruan në mjetin më të hapur dhe të qartë të synimeve të tyre.



Në gjuhën dhe aktivitetet e organizatës feja është vetëm një mjet për të zbatuar planet e veta tinëzare. Kreu i organizatës në fillim ka mashtruar shtresat e gjera të popullit me premtimin e edukimit fetar, ndërsa në fund, me aktivitetet që u munduan të shndërrojnë në përçarje shtetin tonë dhe duke hapur zjarr mbi popullin civil, ka dhënë urdhrin e kryerjes së sulmeve jomorale dhe jonjerëzore, siç janë masakrat masive. Me tentativën për puç, në një periudhë kohore kritike, ku tregohet përpjekja ndaj organizatave terroriste globale të drejtuara kundrejt shtetit, brenda dhe jashtë tij, tentoi të shembë institucionet shtetërore dhe të parapërgatisë shtetin tonë që të mund të pushtohet nga të huajt.

Karakteret e pjesëtarëve të organizatës që zhvilloi aktivitete nën maskën e fesë, bien në përputhje me munafikët (dyfytirësit) që jetonin në periudhën e Medines. Si rrjedhojë, në ajetet përkatëse, në lidhje me munafikët, tregohet se persona të tillë janë të sëmurë shpirtërisht, se thurin plane tinëzare ndaj besimtarëve, në emër të realizimit të agjendave të tyre të fshehta. Përsëri sipas ajeteve mbi këtë çështje ata, duke braktisur besimtarët dhe duke konsideruar si të lartë dhe miq jomuslimanët me të cilët bënin aleancë, punonin në disfavor të muslimanëve. Ata pretendojnë se punët e fitnes dhe të përçarjes i bëjnë nën emrin e “paqes”. Flasin aq bukur sa të bëjnë t’i dëgjosh (Bakara, 2/8-15, 204-206; Munafikun, 63/2-4). Ata e fshehin veten aq mirë, sa as Hz. Pejgamberi nuk mund ta dinte anën e tyre të fshehtë, pa e informuar Allahu (Teube, 9/101; Muhammed, 47/30).

Grupi gylenist, i cili në fillim e paraqiti veten si një lëvizje morali dhe arsimimi, në fillim u shndërrua në një kult fetar, e më pas në një organizatë terroriste. Si rrjedhojë, disa hulumtues e përshkruajnë organizimin dhe strukturimin e organizatës si “organizatë me veçori mesjanike (në lidhje me mesihun), strukturë që bazohet në lidhësinë fetar me identitet karizmatik dhe autoritar, që ka një strukturim të ngushtë hierarkik, që krahas funksioneve të organizatave të qarta, zotëron një strukturim të fshehtë, të posaçëm dhe një organizim të brendshëm të komplikuar.” Kjo strukturë e sëmurë nuk është një xhemaat fetar, por një projekt tinëzar i sistemit global. Si rrjedhojë, një strukturë që nuk është nën udhëzimin e Kur’anit dhe Sunnetit, por që orientohet dhe drejtohet qartësisht nga një “mbimendje”, që është në bashkëpunim me forcat e jashtme, që u shërben qëllimeve të fshehta të forcave madhore, nuk mund të jetë kurrë një formacion fetar.

Argumenti më i qartë i kësaj ka të bëjë me faktin se organizata që realizoi tentativën për puç, sulmoi me armët më të rënda popullin e pafajshëm, i cili doli nëpër sheshe me flamuj në duar dhe tekbire në gjuhë, për të mbrojtur vullnetin e vet. Gjatë këtij sulmi vranë qindra nënshtetas dhe plagosën mijëra të tjerë. Si rrjedhojë, cilidoqoftë pretendimi që parashtron së jashtmi, si gjuha, parulla, njohuritë dhe dija, njësoj siç nuk mund të cilësohet strukturë fetare një organizatë që ka kryer këtë tradhti, nuk është e drejtë as që kreu i kësaj organizate të thirret me epitete të tilla si, dijetar fetar, ligjërues ose hoxhë efendi.



EPITETET QË I VIHEN LIDERIT TË FETO/PDY NUK MUND TË PËRPUTHEN ME ISLAMIN

2. Sipas Islamit, përveç Hz. Pejgamberit, nuk mund të pranohet një autoritet dhe udhërrëfyes “i pagabueshëm dhe i padiskutueshëm”. Askush dhe asnjë strukturë nuk mund ta shohë veten si përfaqësues absolut i fesë dhe nuk mund t’i ftojë njerëzit të lidhen me të me bindje dhe vartësi të pakushtëzuar. Meqë në Islam bindja dhe vartësia absolute lidhet me parimet, kornizat e të cilave përcaktohen nga Kur’ani dhe Sunneti, askush nuk ka vlefshmëri që dikush ta pranojë veten si autoritet, kompetent dhe udhërrëfyes i pagabueshëm, ose që të shihet kështu nga vartësit. Kjo bie qartësisht në kundërshtim me librin e Allahut dhe Sunnetin e Hz. Pejgamberit. Nga pikëpamja fetare, nuk mund të pranohet pretendimi se një person është i veçantë, i përzgjedhur dhe i pagabueshëm, se deklaratat dhe doktrina e tij përfaqësojnë shenjtërimin.

Koncepti “i pagabueshëm” ka edhe kuptimin “i mbrojtur/mbrojtje”. Njësoj si disa grupe fetare, edhe pjesëtarët e organizatës Gylen i ngarkojnë liderit të tyre cilësinë e “mbrojtësit”, një cilësi kjo që u dedikohet pejgamberëve. Ndërkohë që të qenit i pagabueshëm, apo siç citohet në tekstet e besimit, cilësimi i të qenit i pagabueshëm, është një cilësim i posaçëm vetëm për pejgamberët dhe tregon se individët që kanë këtë cilësi, janë të mbrojtur nga Allahu. Ky cilësim, nën cilindo emër qoftë, nuk mund t’i jepet askujt dhe asnjë grupi, përveç pejgamberëve.

Pjesëtarët e organizatës, pas arsimit, ose më saktë, pas thirrjeve të marra për vite të tëra, çdo urdhëresë të ardhur nga lideri dhe drejtuesi i quajtur vëllai i madh/motra e madhe, e kanë konsideruar si “urdhër të Allahut dhe Pejgamberit”. Edhe pse këto urdhëresa kanë qenë në kundërshtim me rregullat dhe parimet fetare, kanë plotësuar urdhrat e dhëna pa bërë asnjë deklaratë, pa diskutuar dhe pa shprehur asnjë dyshim se “me siguri ka një urtësi që ne nuk e dimë”. Duke iu bindur liderëve të tyre pa hetuar, kanë shprehur zemërimin ndaj këtyre parimeve që gjenden në Islam: *“Aty ku ka rebelim ndaj Krijuesit, nuk ka bindje ndaj krijesës. Bindja gjendet vetëm tek ajo që njihet.”* Pra, në kushtet e pranuar si të

drejta nga feja dhe mendja (*Buhari, Ahbaru'l-ahad, 1; Ahkam, 4; Muslim, Imare, 40; Ebu Dau'ud, Xhihad, 87; Ibn Hisham, es-Sire, VI, 53*).

Në vendosjen e kësaj bindjeje absolute brenda organizatës, krahas keqpërdorimit të disa ajeteve dhe haditheve, krahas tjetërsimit të marrëdhënies mes Hz. Pejgamberit dhe sahabeve, një rol të madh kanë edhe entrikat e ndryshme të Gylenit. Këto thirrje të ngarkuara shpeshherë me aspekte fetare dhe që u ligjëruan për vite të tëra, u futën aq thellë në mendjet e reja, në nivel të shkollës nëntëvjeçare, si mënyrë e “kulturës së bindjes absolute”, sa tashmë, te këta të rinj nuk ka mbetur asnjë përpjekje mendore dhe ideore “për forcë gjykuese dhe mendimi, për aftësi kritike, për synime studimi dhe hulumtimi të së vërtetës”. Në vend të kësaj ka ardhur nënshtimi ndaj liderit, ndaj motrave dhe vëllezërve të mëdhenj. Edhe pse çdo njeri pritet që ta dallojë të drejtën nga e gabuara duke përdorur mendjen që i ka dhënë Allahu, “ata që binden në mënyrë absolute” nuk mund të shpëtojnë nga përgjegjësia. Sepse sipas shpjegimit të Allahut, jo vetëm liderët që orientojnë në rrugë të gabuar, por edhe ata që lidhen e kapen pas tyre, do të pësojnë dënimin e xhehennemit (*shih A'raf, 7/38; Ahzab, 33/67*). Kur'ani Famëlartë e ndalon veprimin në mënyrë të verbër, urdhëron sjelljen e vetëdijshme dhe veprimin me argumente e largpamësi.

Kuptohet se Gyleni, në përcaktimin e rregullave fetare, ka vendosur veten në vend të autoritetit absolut të Kur'anit dhe Sunnetit. Ai ka bërë të mundur që përkrahësit të besojnë çdo fjalë të tij, duke e bërë si mburojë ndaj vetes pretendimin e mbrojtjes. Meqë përkrahësit besojnë se Gyleni përfaqëson “të drejtën dhe të vërtetën” dhe se rruga e përfitimit të lumturisë fetare dhe botërore kalon nga nënshtimi ndaj tij, ata i binden absolutisht atij. Ky besim pothuajse na sjell në mendje “imamin e pafajshëm” (person i zgjedhur nën mbrojtjen e Allahut), që mjaft dijetarë të medh'hebeve e refuzojnë me rreptësi.

Kur'ani, i cili kërkon që të dëgjojmë fjalën dhe t'i përshtatemi më të bukurës, të vëmë në punë mendjen e gjykimin (*Zumer, 39/18*), e ndalon pranimin në mënyrë të verbër, ose lidhjen me një person tjetër pa hetuar. Si rrjedhojë, Allahu i Lartmadhëruar, duke urdhëruar: **“Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre, si dhe Mesinë, të birin e Merjemes”** (*Teube, 9/31*) i kritikon rreptësisht të krishterët dhe hebrenjtë. Ndërsa i Dërguari i Allahut, këtë ajet e shpjegon si në vijim: “Në të vërtetë, nuk i adhuronin ata,



por përcaktonin si të lejuara çka ata i konsideronin të lejuara, si të ndaluara çka ata i konsideronin të ndaluara” (*Tirmidhi, Tefsiru’l-Kur’an, Suretu’t-Teube, 10, no: 3095*).

Individi musliman, ndërkohë që përjeton besimin e tij, nuk është përgjegjës me “bindjen absolute” ndaj askujt, duke përfshirë edhe drejtuesit dhe autoritarët e vendit të tij. Sepse në Islam bindja ka kufij dhe kushte të përcaktuara. Si rrjedhojë, në Kur’anin e Madhërueshëm, citimi i kushtit të *“moskundërshtimit në çfarë është e drejtë dhe e arsyeshme”*, si një ndër kushtet e shprehjes së besëlidhjes së femrave muslimane ndaj Hz. Pejgamberit, është domethënës (*Mumtehinë, 60/12*).

Kur shihet nga ky aspekt, për vendosjen dhe funksionimin e rregullit të nevojshëm, u injekton kulturën e bindjes pjesëtarëve të organizatës së Gylenit, që nga dita e parë që janë përfshirë (shumica e tyre janë mashtruar që në moshë të vogël dhe janë bërë pjesë e organizatës), atyre u krijohet besimi se çdo aktivitet që kanë kryer në kuadër të mendimit të shenjtëritimit të synimit përfundimtar, mbart një qëllim hyjnor dhe, si rrjedhojë, urdhëresat e dhëna janë të pahetueshme. Aq e ashpër është kjo hierarki brenda organizatës, sa asnjëri prej pjesëtarëve nuk ka të drejtë të kundërshtojë urdhëresat e dhëna nga eprorët. Nëse ndodh të ketë kundërshtim ose mungesë bindjeje, menjëherë hyn në funksion veprimi i paralajmërimit-kërcënimit-shantazhit dhe, nëse është e nevojshme, këtij personi i ndërpritet marrëdhënia me xhemaatin.

Në këtë situatë, qoftë perceptimi se kreu i organizatës është i pagabueshëm dhe i përzgjedhur, qoftë qëndrimi i pjesëtarëve me bindje dhe vartësi absolute, nuk kanë një anë që të jetë në përputhje me parimet e përgjithshme të Islamit.

FETO/PDY ËSHTË NJË LËVIZJE E QARTË E KEQPËRDORIMIT TË ISLAMIT

3. Në Islam thirrja bëhet në rrugën e Allahut dhe të Pejgamberit Muhammed (s.a.s.). Thirrja e bërë kundrejt personave, strukturave dhe fraksioneve të ndryshme në emër të Allahut, është mashtrim ndaj njerëzve që kanë konceptin e fesë dhe të Allahut, është një padrejtësi e madhe e bërë ndaj Islamit. Askush nuk mund t'ia dorëzojë dikujt tjetër mendjen, vullnetin dhe personalitetin. Nuk është e mundur që të miratohen nga Islami strukturat që janë formuar duke keqpërdorur ndjenjat shpirtërore të njerëzve, në emër të fesë dhe në emër të Allahut.

Të gjithë pejgamberët, që nga Hz. Ademi, i thërrasin njerëzit drejt Allahut dhe fesë së Allahut. Edhe i Dërguari i Allahut, si hallka e zinxhirit të profetësisë, ka ftuar në Islam për 23 vjet ata që kishte përreth dhe nuk ka bërë ndonjë tentativë kundër së ardhmes. Si rrjedhojë, në ajetin Kur'anor bëhet e ditur se Pejgamberi *“është dërguar me lejen e Allahut si ftues dhe thirrës drejt Allahut” (Ahzab, 33/46)*. Pra, në bazë të aktiviteteve ftuese, shpallëse, të thirrjes dhe irshadit, është sinqeriteti dhe ndjenja vullnetare (*Sebe’, 34/47; Hud, 11/29; En’am, 6/90*). Askush nuk mund të bëjë ftesë kundrejt një kauze, së ardhmes dhe interesit të tij, duke përdorur emrin e Allahut dhe të fesë.

Megjithëse situata qëndron kështu, gjatë gjithë historisë nuk kanë munguar as ata që kërkojnë të nxjerrin interesa nga feja, keqpërdoruesit e fesë dhe të ajeteve të Allahut (*Teube, 9/34*). Për shembull, qoftë në Teurat e qoftë në disa literatura islame, Bel’am b. Baura, që citohet në literaturë (dhe që më parë, ndërkohë që ishte besimtar i mirë, organizoi dredhi kundër Hz. Musait dhe popullit të tij) është një person i tillë. Në të njëjtën mënyrë flitet shpesh për klerikët fetarë, të cilët “megjithëse janë trashëgimtarë për Librin, marrin mallin e pavlerë të botës dhe (sidoqoftë), duke thënë se ne do të falemi, e keqpërdorin Islamit, i shesin haptazi e me një vlerë të ulët ajetet e Allahut” (*A’raf, 7/169; Bakara, 2/79, 174; Al-u Imran, 3/187, 199; Maide, 5/44*).

Sa i përket kësaj çështjeje, një shembull i spikatur është edhe Mesxhidi Dirar, të cilin e ndërjuan munafikët e Medines përballë Mesxhidit të Kubës, me qëllim që të dëmtojnë



muslimanët. Allahu i Lartmadhëruar, duke zbritur këto ajete në lidhje me këtë mesxhid dhe me ata që e ndërtuan atë, ka treguar anën e brendshme të kësaj çështjeje:

“(Hipokritë) janë edhe ata që ndërtuan një xhami për t’u shkaktuar dëm (besimtarëve), për të forcuar mohimin dhe për të krijuar përçarje ndërmjet besimtarëve, duke u shërbyer xhamia si pusi atyre që qysh më parë luftonin kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Dhe, vërtet ata betohen: *“Ne kishim për qëllim që të bënim vetëm një vepër të mirë!”* Por Allahu dëshmon se, në të vërtetë, ata janë gënjeshtarë. Në atë xhami mos fal kurrë namaz...” (Teube, 107-110). Pas këtij paralajmërimi hyjnor, Hz. Pejgamberi urdhëroi menjëherë shembjen e atij mesxhidi (Uakidi, III, 1046; Ibn Hisham, IV, 530).

Në një transmetim që i aludohet Muadh b. Xhebelit theksohet se disa persona që duken si klerikë fetarë dhe që flasin sikur po thonë gjëra të drejta, i mashtrojnë njerëzit dhe, nëpërmjet fjalëve do t’i nxjerrin ata nga rruga e drejtë (Ebu Dau’ud, Kitabu’s-Sunne, 6, no. 4611).

Nga të gjithë këto shembuj kuptohet se keqpërdorimi i fesë islame, edhe në ditët e sotme shihet njësoj si në të shkuarën. Ndërsa shembulli më konkret i kësaj është organizata Gylen. Kjo organizatë nuk ka lënë asgjë pa keqpërdorur, duke filluar që nga besimi e deri te adhurimi, nga ndjenjat tek ëndrrat, nga zemrat te mendjet. Vlerat dhe realitetet fetare që u keqpërdorën nga organizata Gylen janë:

a. Para së gjithash **kanë keqpërdorur emrin Allah**. Sa u përket thënieve të rreme fetare mbi Kur’anin dhe deklaratave jo të vërteta të prodhuara jashtë fesë, Allahu thekson se mund të mashtrohet me të, madje edhe i paralajmëron njerëzit mbi këtë çështje: *“Ai mashtrues të mos ju mashtrojë ju me Allahun”* (Lukman, 31/33).

Pjesëtarët e organizatës mendojnë se kreu i tyre flet drejtpërdrejt me Allahun dhe për këtë arsye, fjalët e tij i mbajnë mbi fjalët e gjithë të tjerëve. Ndërkohë që Allahu nuk ka folur drejtpërdrejt me asnjë qenie njerëzore, përveç pejgamberëve që ka zgjedhur (Shura, 42/51; Nisa, 4/164).

Gyleni, në një ligjëratë që mbajti në datën 07.04.1991, ndërkohë që flet për bindjen dhe nënshtrimin, e paraqet kështu keqpërdorimin e emrit të Allahut, duke dhënë një shembull të hapur: “E vendosa dorën e tij mbi dorën time dhe thashë ‘konsideroje këtë si dorën e

shokëve të mi, o Rasulullah'. Ata që kapin këtë dorë konsiderohen sikur kanë kapur dorën e Allahut. Sikur ky xhemaat ka bërë nijet që të mbajë dorën e Allahut."

b. Organizata Gylen ka keqpërdorur edhe Kur'anin. Gyleni, në një ligjëratë të mbajtur në datën 03.06.1990, gjoja entuziazmohet dhe e flak Kur'anin mbi xhemaat. Në këtë kohë bërtet: "Dilini për zot Kur'anit! Dilini për zot Rasulallahut!"

Gyleni, në ligjëratën me titull "Horizonti i të shenjtëve", mbajtur me datën 31.03.1991, pasi shpreh se këta të shenjtë janë Hz. Pejgamberi dhe sahabet e tij, flet për një grup të dytë të shenjtësh në periudhën e fundme (ahir) dhe thotë se ky grup do të vijë. Me fjalën "të shenjtit", vesh me shenjtëri grupin e tij dhe, duke u nisur nga ky ajet, shprehet se këta të shenjtë janë dëshmorët e Allahut: "Jobesimtarët thonë: *'Ti nuk je i dërguar!'* Thuaju (o Muhammed!): *'Mjafton Allahu për dëshmitar midis meje dhe jush dhe ata që kanë dijeni për Librin (besimtarët çifutë dhe të krishterë të asaj kohe).'*" (Ra'd, 13/43) Shprehjen وَمَنْ عِنْدَهُ عِلْمُ الْكِتَابِ "ata që kanë dijeni për Librin", që citohet në ajet, e komenton duke nënkuptuar grupin e tij.

Gyleni, në ligjëratën e tij me titull "Hizbullah", me datë 6 gusht 1978, pasi këndon ajetin: *"O besimtarë! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se Allahu do të sjellë njerëz që i do dhe që e duan; të përulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë..."* (Maide, 5/54), pra këndimi i këtij ajeti, nënkupton se populli që do të vijë dhe për të cilin flitet në këtë ajet, mund të jetë xhemaati i tij.

Keqpërdorimi i Kur'anit nga Gyleni tregohet edhe nga komentime të ndryshme, për shembull kur tejkalon shtrembërimin, aq sa të mund të thotë se shpirti që i erdhi Hz. Merjemit mund të jetë Hz. Muhammedi. Ajetin 17 të sures Merjem, në formën *"Dhe trego (o Muhammed) në Libër për Merjemen, kur ajo u tërhoq nga familja e saj në një vend në Lindje, duke e fshehur veten prej tyre. Ne i dërguam Shpirtin Tonë, i cili iu paraqit asaj si një njeri i plotë"* (Merjem, 19/17), pra këtë ajet, ai e komenton kështu: "Vallë ç' ishte ky shpirt? Pothuajse të gjithë tefsiret tregojnë se shpirti i cituar në ajet në formën "... dërguam shpirtin tonë..." është Xhebraili.



Ja që këtu në Kur'an përdoret emri shpirt, por ka dallime mendimesh në përcaktimin se kush është shpirti. Ndërsa kufijtë e mundësisë se kush është shpirti e tejkalojnë kornizën e mosmarrëveshjes dhe dallimit të pikëpamjeve, madje janë aq të gjerë sa të mund të përfshijnë edhe shpirtin e Pejgamberit. Po, edhe kjo është e mundur, sepse Hz. Merjemi është një grua mjaft e ndershme dhe e dëlirë. Duke u nisur nga kjo, asaj nuk i kishte hyrë në sy një ëndërr tjetër dhe nuk duhej t'i hynte. Atë mund ta shihte vetëm dikush që ishte i lejuar për të. Edhe ai, vetëm Pejgamberi ynë mund të jetë, sepse ai, në njëfarë mënyre, aludonte se Hz. Merjemi ka bërë nikah me të. Parë nga ky aspekt, "shpirti" mund të jetë edhe shpirti i Pejgamberit."

Që nga periudhat e hershme, dijetarët e tefsirit fjalën "ruh" që citohet në ajet e kanë komentuar në formën e Xhebrailit. Si rrjedhojë, ajeti 45 i sures Al-u Imran e shpjegon këtë koncept dhe shpreh se meleku i ardhur është meleku që i dha sihariq Hz. Isait (Xhebraili). Si rrjedhojë, të bësh një koment në formën se si e shpreh Gyleni nuk përputhet as me tërësinë e Kur'anit dhe as me konceptin e shpirtit në Kur'an. Sepse ky koncept përdoret në tetë kuptime të ndryshme në Kur'an dhe në asnjërin prej tyre nuk synohet Hz. Pejgamberi. Përveç kësaj, duhet të theksohet se shprehjet e ngjashme pothuajse krijojnë mendimin se Hz. Pejgamberi është bashkëshorti i Hz. Merjemit, si rrjedhojë, se ai mund të jetë babai i Hz. Isait. Një mendim i tillë nuk mund të përputhet as me ardhjen e Hz. Isait në botë dhe lindjen e tij në një formë mrekullie dhe as me nivelet e larta të këtyre personaliteteve të veçantë.

c. Shihet se në ligjëratat dhe librat e Gylenit më shumë keqpërdoret figura e Hz. Pejgamberit. Siç e shpreh qartë në ligjëratat e tij, Gylen thotë se Hz. Pejgamberi vjen në Izmir, shëtit në mes të xhemaatit dhe i inspekton ata.

Në një ligjëratë të tij në datë 06.04.1979 shprehet si në vijim: "Dikush tregon kështu: 'Një natë pashë Rasulullahun, i cili më tha: 'Unë sapo dola për inspektim. Prej këtu do të shkoj në Izmir.' Dikush tjetër do të thotë kështu: 'Erdhi dhe u ul në minber, ose u ul pranë minberit. U mishërua brenda atij xhemaati.'"

Në një ligjëratë të datës 07.04.1991, pasi bën të ditur se Pejgamberi ynë shëtiste mes tyre, se atë e kishin parë mijëra njerëz, thotë: "Ai është mes jush, po ëndërroja sikur Ai shëtiste mes jush."

Ndërsa në një ligjëratë të datës 09.07.1979 shprehet se Pejgamberi ynë, vende-vende inspektion shtetin tonë: “Mundohemi të krijojmë atmosferën e të qenit të gatshëm për inspektimin e tij. Pejgamberi ynë nderon mesxhidin me ardhjen e tij. ‘Ç’na thoni në lidhje me të ardhmen?’ Rreth njëqind herë, njerëz me zemër të ndritur dhe persona të pastër, kur ishin në gjendje gjumi, ndoshta disa edhe kur ishin zgjuar, dëgjuan se tha: ‘Unë po iki në Izmir, do të shoh atmosferën atje.’ Po ashtu: ‘Në Anadoll kanë nevojë për mua, dola të shëtis.’ Vjen në xhamitë tuaja, sheh të rinjtë që e vendosin ballin në sexhde, kontrollon emocionin e dashurisë të të moshuarit, sheh nëse xhemaati është i gatshëm apo jo.”

Ndërsa shembulli më spikatës i keqpërdorimit të emrit të Pejgamberit është fakti që në telenovelën me titullin Kodra e Mëshirës, të publikuar në kanalën televiziv të organizatës, hipja e Hz. Pejgamberit në një kamion u tregua në formën e një rrezeje drite. Ndërkohë që, sipas fesë sonë, për asnjë qëllim nuk është e lejuar të bësh piktura dhe miniatura që përshkruajnë Hz. Pejgamberin, as ta përfaqësosh atë me rreze drite.

d. Në ligjëratat dhe veprat e tij shihet se Gyleni prek marrëdhënien mes Hz. Pejgamberit dhe sahabeve dhe paraqet tablo interesante në këtë kuadër. Ai **e keqpërdor edhe figurën e sahabeve.**

Gyleni e përdor fenë si mjet dhe, sa i përket kësaj çështjeje, veçanërisht historinë e pejgamberëve dhe historinë sija, e formon ashtu si historinë e tij. Ky format dhe konceptim e pozicionon Gylenin pothuajse si Hz. Pejgamberi, ndërsa përkrahësit e tij i quan si “të shenjtët e dytë”. Ndërsa njëri prej tjetërsimeve më të mëdha të Gylenit në lidhje me fenë është fakti që historinë e Pejgamberit e supozon sikur është krejtësisht e përputhshme me situatën e tij dhe të përkrahësve të tij dhe që përkrahësit e tij e besojnë me zemër këtë gjë.

Në një ligjëratë që mban në datën 03.06.1990, pasi përmend hadithin: “*Kjo fe ka nisur si e vetme. Do të kthehet në kohën kur edhe filloi...*” shprehet se grupi i tij ishte hallka e dytë e këtyre të vetmuarve. Më pas shprehet se Rasulullahu e ka pasur një dorë mbi kokën e sahabeve, ndërsa një dorë ishte mbi xhemaatin e Gylenit dhe se Pejgamberi i ka quajtur ata “sahabet e mi”.

Ndërsa në një ligjëratë të mbajtur në datën 04.10.1977, me titullin “Përgjegjësia”, e shpreh kështu faktin se shpëtimi i ummetit dhe i njerëzimit është i lidhur me xhemaatin e tij: “Allahu është me ne. Rasulullahu është me ne. Banorët e botës së melekëve vëzhgojnë



luftën për ekzistencë që shfaq në tokë ky xhemaat. Ashtu si sahabet e Bedrit, ose ky xhemaat do të zhduket dhe do të shfaroset, ose do të ndryshojë fatin e hidhur të njerëzimit në sipërfaqen e tokës. Do të nisin duartrokitjet në qiell; shikimi i melekëve të pikëlluar do të shndërrohet në buzëqeshje.”

e. Ndërsa një pasqyrim tjetër i rëndësishëm i perceptimit fetar që zhvilloi Gyleni është **keqpërdorimi i koncepteve islamike**, të tilla si *imam*, *vaiz (ligjërues)*, *hoxhaefendi*, *xhemaat*, hizmet dhe himmet (para e dhënë për bamirësi), për më tepër, ai i tjetëron ato. Janë larguar nga origjinali kuptimet e këtyre koncepteve të përdorura shpesh në hierarkinë dhe aktivitetet e organizatës, janë boshatisur brenditë e tyre në kulturën tradicionale dhe janë përdorur në kuptime të ndryshme. Aq sa, meqë sjell në kujtesë përfytyrime negative, muslimanët arritën në një pikë sa nuk i përdorin më këto koncepte.

f. Krahas të gjitha këtyre, kriteri që është keqpërdorur më shumë janë **mendjet e reja**. Organizata, duke vjedhur ose duke keqorientuar besimet, idealet, horizontet dhe ëndrrat e të rinjve më të zgjuar të shtetit, i ka keqpërdorur dhe shfrytëzuar ato. Ka shfrytëzuar ndjenjat krejt të pastra, të palarguara ende nga pastërtia krijimore e atyre të rinjve, me lotët, rrëfenjat dhe tregimet e ekzagjeruara. Me modesti të rreme dhe fjalë të buta, me lot dhe me të ashtuquajtura ligjërata e këshilla, kanë bërë mjet çdo shpresë dhe përmallim ndaj synimit të tyre. Ata që kanë marrë nga bijtë e popullit i kanë pajisur me objektiva dhe qëllime të fshehta, me bindje absolute dhe infiltrim dinak. Përkrahësit, të cilët janë robotizuar ndaj këtyre urdhrave në dukje të butë dhe që aftësitë e tyre kanë dalë jashtë funksionit, e kanë mashtruar popullin tonë me Allahun, Pejgamberin dhe sahabet. Kanë përdorur si mjet për synimet dhe qëllimet e tyre ajetet e Allahut, hadithet e Rasulullahut, trashëgiminë e dijetarëve, të të parëve të urtësisë dhe të mirësisë, kanë përdorur të gjitha vlerat e këtyre tokave, si për shembull, poetët Mevlana dhe Junus Emre.

g. Po ashtu, një kriter tjetër i keqpërdorur nga Gyleni është **mallkimi**. Gyleni, nëpërmjet mallkimit që u drejtonte atyre që nuk e njihnin autoritetin e tij, frikësonte jo vetëm përkrahësit e tij, duke synuar t'i lidhte më shumë me veten, por edhe anën shpirtërore të bashkëbiseduesve të tij. Gyleni, në një mallkim që shpreh kundrejt shtresave muslimane, me të cilat ishte nexhur, shpreh të njëjtat fjalë mallkuese që përdor Hz. Pejgamberi ndaj idhujtarëve. Të shprehësh ndaj muslimanëve mallkimet që Hz. Pejgamberi dhe sahabet

e tij i shprehën ndaj idhujtarëve në ditët më të vështira, nuk mund të përputhet dhe të harmonizohet kurrë me parimet fetare.

h. Një fushë tjetër që Gyleni e keqpërdor dhe e shfrytëzon është **fetvaja**. Duke përfutur nga fakti që përkrahësit e tij e pranonin si autoritet fetar absolut, Gyleni, me qëllim që të mundësojë vijimin e pandërprerë të vartësisë së tyre ndaj organizatës, duke larguar nga burimi dhe qëllimi disa dispozita që përfshihen në kulturën e jurisprudencës islame, i ka shndërruar ato në mjet kërcënimi. Fetvatë e dhëna me qëllim që të mos ndahen nga organizata, që të pranojnë postin e emëruar, të kryejnë detyrat e përcaktuara ndaj xhemaatit, të martohen me njerëzit e përcaktuar, të sigurojnë vazhdimisht kontribut material, të përçojnë dijet e përfutur drejt personave të quajtur "imam", "vëlla i madh", "motër e madhe", të premtojnë mbi divorc për këtë veprim dhe të vënë në funksion format e tjera të betimit të rëndë; sipas sistemit dhe rregullave të organizatës, këtu mund të citohen si shembull fetvatë e dhëna me qëllim që të dënojnë veprimet e quajtura krim.

Madje, adhurimet themelore të konsideruara si simbol i Islamit, ose kanë ndryshuar formë, ose janë boshatisur në kuadër të qëllimit të organizatës, ose janë tjetërsuar. Për shembull, për namazin, i cili falet pesë herë në ditë dhe që duhet të falet në formën e njohur, janë dhënë fetvatë, sipas të cilave mund të falet bashkërisht, në një kohë të përshtatshme, se mund të falet me nënkuptim, pra me zemër, ose mund të bëhet kaza; po ashtu, edhe se agjërimi i Ramazanit mund të mbahet në një kohë të përshtatshme jashtë këtij muaji.

Në këtë situatë nuk ka mbetur asnjë vlerë që kjo organizatë nuk e ka cenuar, nuk e ka keqpërdorur. Bëhet fjalë për një 'tjetërsim dhe keqpërdorim të metodave'. Ajetet e Kur'anit, në veçanti tregimet në Kur'an, janë komentuar sipas synimit dhe misionit të përcaktuar; është vënë në funksionim një eklekticizëm mjaft i dobishëm i privuar nga "drejtpeshimi mendor dhe harmonia gjykimore" në fushën e hadithit dhe sjerit; në këtë mënyrë, ngaqë të gjitha gabimet, në një mënyrë, janë bazuar te Kur'ani dhe Sunneti, vullneti është zhdukur.

Si përfundim, nuk ka dyshim se Gyleni, konceptet dhe vlerat fetare, organizatën, të cilën ai e orientoi dhe e drejtoi, e ka përdorur si një pengesë dhe mjet për të fshehur synimet jofetare, por edhe si një mjet ose aparat që i orientonte përkrahësit drejt vartësisë absolute.



FETO/PDY ËSHTË NJË LËVIZJE FORCE DHE INTERESI, QË VEPRON NËN PETKUN E FESË

4. Të formosh një strukturë botërore, politike dhe ekonomike, duke e shndërruar në rrjet force dhe interesi veprimtarinë arsimore, të gjitha këto nën petkun e fesë, të vendosësh perde mbi çdo lloj marrëdhënieje të fshehtë dhe të pistë, nuk mund të përputhet në asnjë mënyrë me parimet themelore të Islamit. Nga ana tjetër, të përfitosh interesa apo të krijosh autoritet bazuar te feja, nuk ka asnjë lloj baze fetare.

Dëshmia e mjaft personave që janë gjendur pranë organizatës së Gylenit prej fillimeve të saj, që kanë marrë arsimim të veçantë për këtë, që kanë përvetësuar doktrinën e saj, që kanë marrë mbi vete misionin e saj dhe që janë gjendur për shumë vite në shërbim dhe brenda kësaj strukture, japin të dhëna të spikatura mbi personalitetin e Gylenit dhe marrëdhëniet e posaçme të mbyllura ndaj publikut. Seancat e ëndrrave të stisura, metodat e ndikimit global të planifikuara, kanë bërë që vartësit të përjetojnë kënaqësi dhe eksperiencë shpirtërore virtuale. Kështu, duke mashtruar vartësit e tij, ai forcoi autoritetin shpirtëror kundrejt tyre, forcoi besimin dhe faktin e të qenit i pagabueshëm, si ndaj një personaliteti të shenjtë. U dobësuan aftësitë e mendimit të lirë dhe të vlerësimit racional të atyre që ishin brenda organizatës, madje këto aftësi u verbuan.

Lideri i organizatës, me respektin që fitoi mbi fenë në etapën e parë të lëvizjes, së pari shtiu në dorë një forcë shpirtërore. Organizata, duke devijuar objektivin në rrugë të fesë, bindjen dhe nënshtrimin që duhet t'i drejtohet Allahut, e tregoi ndaj liderëve që flisnin nën petkun e fesë. Nga ana tjetër, organizata, e cila jepte një pamje "astike, të një jetese modeste", pas hapjes së qendrave të kurseve dhe në veçanti të shkollave jashtë shtetit, si nga të pasurit, ashtu edhe nga përfitimet dhe avantazhet shtetërore, korri forca materiale të pafund.

Gyleni, i cili që nga vitet e rinisë ka qëndruar gjoja i distancuar nga politika, kontaktin e tij me politikën e ka vënë në funksion sipas një 'boshti dobiprurës' dhe 'vije allishverishesh', duke synuar sigurimin e forcës dhe të interesit të vazhdueshëm. Kështu, hap pas hapi ka ndjekur strategjinë e 'të qenit i aftë dhe autoritar pa u zgjedhur'. Ai, duke fshehur qëllimin

e vërtetë, ka marrë mbështetje nga persona autoritarë, drejtues që ishin në rend të parë dhe, me kalimin e viteve, ka shtuar forcën e tij.

Sasi shumë të mëdha parash, të marra nën emrin e himmetit (para të dhëna për bamirësi) nga biznesmenë të dërguar në shtete të ndryshme me anë të shkollave, e kanë shndërruar organizatën plotësisht në një lëvizje interesprurëse. Mori në zotërim kompani të mëdha tregtare ndërkombëtare dhe banka. Aq sa kur këto banka ishin me humbje, me urdhrin e liderit të organizatës, përkrahësit e tij kanë investuar çdo gjë që kanë pasur pikërisht në këto banka. Ndërkohë që në fillim ishte “një lëvizje shërbimi”, që nga vitet nëntëdhjetë u shndërrua në një “lëvizje himmeti (para e dhënë për bamirësi)”, për shkak se këto ndihma korreshin me detyrim, dredhi, intriga, montazhe, shantazhe dhe metoda presioni. Ndërsa himmeti u shndërrua në një sistem haraçi. Me anë të bursave, kurbanëve dhe himmeteve të tjerë u mblodhën sasi astronomike parash. Autoritetin që fitoi në burokraci, në forcat policore, politike, ekonomi dhe akademi, e ka përdorur me sa ka pasur mundësi për të qenë si qendër force. Esnafët dhe biznesmenët, që panë forcën e organizatës në media, arsim, financë, në forcat policore dhe në gjykim, filluan të japin rryshfete të fshehta nën emrin e “himmetit”. Përsëri, shkurtimet e rrogave dhe transferimi i tyre (rroga e parë transferohej në total duke u quajtur si e drejta e ‘hoxhaefendiut’) formonin burimet themelore financiare.

Sidomos pasi Gyleni shkoi në SHBA, organizata e shtoi edhe më shumë forcën në arenën ndërkombëtare. Tashmë filloi të realizojë veprimtari të ngjashme jo vetëm në Turqi, por edhe në shtetet turke dhe në ato afrikane. Pa dyshim që mbështetja sistematike e forcave globale është e qartë në objektivin e zgjerimit të kësaj organizate. Bashkëpunimet dhe misionet që mori mbi vete në botën e re, hapën rrugë për “përfitim force dhe autoriteti” të liderit të organizatës dhe të pjesëtarët e saj. Aq sa lideri në fjalë tentoi të organizojë qeveritë, partitë politike, hierarkinë në ushtri dhe në forcat policore, madje edhe ekuilibrat në media.



FETO/PDY ËSHTË NJË LËVIZJE E RREME SHPËTIMTARE (MEHDIU)

5. Gjatë gjithë historisë janë shfaqur mjaft lëvizje fitneje dhe përçarjeje, me karakter shpëtimtar (mehdiu-mesih), të cilat kanë kërcënuar sigurinë e shoqërisë dhe kanë pasur karakter të fshehtë. Sekretit, misterit, kushtimit, demonstrimi i personalitetit karizmatik dhe personaliteti i dyfishtë janë bërë veçoritë më spikatëse të kësaj lëvizjeje. Ndërsa në periudhat moderne, lëvizje të tilla, nën drejtimin e inxhinierive politike ndërkombëtare, janë përdorur si një mjet i copëtimit dhe i shfrytëzimit të shoqërive islame.

Ndër shtrembërimet që bëri Gyleni në çështjen e autoritetit fetar, njëra prej tyre, ndër më të rëndësishmet, është çështja e shpëtimtarit (mehdi dhe mesih). Edhe pse vetë ai nuk e thotë haptazi, te vartësit është formuar një perceptim i tillë, por edhe ai ka mbyllur sytë përballë formimit të këtij perceptimi. Nuk i ka refuzuar ëndrrat që ka parë në lidhje me këtë temë a çështje dhe me thashethemet e përhapura mes përkrahësve, pothuajse ka dhënë kontribut që të rrënjoset ky perceptim në mënyrë të vetëdijshme. Vartësit, me sa kuptohet nga perceptimet dhe shpjegimet në lidhje me Gylenin, e shohin atë si mehdiu dhe mesihu i pritur. Si rrjedhim, një gjykatës pjesëtar i organizatës, pak ditë para tentativës për puç, ka shkruar madje edhe në vendimin gjyqësor se Gyleni është mehdi. Ky besim është përdorur si një mjet tjetër për vartësinë ndaj liderit dhe shenjtërimit të tij. Besimi i mehdiut është shndërruar në një ideologji që ka gjakosur shtetin tonë me dorën e kësaj organizate.

Në shoqëritë ku mësimdhënia e fesë nuk jepet me metoda të sakta e të drejta, por nëpërmjet objekteve mistike, të cilat janë dominuese, këto lloj pretendimesh ekzoterike dhe mistike i ndikojnë shumë lehtë njerëzit. Në qëndrimin e theksuar mbi konceptet mehdi, mesih dhe veli brenda organizatës, shtrihet dëshira e Gylenit për të krijuar perceptimin në mendjen e vartësve të tij që vetë ai është "autoritet absolut". Me këtë metodë i bën më të pranueshme pretendimet se takohet vazhdimisht me Hz. Pejgamberin në ëndrra dhe jashtë ëndrrave. Kështu e bën më të lehtë që ata të pranojnë fjalët dhe sjelljet e tij, si një njeri i zgjedhur nga Allahu dhe që pasqyron vullnetin e Allahut.

Në Kur'an, si burimi kryesor i fesë Islame, nuk gjendet një argument i qartë që tregon se në të ardhmen do të vijë një shpëtimtar. Në ajetet që citohen si argument për ardhjen e mehdiut (shpëtimtarit) (*Ra'd, 13/7; Enbija, 21/105; Saff, 61/9*) nuk gjendet ndonjë shprehje e qartë që tregon se në të ardhmen do të dërgohet një shpëtimtar. Ndërkohë, transmetimet në lidhje me mehdiun nuk gjenden te veprat Sahih të Buhariut dhe Muslimit, por citohen në disa vepra të tjera të literaturës së hadithit. Megjithëse një pjesë e këtyre transmetimeve, brenda të cilave ka mjaft kontradikta, janë sahih ose hasen në pikëpamje të dedikimit, shumica janë vlerësuar si transmetime të dobëta (dajif). Fakti që transmetime të tilla nuk mund të pranohen si bazë në çështjet e besimit, është shprehur qartësisht nga dijetarët. Krahas kësaj, ndërsa shumica e dijetarëve sunnitë të apologjetikës në periudhën e parë, nuk e kanë cituar çështjen e mehdiut, në periudhat e mëpasshme, kur janë numëruar shenjat e kiametit, është trajtuar çështja e mehdiut me disa fjali, por është theksuar se kjo nuk është një çështje besimi (*Taftazani, Sherhu'l-Makasid, Stamboll 1305, II, 307*).

Siç dihet, Allahu e ka plotësuar fenë (*Maide, 5/3*) dhe Hz. Pejgamberi ka lënë Kur'anin e Sunnetin si trashëgimi. Si rrjedhojë, një musliman, duke u sjellë indiferent ndaj përgjegjësiëve që i ngarkon njeriut Kur'ani dhe Sunneti, nuk mund të shpëtojë nga përgjegjësia e eliminimit të fitnes dhe përçarjes duke ia tejkualuar atë mehdiut, mesihut ose "cilindo personi të mbrojtur dhe që bën vepra të mira". Përkundrazi, sa i përket kësaj çështjeje, çdo njeri është përgjegjës për kryerjen e asaj që i përket. Të gjithë muslimanët që plotësojnë besimin dhe përgjegjësitë ashtu siç duhet, në vend që të presin mehdiun, duhet të mundohen të plotësojnë personalisht detyrat që u bien mbi vete në kohën dhe vendin ku jetojnë. Sepse Allahu i Lartmadhëruar i jep njeriut veçse këmbimin e punës së tij (*Nexhm, 53/39*). Përsëri Krijuesi i Lartë, premton se do të bëjë zotërues force në sipërfaqen e tokës vetëm ata që lidhen me zemër me Allahun dhe që bëjnë vepra të mira kundrejt botës dhe ahiretit (*Nur, 24/55*).

Gyleni, duke e tejkualuar cakun edhe më tej, në mjedise ku gjendeshin shumë njerëz, ka mbajtur fjalime, nëpërmjet të cilave nënkuptonte se vetë ai është Mesihu Isa. Për shembull, ai është munduar ta veshë veten me identitet të shenjtë duke thënë se Mesihu Isa do të shfaqet në Izmir, se Izmiri zotëron veçorinë "*belde-i tajjibe (vend i bukur)*" (*Sebe, 34/15*), se Mesihu Isa kishte tri veçori të rëndësishme, se njëra prej këtyre është të qenit vaiz (ligjërues fetar), përveç kësaj, se Mesihu nuk do të zbrësë nga qielli, përkundrazi, se do të



vijë nga nëna dhe babai, se ai do të flasë bukur, se edhe ai flet bukur, madje duke thënë se Mesihu Isa do të shkojë e do të vijë në Izmir vazhdimisht.

Krahas perceptimit të të qenit mehdi dhe mesih, një kriter tjetër misterioz që shihet herë pas here në organizatë është cilësia e **hurufizmit** (qasjeve që u atribuojnë shkronjave kuptime të veçanta) **dhe xhifiri** (shkenca e lajmërimit mbi të ardhmen, duke vlerësuar shkronja, numra dhe metoda të ndryshme). Organizata, duke parashtruar pretendime të tilla si misteri i shkronjave dhe duke nxjerrë data të ndryshme nga disa shprehje të teksteve të shenjta, ka shprehur parashikime në lidhje me të ardhmen dhe i ka mashtruar përkrahësit duke i bërë që t'i besojnë këto. Ndërkohë që gajbi, i cili ka kuptimin e gjërave që nuk mund të njihen dhe të perceptohen me shqisa, është një fushë, të cilën mund ta dijë vetëm Allahu (*En'am, 6/59; Junus, 10/20; Neml, 27/65*). Përveç pejgamberëve që u jepen të dhëna nga Allahu, askush nuk mund të japë informacione në lidhje me të ardhmen (*Al-u Imran, 3/179; Xhin, 72/26*). Të pretendosh se po mëson anën e brendshme të ngjarjeve duke u orientuar ndaj çdo lloj falli, parashikimi fati dhe metoda të tjera besëtyte, ose të thuash me gjuhë të prerë se ç'do të ndodhë në të ardhmen, është një veprim që bie në kundërshtim me Islamin. T'u vësh veshin atyre që pretendojnë se zotërojnë dije të fshehta dhe japin lajm nga gajbi, si dhe t'i miratosh ato, kjo nuk përputhet me besimin. Edhe shkenca xhefr (xhifir), e cila pretendon se jep të informacione mbi të ardhmen, duke u bazuar në një besim, sipas të cilit shkronjat dhe numrat mbartin sekrete të veçanta, është një metodë e pabazë dhe besëtyte.

Në këtë kuadër spikat komenti që i jep Gyleni shprehjes: *"Idha xha'e nasrullahi ue'l-fet'h - Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi"*, si ajeti i parë i sures Nasr: "Nga pikëpamja e rregullave sintaksore, te fjala orientuese plotësori hiqet dhe në vend të saj vjen 'lami' në krye të fjalës, si shtesë përcaktimi. Si rrjedhojë, fjala "ue'l-fet'h" do të thotë **ue fet'hullahi**. Për sa i përket sarkazmës këtu, krijimi ynë nga ana e Allahut, orientimi në udhën e shërbimit, drejtimi i zemrës së popullit ndaj nesh... të gjitha këto bëhen me anë të ndihmës dhe të mirësisë së Allahut. Shumë njerëz e vënë re se kjo është kështu dhe në çdo rast e përmendin dhe e tregojnë si domosdoshmëri të mendimit mbi teuhid dhe njëjësi." (*M. Fetullah Gülen, Fasıldan Fasıldan-2, Botimet Nil, Izmir 1995, f. 184*).

Me sa kuptohet, Gyleni nuk ka ndryshuar përshtypjet se është mehdi dhe/ose mesih, përshtypje këto të mbështetura qoftë nëpërmjet nënkuptimesh e shenjash, qoftë edhe

nëpërmjet perceptimeve dhe tregimeve të përkrahësve që kishte përreth. Përkundrazi, ai ka zgjedhur të përfitojë nga përshtypje të tilla të gabuara. Duke i mbështetur këto mentalitete të tilla edhe nëpërmjet qasjes së hurufizmit dhe llogaritjeve të shkencës së xhifirit, ka forcuar edhe më shumë autoritetin mbi përkrahësit e tij. Ta paraqesësh veten si mehdi dhe mesih duke keqpërdorur perceptimet dhe ndjenjat e njerëzve, ose të qëndrosh indiferent dhe i heshtur ndaj një konsiderimi të tillë, nuk është gjë tjetër veçse një falsifikim dhe mashtrim i qartë.



LITERATURA FETARE E FETO/ PDY ËSHTË E DYSHIMTË

6. Në të ashtuquajtura klishe fetare të kësaj strukture dhe organizate, më shumë se literatura themelore e Islamit, kanë pasur përparësi ëndrrat dhe tregimet misterioze. Nëpërmjet tyre janë mashtruar dhe magjepsur masat e pafajshme dhe kështu është formuar një mendësi e sëmurë. Me këtë synim dhe qëllim, në veçanti duke u përdorur media, nëpërmjet bisedave, ligjëratave fetare dhe konferencave, është treguar një orvatje për tjetërsimin dhe prishjen e fesë. Pretendohet se në këto ligjëratat dhe biseda ka marrë pjesë Hz. Pejgamberi, urdhëresat dhe kërkesat që u janë dhënë përkrahësve janë munduar të bazohen po ashtu te Hz. Pejgamberi nëpërmjet ëndrrave. Nuk është e mundur që një strukturë, e cila pranon si metodë vendosjen e autoritetit të saj, duke i mashtruar njerëzit në këtë mënyrë, të gëzojë lejen e fesë.

Burimi themelor i fesë sonë është libri i Allahut dhe Sunneti i Hz. Pejgamberit, i cili ua shpalli këtë libër njerëzve. Përveç këtyre, perceptimi se Allahu ka komunikim të veçantë me disa njerëz, se edhe frymëzimi dhe ëndrrat e këtyre personave të veçantë janë burim dispozitash, para së gjithash bie në kundërshtim me deklaratën se Allahu e ka plotësuar fenë (Maide, 5/3). Si rrjedhojë, kur Hz. Aliu pyetet nëse tek ehli bejti (familja e Pejgamberit) gjendeshin të dhëna të tjera që Rasulullahu nuk ua kishte thënë të tjerëve, përgjigjet duke thënë "Jo! Tek ne nuk ka asgjë tjetër të veçantë, përveç aftësisë për të perceptuar se Allahu ka dhënë për t'u kuptuar Kur'anin" (*Ebu Dau'ud, Dijat, 11; Ahmed b. Hanbel, I, 79*). Bashkë me vdekjen e Hz. Pejgamberit ka përfunduar edhe thirrja hyjnore, ka filluar periudha e ixtihadit (arsyetimit juridik). Ndërsa dispozitat që nxorën në pah muxhtehidët (ideatorët juridikë) dhe dijetarët e fikhut, me metodat e analogjisë dhe metoda të tjera të nxjerrjes së dispozitave, mund të jenë të sakta, por mund të jenë edhe të gabuara. Edhe dispozitat që nxjerrin në pah dijetarët e apologjetikës islame me anë të metodave të arsyetimit dhe induksionit, janë të këtij lloji.

Dispozitat e përfituara me rrugë dhe metoda jashtë atyre që lidhen me ëndrrat frymëzimin, kerametin dhe istiharen (kërkimit të më të mirës), duke mos qenë të formës së prerë, nuk janë as të vlefshme. Si rrjedhojë, respektimi i këtyre të dhënave të përfituara me këto metoda, në qoftë se bie në kundërshtim me dispozitat e prera të fesë, është i ndaluar fetarisht. Nga kjo pikëpamje, është bërë e ditur qartësisht nga dijetarët e shkencës së tasavvufit se ata që respektojnë pikëpamjet e gabuara të një personi, për të cilin mendojnë se zotëron cilësinë e zbulimit, nga pikëpamja fetare do të konsiderohen gjynahqarë (*Imam Rabbani, Mektubat, v. I, 31, Letra*). Ata që nisen me këtë mendim në fakt nuk janë në dijeni se kanë nxjerrë një fe tjetër brenda fesë. Dijetarët e Islamit, të cilët e parashikuan një rrezik të tillë, kanë bërë të qartë se frymëzimi nuk mund të jetë burim në fe. Molla Gurani ka theksuar se pranimi si burim në fe i atyre që thonë personat që pretendojnë se marrin frymëzim është një bidat i madh, se kjo nënkupton përpjekjen për të formuar një fe të re pas Hz. Pejgamberit, se kundërshtimi i këtyre mentaliteteve është detyrë për çdo musliman (*Molla Gurani, ed-Dureru'l-leuami, Bejrut 2007, f. 565*).

Ngaqë askush, përveç pejgamberëve, nuk e zotëron cilësinë e të të mbrojturit/pagabueshmërisë, vlefshmëria e mendimeve dhe komentimeve që parashirojnë personat është e lidhur me të qenit e tyre në përshtatje me Kur'anin dhe Sunnetin. Në traditën islame, kjo përputhje është kontrolluar nga shkenca e Kelamit (apologjetikës islame) dhe Fikhut (jurisprudencës islame). Sipas kësaj, autoriteti i vetëm fetar në kuptimin absolut i përket Allahut; pejgamberët u shpallin njerëzve vahjin që marrin nga Allahu. Pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, tashmë nuk ka mbetur autoritet absolut apo burim dijeje dhe informacioni i ardhur nga Allahu. Qoftë nëse është dijetar, murshid ose muxhtehid, askush nuk është larg të qenit i gabueshëm, pra askush nuk është i pagabueshëm. Thëniet e tyre përbëhen nga kuptimi dhe komentimi i dy burimeve të fesë. Ndërsa është pranuar me unanimitet se komentimet nuk janë pretendim i një të vërtete absolute. Personat që orientojnë jetët e njerëzve mbeten në kuadrin e legjitimitetit në masën që respektojnë kriteret e dijes. Duke u dukur si veli, mehdi, murshid ose hoxhë, ata që mundohen të formojnë autoritet mbi njerëzit me metoda si kerameti (demonstrimi i gjendjeve të jashtëzakonshme), ëndrra, frymëzimi dhe metoda të ngjashme, pa respektuar kriterin e dijes, nuk mund të përcaktojnë dispozita në emër të Islamit. Gjithsesi, e vërteta ku bashkohen të gjithë dijetarët e fesë islame është fakti që rregullat fetare mund të merren



vetëm nga dijetarët, se nuk mund të vërtetohet një dispozitë fetare me anë të frymëzimit, ëndrrës, keshfit (zbulimit) dhe metodave të ngjashme.

Ndërsa njëra prej metodave që përdoren shpesh në orientimin e punonjësve dhe të njerëzve përreth nga organizata, janë **ëndrrat** e para, ose të cilat pretendohen se janë parë. Në ëndrrat në fjalë, thuhet se shihet veçanërisht Hz. Pejgamberi dhe jepet një urdhëresë konkrete. Formula e ëndrrës përdoret shpesh duke filluar që nga falja e tokës e deri te ndërtimi i shkollës, nga shkrimi i mesazheve në twitter e deri te dhënia e votës.

Gyleni, megjithëse thotë se ëndrrat nuk janë argument në fe dhe se nuk mund të veprohet me ëndrra, si ëndrrat e tij, ashtu edhe të përkrahësve të tij i ka përdorur si një argument, nëpërmjet tyre ka realizuar qëllimet që ka dëshiruar. Ky qëndrim i tij, me kalimin e kohës ka fituar një përmasë orientuese dhe mesazhdhënëse ndaj vartësve, duke u nisur nga ëndrrat.

Gyleni deklaron se “Në ëndrrat e drejta dhe të sakta ka mesazhe të mbushura me frymëzim dhe irshad (udhëzim në fe). Prandaj, mjaft zbulime janë përfituar nëpërmjet ëndrrave dhe shumë prej tyre janë bërë shkak për përcaktimin e kaderit të individëve e të popujve. Ëndrra, në çështjet e lejuara, me kusht që të mbetet te personi që e sheh, duhet të pranohet se gjithmonë ka një funksion orientues.” Në vijim të këtyre fjalëve, edhe pse është shprehur se duhet të merret si bazë Kur’ani dhe Sunneti, nuk mund të thuhet se në praktikë e respekton këtë.

Po ashtu, njësoj si ëndrrat që bien në kundërshtim me Kur’anin dhe Sunnetin nuk kanë asnjë vlerë, edhe ëndrrat që nuk bien në kundërshtim me ta nuk kanë një kushtëzueshmëri. Madje sado që pretendohet se në ëndërr është parë Hz. Pejgamberi dhe se janë dhënë mesazhe të caktuara, kjo nuk mbart asnjë vlerë dispozite. Aq më tepër që shumica e ëndrrave janë pamje subjektive, të cilat shfaqen në botën tonë shpirtërore dhe mendore si rezultat i faktorëve të jashtëm në gjendje gjumi. Nga ana tjetër, tregimi i një ëndrre të paparë nga personi, ashtu sikur e ka parë atë, është cilësuar nga Hz. Pejgamberi si **“Më e madhja e gënjeshtrove”** (Buhari, Tabir, 45; Ahmed b. Hanbel, II, 96, 119). Edhe **keshif dhe keramet** (gjendjet e jashtëzakonshme që paraqesin njerëz të quajtur velinj/evlija), të cilat organizata i përdor për ndikimin e vartësve, nuk kanë vlefshmëri në fe.

Gyleni ka formuar një 'teologji' të pakontrolluar, që shmang thëniet dhe veprimet nga kontrolli i të dhënave të sakta fetare. Ka kërkuar, sipas tij, një legjitimitet brenda eksperiencës së shkencave islame, si tefsiri, hadithi, sijeri dhe fikhu dhe e ka gjetur atë; ndërsa në ndonjë rast të veçantë, kur kjo nuk është e mundur, duke nënkuptuar Hizrin dhe Mesihun, edhe pse duket se bie në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunnetin, ka shfaqur mendimin se është 'hikmet (urtësi)' dhe 'miratim hyjnor'. Ky kult i formuar mbi personalitetin e Gylenit, me përkufizimin e tij ka ngarkuar edhe një krenari kolektive ndaj 'lëvizjes që i ka shembujt në vetvete'. Personi, i cili me çdo veprim që bën besohet se përfaqëson vullnetin e Allahut në sipërfaqen e tokës, në udhërrëfimin e një prijësi të përzgjedhur si një orientim hyjnor dhe që besohet se përfaqëson 'projektin e së ardhmes', ka arritur të shohë legjitime çdo gjë, duke përfshirë edhe tentativën për puç.

Si rezultat, kritere të tilla si keshifi, kerameti, ëndrra dhe të tjera, nuk kanë një kushtëzueshmëri fetare për individin dhe shoqërinë dhe nuk mund të vendoset ndonjë dispozitë mbi këta (*shih Neseфи, Tebsiratu'l-Edille, I, 22-24; Teftazani, Sherhu'l-akaid, f. 72-74; Ibn Haldun, Shifau's-sail, f. 61-69; Yazır, Hak Dini Kur'an Dili (Feja e vërtetë, gjuha e Kur'anit), VI, 4259-4260; Talat Sakalli, Rüya ve Hadis Rivayeti (Ëndrra dhe transmetimi i hadithit), Spartë 1994).*



FETO/PDY ËSHTË NJË LËVIZJE PËRÇARËSE QË COPËTON UNITETIN E UMMETIT

7. Në shoqërinë Islame medh'hebet e ndryshme, mënyrat e sjelljeve në jetë dhe ekolet e mendimeve janë bashkuar në një formë të harmonizuar dhe kanë formuar një pasuri të madhe. Mirëpo, ngaqë Islami ka si thelbësore unitetin e muslimanëve, është ndaluar çdo lloj përçarjeje dhe grupimi që copëton e përçan uahdetin, pra unitetin. Një strukturë si FETO/PDY, e cila duke monopolizuar realitetin, i përjashton të gjitha, përveç vetes, nuk mund të përputhet me traditën islame. Si rrjedhojë, asnjë strukturë, mendim dhe lëvizje, e cila merr për bazë përçarjen e ummetit islam, nuk mund të pranohet.

Organizata, e cila në punimet ndërfitare sillej mjaft me tolerancë ndaj jomuslimanëve dhe që krijon marrëdhënie të afërta me ta, ndaj muslimanëve që nuk janë prej tyre paraqet një qëndrim më se të ftohtë, përjashtues dhe tjetërsues. Përkundër cilësimit të cituar në ajetin 29 të sures Fetih, u mbajt një qëndrim që mund të përmbledhet në formën "i rreptë ndaj besimtarëve, i mëshirshëm ndaj mohuesve". Dialogun që krijoi me jomuslimanët e ka privuar nga grupet muslimane dhe gjithmonë ka qëndruar i distancuar prej tyre. Madje ka përçmuar grupet islame në mënyrë që të mos përputhen kurrë me ligjin vëllazëror, ndërsa herë pas here ka mbajtur qëndrim për t'i shtypur ata me dredhi e kurthe, si dhe për të bërë që ata të heshtin. Të gjitha këto ndodhin në një kohë që, në mjaft ajete, Allahu i Madhëruar e ka ndaluar që t'i braktisim besimtarët dhe të bëjmë miq jomuslimanët, apo e thënë më hapur, armiqtë e Allahut (*Al-u Imran, 3/28; Nisa, 4/139, 144; Maide, 5/51; Mumtehinë, 60/1*).

Ky mentalitet i konfliktuar në organizatë ka fshirë ndjenjën e uahdetit (unitetit) dhe të përkatësisë të nxënësit që kanë edukuar. Të rinjtë që u çuan nëpër shkolla nga familjet e tyre, me qëllim që të marrin arsim fetar, së pari humbën besimin dhe vetëdijen se u përkasin familjeve të tyre, më pas edhe ndjenjën e përkatësisë së shtetit dhe të shoqërisë së tyre, dhe më në fund të ummetit islam. Këta të rinj, të cilët u shpëputën nga përkatësitë më të mëdha, në fund të thirrjeve të bëra janë shndërruar në robër, janë individë të programuar,

duke plotësuar urdhrin e liderit të organizatës. Tashmë për ta nuk ka rëndësi dhe përparësi as familja, as atdheu, por as ummeti islam. Me të tilla situata ata na sjellin në mendje grupet vetëflijuese të grupeve hash'hashite në histori. Ky rezultat përputhet plotësisht me karakteristikat e qendrave të sherrit, të cilësuarat “... *E, kur largohen, përpiqen të bëjnë të këqija në tokë...*” në ajetin 205 të sures Bakara, si një pamje tjetër se si organizata zhduk brezat. Si rrjedhojë, në një ligjëratë të tij të para shumë viteve, duke thënë: “Nëse herë pas here do të bëhet një vetëflijim i tillë për vijueshmërinë e shërbimit, e hedhim veten në këtë zjarr dhe zhdukemi!”, ka arritur që t’i hapë udhë edhe vetëvrasjes.

Gyleni, në një ligjëratë fetare të datës 9 shtator 1977, pasi thotë “Besimtari që i beson Allahut dhe Rasulullahut, qoftë edhe nëse e kundërshton babai, vëllai, xhaxhai, daja ose i afërm, duhet të dijë t’i tejkalojë ata lehtësisht!”, në fakt duke keqpërdorur ajetin 58/22 të sures Muxhadele, i cili flet për qëndrimin që duhet të mbahet ndaj nënave dhe baballarëve mohues, të cilët tregojnë përpjekje ndaj ftesës dhe thirrjes islame, jep këtë mesazh: “Për hir të kësaj kauze nuk do të dëgjosh madje as babanë, as nënën dhe as vëllanë!”

Për pjesëtarët e kësaj organizate, e cila tashmë është kuptuar mjaft mirë që drejtohet nga një “mendje e lartë”, gati për t’u përdorur ndaj Islamit dhe muslimanëve, e cila fokusohet vetëm tek objektivat e treguara, tashmë as uahdeti, as ummeti dhe as populli nuk kanë vlerë. Në emër të realizimit të objektivave të veta, kjo organizatë ka treguar me një eksperiencë dhe zbatim të hidhur natën e 15 korrikut se mund të vrasë qindra, madje mijëra muslimanë. Cilidoqftë objektivi dhe pretendimi i saj, struktura në fjalë, si masha e forcave të errëta, e cila nuk shmanget nga drejtimi i armës ndaj vëllezërve muslimanë, ndaj shtetasve të tij, që nuk i shmanget luftës ndaj popullit të tij, me këtë qëndrim ka treguar qartësisht se është një formacion që copëton teuhidin, që është në fokus të fitnes dhe përçarjes.

Ndërkohë që Islami, i cili është një fe teuhidi, urdhëron uahdetin, pra unitetin e muslimanëve, cilido qoftë medh’hebi apo përkatësia e tyre. Dallimet në pikëpamje të besimit, të jurisprudencës apo të misticizmit të muslimanëve, me kusht që të mbeten brenda boshtit të teuhidit, tregojnë për pasurinë ideore dhe shkencore që gjendet në shoqërinë islame. Sepse shoqëria islame është një dhe e tërë me të gjitha ekolet e



mendimit. Për këtë arsye, këto dallime që shihen në traditën islame nuk janë parë si një dallim, por si “një mjet mëshire për ummetin”.

Islami refuzon rreptësisht çdo lloj përçarjeje, grupim dhe dallim që synon ndarjen dhe përçarjen e strukturës shoqërore. Asnjë mendim dhe lëvizje, e cila merr për bazë copëtimin e ummetit islam në aspektin fetar, që zotëron krenarinë e xhemaatit dhe narcizmin dhe që me këto veçori përçmon grupet e tjera muslimane, nuk mund të pranohet si e pagabueshme. Një strukturë, e cila përjashton gjithçka përveç vetes, duke krijuar monopol ndaj së vërtetës, nuk mund të ketë një bazë dhe mbështetje islame.

FETO/PDY ËSHTË NJË LËVIZJE MISTERIOZE, E CILA NUK KA MORAL NË VETVETE

8. Është më se e qartë që strukturat dhe organizimet, të cilat aktivizohen në mënyrë të fshehtë në fushë të fesë, po ashtu që janë të mbyllura ndaj kontrollit dhe inspektimit dhe që, në veçanti, nuk janë transparente në pikëpamjen e burimeve financiare, ndaj tyre do të ngrihet çdo lloj dyshimi dhe do të kenë marrëdhënie të errëta në vetvete. Në këtë pikë, politika dhe strategjia që ndjek një lëvizje, e cila mundohet të sigurojë legjitimitet duke prodhuar argumentet fetare sipas vetes, nuk ka asnjë bazë të fortë dhe të saktë. Si rrjedhojë, kjo strukturë i ka përdorur njerëzit në kuadër të synimeve të saj duke keqpërdorur ndjenjat e tyre në lidhje me Islamin.

Shpallja hyjnore islame është e qartë dhe e hapur. Nuk mund të pranojmë fshehtësinë si një metodë shpalljeje. Të pranosh fshehtësinë e shpalljes në ditët e para të periudhës së Mekës nga Hz. Pejgamberi, si një legjitimitet për takijen (dyfytirësi) e aktiviteteve ilegale që bëhen në shoqëritë muslimane dhe, si rrjedhojë, si legjitimitet i takijes, të zhvillosh një strategji shpalljeje mbi këtë, është e gabuar.

Kushti më themelor i shpalljes në Islam është të jesh i drejtë dhe i besueshëm. Por kjo strukturë e ka ndërtuar strategjinë mbi gënjeshtrenë dhe mashtrimin. Fakti që një organizatë, e cila keqpërdor ndjenjat fetare të njerëzve duke bërë mjet Hz. Pejgamberin për qëllimet e ulëta të saj, mund të shihet si e tillë që mashtron masën me anë të Pejgamberit. Gyleni, duke u nisur nga pretendimet se i janë dhënë informacione të veçanta dhe të fshehta, ka vendosur një mbulesë ndaj punëve të fshehta që karakterizojnë organizatën, madje ka shkuar aq larg sa të thotë se “lëvizjen më të madhe të heshtjes e ka formuar Pejgamberi”. Në të vërtetë, duke përfshirë edhe periudhën e Mekës, nuk është e mundur që Hz. Pejgamberi të ketë fshehur nga disa muslimanë një pjesë të të dhënave fetare.

Njëri prej parimeve, të cilit organizata i kushton më shumë rëndësi, është fshehtësia. Lëvizja, e cila zotëron strukturimin e fshehtë në planin horizontal dhe vertikal, duke i kushtuar rëndësi fshehtësisë në aspektin e strukturës së organizatës, si dhe duke



mundësuar që me emra të koduar pjesëtarët të fshehin identitetin, bëhet shkak që ata të duken ndryshe. Krahas këtij parimi, i cili brenda organizatës emërohet si “tedbir” (masë paraprake), si strategji themelore e saj është përvetësuar edhe synimi, sipas të cilit “duhet të jemi në çdo vend”, duke u infiltruar në vendet kritike, sidomos në institucionet shtetërore.

Organizata ka një ngjashmëri të madhe me organizatën me karakter të fshehtë, që është nën kryesinë e Hasan Sabbahut (v. 518/1124), të quajtur “Hash’hashitë” dhe që kanë origjinë ismailite. Në burimet e historisë tregohet se Sabbahu i ka shndërruar në vartës personat që ka nën urdhra, duke u dhënë hashash, se ka mundësuar që këta persona të bëjnë ç’të duan duke iu premtuar xhennetin dhe se i ka përdorur ata për të zhdukur kundërshtarët politikë. Këta njerëz, të quajtur “sakrifikues, vetëflijues”, për shkak të besimeve të tyre të theksuara në lidhje me ‘shfaqjen e mehdiut’, realizonin aktivitete të frikshme. Duke përfshirë edhe komplotet që organizuan, të gjitha punët i cilësonin si të shenjta. Zhduknin një nga një politikanët dhe dijetarët që i shihnin si pengesë për kauzën e tyre të lartë. Hasan Sabbahu, i cili ishte në krye të tyre, ndryshe nga sa supozohet, nuk është një ëndërrimtar, por një person, i cili duket i kujdesshëm në respektimin e rregullave ligjore. Aq sa transmetohet se ka urdhëruar vrasjen e të birit ngaqë ka pirë alkool. Me një drejtim të disiplinuar, me dije fetare dhe karizëm personale, zotëronte një aftësi që të merrte pas vetes masa të gjera. Ai, bashkë me organizatën vetëflijuese në fjalë, ka paralizuar për pak kohë funksionimin e shtetit selçuk, ka bërë të mundur që nëpunësit e shtetit të bënin çdo gjë që donte ai, nën presionin e kërcënimeve dhe kanosjeve, ndërsa ata që nuk zbatonin urdhrat, lireshin jashtë funksionit me metoda të ndryshme. (*Shihni Abdülkerim Özeydin, “Hasan Sabbah”, DÍA, XVI, 347-350; Mustafa Öz, “Hashishije”, DÍA, XVI, 418-419*).

Përveç botës islame, edhe në fetë dhe besimet e tjera ka strukturime të kësaj natyre dhe lëvizja Opus Dei është një ndër shembujt më të ngjashëm. Opus Dei është një strukturim katolik, i njohur edhe nga Papati dhe që ka kuptimin “Vepra e Zotit”. Opus Dei është formuar nga fundi i viteve 1920 nga prifti J. Escriva. Opus Dei, i cili në vitet e para e sheh veten si organ lufte ndaj komunizmit, për shkak të identitetit të djathtë, në periudhat e mëpastajme është shndërruar në një organizim shumë të madh terrori, përmasat e të cilave nuk mund të përcaktohen. Escriva, me synimin fetar për t’i shërbyer papatit, ofron mundësi shumë të mira ekonomike për fëmijët e varfër dhe të zgjuar, duke i infiltruar më pas në strukturat shtetërore dhe qeveritare. “Të punosh duke përdorur mundësitë dhe institucionet

shtetërore” është bërë një strategji e pashmangshme për Opus Dein. Bëhet e ditur se kjo lëvizje përvetëson filozofinë “çdo rrugë që të çon në objektin” është e lejuar, prandaj edhe anon ndaj aktiviteteve ilegale. Pikërisht për këtë arsye, kjo organizatë përmendet shpesh si “mafie me doreza të bardha”. Aktualisht zotëron 15 universitete në shtete të ndryshme, qindra shkolla në nivelin fillor dhe të mesëm. Escriva i ka bindur ata që ka përreth se është ‘Padre’, që në Krishterim ka kuptimin ‘Baba’ dhe është shprehur se ka marrë shenjë nga Zoti për formimin e këtij rrethi. Struktura hierarkike e Opus Deit, e cila frymëzohej nga masonizmi, për nga fshehtësia që e karakterizon, në shumë aspekte ngjan me strukturën në fjalë.

Mund të themi se strukturimi i organizatës së Gylenit zotëron karakter “të dyfishtë”, në formë paralele, në aspektin gjuhësor dhe ideor të liderit dhe organizatës. Kjo strukturë e dyfishtë mund të cilësohet si rrjetë transparente dhe e fshehtë. Rrjetet transparente përbëhen nga struktura legale që zhvillojnë aktivitete edukative-arsimore, që kanë një mbështetje nga shoqëria civile dhe organizata profesionale, nga ndërmarrje tregtare vendase dhe ndërkombëtare, nga organet e medias dhe të shtypit. Shihet se në rrjetat e fshehta dominon një strukturë e ashpër hierarkike. Ngaqë këto rrjeta janë formuar me qëllim “infiltrimin në shtet”, fshehtësia është një parim i pashmangshëm. Burokracia civile, gjykata, forcat e armatosura dhe ushtria janë qarqe të ndryshëm që përfshin ky rrjet i fshehtë. Në këto rrjete ku zbatohen teknikat e shpëlarjes së trurit, përtej të qenit të Gylenit një lider mendimtar dhe ideor, del në plan të parë identiteti i tij si mehdi-mesih dhe skenari ekzoterik rreth këtij besimi. Nga ky aspekt, organizata, përtej të qenit një “strukturë” që ofron shërbim, merr një formë sistematike, ku qarqe të ndryshëm rrotullohen rreth njëri-tjetrit.

Në rrjetet e fshehta zbatohen praktikata e takijes në formë të ngarkuar, lehtësohen “brejtjet e mundshme të ndërgjegjes” me anë të disa profesorëve që janë të ngarkuar me detyrë në këta rrjete dhe, në këtë mënyrë, personat orientohen ndaj të ashtuquajturave “objektiva të lartë”, duke e mbajtur motivimin në nivelin më të ngritur. Nga ana tjetër, rrjetet transparente, përkundër kësaj situatë, e konsiderojnë si prestigj që të mund të identifikohen haptazi me pjesëmarrjen dhe të qenit aktiv në këtë lëvizje. Madje kjo situatë ushtron një presion shpirtëror mbi shtresat që nuk kanë ende kontakt me Gylenin, duke krijuar idenë, “njësor si te të tjerët”, se duhet të njihen patjetër me njerëz “të përsosur” dhe se duhet të



kenë bashkëpunim. Pikërisht në këtë pikë, krahas “rrjeteve të përkatësisë” shihet se ka formuar vetvetiu edhe “rrjetin e simpatizantëve”. Nga personat që merren brenda këtyre rrjeteve mundohet që, në emër të organizatës, të ketë përfitime maksimale nga organizatat dhe ndërmarrjet. Mbledhjet e Abantit, organizimet prestigjioze të ngjashme me Olimpiadat e Turqishtes, ushqenin rrjetin e simpatizantëve dhe ishin organizime të rëndësishme që e fuqizonin këtë rrjet.

Ndërkohë, për orientimin e gjithë këtij organizimi, është e qartë se janë përdorur teknologjitë e komunikimit. Organizata zotëron mjaft profesionistë në këtë çështje. Kjo veçori e rrit edhe më shumë mundësinë që kjo organizatë të ketë sukses në punët dhe veprat e veta mafioze.

FETO/PDY ËSHTË NJË LËVIZJE JOMORALE

9. Metoda të tilla si fshehja e vetes, të dukurit ndryshe nga ç'je, sjellja e dyfishtë, të folurit me gjuhë të dyfishtë, mosrespektimi i asaj që lejohet dhe i asaj që ndalohet për shkak të takijes, përdorimi i emrave të koduar dhe të shifruar, të jetuarit ndryshe në mjedisin ku personi jeton, në kundërshtim me ato që beson, thënia e gënjeshtreve, veprimtaria përgjuese, cenimi i privatësisë, kërcënimi, përkrahja, solidariteti organizativ për synime të këqija, janë metoda joislame dhe jomorale.

Ndërsa njëra prej taktikave themelore që zbaton organizata, ndërkohë që kryen vepra dhe punë jolegjitime, është të bëjë **takije** në emër të **marrjes së masave** deri në arritjen e objektivave. Takija, e cila ka kuptimin 'të shprehësh besimin më ndryshe nga ajo që është', 'të bësh apo të thuash diçka që nuk e beson me zemër', është një kriter që refuzohet nga dijetarët e Ehlul-Sunnetit.

Organizata, që shfaqet sikur është Ehlul's-Sunnet, orientohet drejt mënyrave jomorale, si mashtrimi, gënjeshtria, shpifja, dredhia dhe vjedhja, duke zbatuar mentalitetin e takijes. Pjesëtarët e organizatës, të cilët i fshehin gjithmonë qëllimet e tyre, e kanë konsideruar si të lejuar çdo gjë për të arritur objektivat e vet, kanë përvetësuar një mentalitet kontradiktor që nuk përputhet me fenë islame. Ndërkohë, njëra prej veçorive më të rëndësishme morale të një muslimani është të jetë i besueshëm. Si rrjedhojë, fjala "besimtar", krahas kuptimit "besues dhe miratues", ka edhe kuptimin "person që fal besim". Ndërsa shembulli më i bukur mbi këtë çështje është ai që, në shoqërinë ku jeton, përmendet si "Muhammedu'l-Emin" dhe që, as armiq të më të egër të tij nuk shfaqin qoftë edhe dyshimin më të vogël në pikëpamje të besueshmërisë si Zotëria i Gjithësisë.

Organizata, e cila tregon kujdes që të mos ketë kontradikta me të tjerë përveç muslimanëve, nuk ka treguar të njëjtin kujdes ndaj muslimanëve. Organizata, e cila pothuajse ka hyrë në një luftë të shenjtë me personat dhe institucionet që i ka përcaktuar si armiq, duke shtrembëruar hadithin "*Lufta është dredhi*" (Buhari, *Xhihad*, 157; Muslim, *Fiten*, 75-78), e ka parë si të arsyeshme të përdorë edhe instrumente jomorale. Ndërkohë, në Islam është



e ndaluar që një musliman të mashtrrojë dikë tjetër (*Ahmed b. Hanbel, IX, 122-123*) dhe dhënia e informacioneve të gabuara apo të gënjyerit, janë lejuar vetëm kur është fjala për një taktikë strategjike kundrejt armikut, pra në kohë lufte (*Neueui, Muslim Sherhi, XII, 45*). Duhet të theksojmë, pra, se lejimi në fjalë është i vlefshëm në gjendjen e luftës dhe kundrejt armikut. Përndryshe, nuk është e lejuar që muslimanët të bëjnë dredhi ndaj njëritjetrit dhe ndaj shoqërisë brenda së cilës jetojnë.

FETO/PDY, PËR HIR TË OBJEKTIVIT TË SAJ, KA CENUAR TË DREJTËN E INDIVIDIT DHE TË PUBLIKUT

10. Të kryesh korrupsion të natyrave të ndryshme dhe veprime të paligjshme për të vendosur pjesëtarët e strukturës në kuadro dhe për të shtënë në dorë shtetin, duke filluar nga vjedhja e pyetjeve (të provimeve), do të thotë të cenosh të drejtën e individit dhe të publikut. Një strukturë dhe organizatë, e cila e ka shndërruar në mjetin më themelor një strukturim të tillë, nuk mund të pranohet si strukturë islame. Ata që janë lider të saj, që ndihmojnë në rrugëtimin e saj dhe që mbyllin sytë ndaj saj, nuk janë të ndërgjegjshëm moralisht apo fetarisht.

Duke vepruar në emër të realizimit të synimeve të liderit të organizatës, të shërbimit dhe të kauzës, mangësia themelore e atyre që shtypin çka feja e ndalon në mënyrë të hapur dhe që e bëjnë këtë në emër të fesë, është të mos zotërojnë një mentalitet të shëndoshë fetar. Kjo lëvizje, e cila në fillim u shfaq nën emrin e shërbimit ndaj fesë, për shkak të qëndrimit të përvetësuar në pikën ku mbërriti, u bë shkak për shfaqjen e një perceptimi fetar të larguar nga rregullat themelore fetare. Ndërkohë, të pranosh të ndaluarën si të lejuar, e nxjerr njeriun nga feja, ndërsa të kryesh haram, e bën atë gjynahqar (*Taftazani, Sherhu'l-Akaid, Stamboll 1308, 190*). Të gjitha këto qëndrime janë si rezultat i devijimit nga konceptimi i fesë së drejtë. Përballë deklaratës së personit që mendojnë se ka një kontakt të veçantë me Allahun, ata që nuk shohin pengesë në kryerjen e haremeve, në një kuptim tregojnë edhe se struktura përvetëson një qëndrim mbi takije. Një person, i cili në një transmetim të hapur për publikun, thotë se nuk është i lejuar përdorimi i ujit dhe i energjisë elektrike në mënyrë të paligjshme, se ata që bëjnë këtë veprim duhet të kërkojnë falje një më një prej 60 milionë personave, nuk mund të kuptohet që të miratojë vjedhjen e së ardhmes të brezave tanë, nuk mund të kuptohet që të përdorë metoda të ndaluara dhe jomorale për të shtënë në dorë institucionet shtetërore, nuk mund të kuptohet që me vjedhjen e pyetjeve të provimeve, nuk do të vjedhin vetëm potencialin e mundshëm njerëzor.



Pjesëtarët e organizatës, qoftë nëse janë edukuar brenda saj ose jo, kanë përdorur armët e “shpifjes” dhe “komplotit” ndaj personave që nuk tregojnë nënshtrim të plotë dhe që i shohin të kontradiktuar me interesat e tyre, ndërsa këto imoralitete i kanë konsideruar të lejuara, si domosdoshmëri e vijimit të këtyre imoraliteteve ose të gjoja shërbimeve të tyre. Përveç kësaj, duke shtënë në dorë të dhëna dhe pamje nga jeta private e personave, kanë bërë montazhe të ndryshme dhe i kanë përdorur si mjet shantazhi. Në këtë mënyrë janë krijuar mjaft shtypje me veprime ilegale, si shkarkimi nga detyra i njerëzve të pafajshëm, burgosja e tyre etj., kështu janë bërë shkak që mjaft persona, të cilët dëshironin t'i pengonin ose që nuk janë pjesëtarë të organizatës (ose që janë ndarë nga organizata) të humbin punën, karrierën, respektin, lirinë, madje edhe jetën. Këto sjellje të jomoralshme nuk kanë asnjë lidhje të largët apo të afërt me fenë islame. Të hedhësh baltë mbi njerëzit e pafajshëm me shpifje dhe ta përdorësh këtë si një shkallare për të arritur objektivat personale, është ndër gjynahet e mëdha dhe sulmet që janë ndaluar qartësisht në Kur'an (*Nur, 24/15-19; Nisa, 4/112; Ahzab, 33/58*).

Feja islame ka ndaluar edhe cenimin e jetës private; në rast se nuk respektohet ky parim, ka parashikuar një sërë sanksionesh të rënda shpirtërore. Në këtë kuadër, jetesa shpirtërore, privatësia e mjedisit dhe bisedat e veçanta përfshihen brenda konceptit të jetës private. Në Kur'an, ndaj besimtarëve urdhërohet: “...*mos hetoni mangësitë dhe privatësitë e njëri-tjetrit...*” (*Huxhurat, 49/12*). Dijetarët kanë bërë të ditur se në përfshirjen e konceptit “tëxhessus (përgjim)”, që citohet në tekstin e ajetit, mund të hyjë çdo lloj informacioni personal dhe privat, duke përfshirë edhe veprimet e turpshme (*Maturidi, Teuilat, IX, 336*).

Edhe Hz. Pejgamberi, me hadithin: “*O ju që besoni me gjuhë, por që nuk keni besim në zemra! Mos i torturoni muslimanët dhe mos hetoni anët e fshehta të tyre! Allahu nxjerr në pah anët e fshehta të atij që heton anën e fshehtë të vëllait të tij musliman; Allahu, kujtdo i shfaq anën e fshehtë e poshtëron atë edhe nëse është brenda shtëpisë së tij*” (*Tirmidhi, Bir, 85*), pra, nëpërmjet këtij hadithi, është shprehur se përgjimi nuk ka vend në Islam dhe se nuk mund të mbetet pa dënim ai që përgjon (*Buhari, Ruja, 45; Tirmidhi, Libas, 19*).

Pjesëtarët e organizatës në fjalë, që nga fillimi, në emër të të qenit i parapërgatitur, kanë paraqitur një qëndrim mjaft dinak dhe të fshehtë. As nuk janë dukur ashtu siç ishin dhe as ishin ashtu siç u dukën. Në veçanti kanë vepruar me një identitet ndryshe në pozicionet strategjike të burokracisë dhe për vite të tëra kanë arritur ta fshehin veten. Në këtë kuadër, qëndrimet që nxjerrin në pah synimin dhe qëllimin e vërtetë janë konsideruar si tradhti, humbje dhe mashtrim brenda organizatës.

Sjellja e dyfishtë në thëniet dhe veprimet dyzetvjeçare të Gylenit, përmasa e të folurit në një gjuhë të dyfishtë, janë aq të mëdha, sa vetëm në këtë kriter është botuar një vepër më vete me titullin “Njeriu i kontradiktave” dhe janë cituar pothuajse të gjitha kontradiktat e Gylenit mbi çdo çështje.

Për shembull, ndërkohë kur në Turqi thoshte se “nuk kishin asnjë lidhje me misticizmin”, kur ishin në Perëndim, në veçanti kur u hapën drejt SHBA-së, kur panë atje respektin ndaj ‘misticizmit’ dhe ndaj Mevlanës, veprën në anglisht të “Kodrat e zemrës prej rubini”, e botuan me titullin “Sufism in Islam (Sufizmi/Misticizmi në Islam), më pas themeluan edhe Forumin e Mevlanës.

Gyleni, ndërkohë që në Turqi dhe në shoqëritë e tjera muslimane ka përdorur shpesh motivin e Hz. Pejgamberit, në kuadër të punimeve për dialog kriterin e Pejgamberit e ka nxjerrë nga Fjala e Teuhidit.

Gyleni, duke i kushtuar moderim lëvizjes Risale-i Nur, për t’i dedikuar asaj një idealizëm të saktë dhe puritan, që në krye të udhës pajis me flamur Ebu Dherin; të gjitha taktikat që ka përdorur për ‘fitimin e potencialit njerëzor’ gjatë kohës kur u rrit organizata, kanë hyrë në drejtimin e legjitimitetit mbi sahabet e tjera.

Kjo situatë e kontradiktuar është një shembull tjetër i qëndrimit të dyfishtë të vëzhguar në mjaft aktivitete nga organizata Gylen. Ndërkohë kur ai vinte theksin mbi modernizmin, postislamizmin dhe dialogun kur i drejtohej publikut të Perëndimit, kur u drejtohej shtesave vendase laike-moderne, qëndrimet fetare tradicionale ishin kundrejt ngopjes së ndjenjave shpirtërore të përkrahësve fetarë dhe publikut të përgjithshëm musliman. Në të vërtetë, çdonjëri prej shkrimeve që marrin për bazë metodat dhe burimet e ndryshme, ku mund të shohim kontradiktën që shfaqet në organet mediatike të organizatës, njerëzit pjesëtarë të



të njëjtit rreth përgatiten dhe regjistrohen. Herë pas here, për shembull një fjalim që mbajti në SHBA dhe një fjalim që mbajti në Turqi i njëjti pjesëtar organizate, mund të kishin brendi krejt të ndryshme nga njëri-tjetri. Në veprat dhe botimet periodike të botuara në Turqi në emër të organizatës, ndërkohë që jepet imazhi sikur merren për bazë konceptimi dhe komentimet islame të popullit tonë, në veçanti në aktivitetet jashtë shtetit ka paraqitur qëndrime dhe mentalitete të ndryshme. Është më se e qartë se pas këtij qëndrimi dyshues, i vetmi motivim është pragmatizmi.

Situata në fjalë, duke u paraprirë sidomos strukturave neo-selefite, ka krijuar një mundësi të pashoqe për strategjistët perëndimorë që formojnë një dallgë islamofobe në përmasë globale. Me këtë mënyrë ka penguar zhvillimin, organizimin dhe aktivitetet politike të muslimanëve. Këto forca globale, të cilat e paraqesin para botës në përgjithësi si një alternativë efektive kundrejt grupeve terroriste, që zakonisht i kontrollon ata, që ndihmojnë në përhapjen, organizimin, hapjen e institucioneve arsimore dhe institucionalizimin e tyre, dëshirojnë që të mbajnë nën kontroll qendrën e Islamit, për të vendosur mbi shtyllën kryesore strukturën “Islame” që nuk i dëmton dhe, madje, edhe të përdorshme. Nga kjo pikëpamje organizata Gylen nuk ka asnjë dyshim se duke pasur si synim “shndërrimin e Islamit dhe kontrollimin e muslimanëve”, në anën e jashtme është kthyer në një projekt global.

Veprimet e përgjakshme të organizatës kanë treguar se koncepti “tolerancë”, të cilin nuk e hoqën nga gjuha për dhjetëra vite, dhe etiketa “Islam i moderuar”, përbëhet nga një maskë që mbulon qëllimet e errëta. Allahu urdhëron kështu në lidhje me foletë e përçarjes: *“Kur u thuhet: ‘Mos bëni çrregullime në tokë!’ ata thonë: ‘Ne bëjmë vetëm përmirësime në tokë!’ Por jo! Në të vërtetë, pikërisht ata janë shkaktarët e çrregullimeve, ndonëse nuk e ndiejnë.”* (Bakara, 2/11-12)

FETO-PDY, ZEKATIN, SADAKANË DHE BAMIRËSINË, SI TË DREJTA TË TË VARFËRVE, I KA SHNDËRRUAR NË HARAÇ, NËN EMRIN E HIMMETIT

11. Adhurimet që duhet të bëhen për Allahun nuk mund të keqpërdoren për qëllime të ndryshme. Kurrë nuk mund të shihet si legjitim themelimi i një kanali televiziv me paratë e zekatit dhe të kurbanit; po ashtu, nuk mund të shihet dhe konsiderohet legjitime as të bësh aktivitete mediatike apo lobingu dhe t'i transferosh këto para në fushatat zgjedhore në shtete të ndryshme.

Ndërkohë është formuar edhe gjoja një "jurisprudencë" e takijes, që organizata e përdor shpesh në çdo fushë. Në këtë kuadër, dihet nga të gjithë se prej kohëve të hershme, me metoda të ndryshme, herë pas here me pëlqimin e pjesëtarëve dhe të simpatizantëve, herë të tjera edhe me presion të inspektimit financiar, si shantazh apo rrugë të tjera, korri në ardhura materiale nën emrin e "himmetit". Krahas marrjes së zekatit, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, me kërcënim dhe me presion, harxhimi i tij në vende ku nuk ekziston e drejta është ndër ankesat kryesore. Zekatet e mbledhura nuk janë harxhuar në vendet e përcaktuara në Kur'an, por në një mënyrë jashtë rregullave, në kuadër të qëllimeve të organizatës, në programet televizive, aktivitetet e lobingut në shtetet e tjera dhe në fushatat zgjedhore, në punët e përfaqësimit-mikpritjes, në aktivitetet sociale dhe kulturore, janë përdorur për harxhime si shkrimi i veprave dhe artikujve shkencorë në favor të Gylenit dhe organizatës, për shpenzimet e pronës ku banon Gyleni si dhe për rrogat e imamëve të pjesëtarëve të organizatës. Por, në mënyrë që zekati të jetë i vlefshëm, është e domosdoshme që të harxhohet ndaj shtresave që citohen në ajetin 60 të sures Teube dhe nuk është e lejuar që të harxhohet në vende të tjera (*Ibn Abidin, Reddu'l-muhtar, Rijad 2003, III, 291 etj.*)

Paratë e mbledhura për adhurimin e kurbanit janë përdorur për qëllime të tjera, sadakatë e mbledhura në emër të të varfërve dhe jetimëve, përsëri janë harxhuar për qëllime të organizatës, shumica e bursave të dhëna për nxënësit nuk kanë arritur në destinacion. Si



një shembull tipik i shtrembërimit të fesë, sipas një praktike të vënë re për herë të parë në këtë organizatë, duke u mbledhur para nga shumë persona, gjoja prisnin kurban për Hz. Pejgamberin, kështu sigurohej një mbështetje materiale për organizatën. Ndërkohë që në traditën e jurisprudencës nuk ka një adhurim tjetër në formën “prerja e kurbanit në emër të Hz. Pejgamberit”. Si rrjedhojë, të shikosh si adhurim një zbatim të tillë, që nuk transmetohet nga Allahu dhe i Dërguari i tij, është bidat, madje edhe devijim nga rruga e drejtë (*Muslim, Xhuma, 44; Ebu Dau'ud, Sunnet, 6; Tirmidhi, Mukaddime, 16*). Prerja e kurbanit në emër të Hz. Pejgamberit si domosdoshmëri e trashëgimisë së tij nuk mund të jetë argument për këtë zbatim (*Ebu Dau'ud, Dahaja, 2; Musned, I, 107, 149*).

Në këtë kuadër, është dhënë fetva nga organizata se pjesëtarët që gjendeshin në detyra kritike mund të konsumonin pije alkoolike, mund të përfshiheshin në dëfrime që fetarisht konsideroheshin jolegjitime, që mund të vallëzonin me persona që ishin të huaj për ta, se mund të mos respektonin dispozitat e mbulesës, të cilat Islami i konsideron të nevojshme. Përsëri pjesëtarët e organizatës, të cilët ishin ndër kuadrot kritike të organizatës, mund të hiqnin mbulesat e bashkëshorteve të tyre, gjë që bie në kundërshtim me ixhmanë (mendimin e njëzëshëm) e ummetit dhe asnjëri prej imamëve muxhtehid nuk e pranon këtë.

Si rezultat, në tefsir, hadith, jurisprudencë, në sijer dhe në historinë islame, shkurtimisht në fushën e të gjitha shkencave islame, FETO shfaqet kundrejt nesh si një formacion eklektik, i fokusuar mbi përfitimin e dobisë dhe i pabazë. Nëse është e drejtë të thuhet kështu, çdo gjë në interes të organizatës, është përdorur me mjeshtëri. Në formë të përmbledhur, për të përfituar ‘legjitimitet’ ndaj pozicionit të saj, ka pasur dhe do të ketë gjithmonë persona që do të mundohen “t’i shndërrojnë në mjete” vlerat dhe dispozitat. Edhe organizata Gylen është një shembull i kësaj, dhe jo shembull i vetëm. Masat parandaluese (tedbir) të nevojshme përballë çdo lloj formacioni që kryen veprime të tilla, që keqpërdor fenë islame për qëllime dashakeqëse dhe të poshtra, duhet të merren në kohë.

FETO/PDY ËSHTË NJË LËVIZJE QË BËN ROLIN E INXHINIERISË SË FESË NË EMËR TË DIALOGUT NDËRFETAR DHE QË PËRÇAN FJALËN E TEUHIDIT

12. FETO-PDY, për të siguruar interesin dhe mbështetjen e publikut perëndimor, në emër të krijimit të ndjeshmërisë kundrejt tezës së konfliktit të qytetërimeve, ka nisur dhe ndërmarrë nisma të dyshimta bashkë me shprehjet 'dialog ndërfetar' dhe 'Islam i moderuar', dhe është bërë pjesë e projekteve të errëta që përgatiteshin kundër muslimanëve në një botë ndërkombëtare mjaft misterioze dhe me marrëdhënie të fshehta. Nuk ka dyshim se feja e vërtetë pranë Allahut është Islami. Thelbësore është të jetojmë në paqe me pjesëtarët e feve të tjera, pa cenuar liritë fetare; po ashtu, është i mundur solidariteti dhe mbështetja e ndërsjellë në një bazë të përbashkët, për një punë që do të jetë e dobishme për njerëzimin. Si rrjedhojë, një teologji fetare e përbashkët, ose përpjekja për të formuar një unitet kulturor fetar, e cila kuptohet se është një inxhinieri politike e caktuar nën emrin e dialogut ndërfetar, nuk mund të miratohet në asnjë lloj mënyre. Të bësh lëshime dhe tolerime mbi kushtet themelore të Islamit, për shembull të jesh indiferent ndaj profetësisë së Hz. Muhammedit (s.a.s.), si pjesa e dytë e fjalës së fjalës së teuhidit, nuk mund të pranohet kurrë.

Njëra prej veprimtarive më interesante që nisi organizata Gylen në vitet nëntëdhjetë, janë punimet e "Dialogut ndërfetar". Edhe pse ky dialog parashtrohet si "bisedimi, diskutimi dhe kërkimi i rrugëve të bashkëpunimit në çështjet e përbashkëta, pa u sforcuar dhe duke mbrojtur të gjitha dallimet, brenda tolerancës dhe mirëkuptimit", në fakt, me kalimin e kohës është kuptuar se i ka shërbyer një qëllimi të fshehtë, për të krijuar marrëdhënie të afërta me kishën dhe Perëndimin, si dhe për të fituar mbështetjen e tyre. Sa i përket kësaj çështjeje, janë argument i mjaftueshëm shprehjet e qarta të Gylenit në letrën që i dorëzoi personalisht Papës, më 9 shkurt 1998: "Gjendemi këtu për të qenë pjesë e misionit



Këshilli i Papatit për Dialog Ndërfetar (PCID), të iniciuar nga ekselencia Pauli VI. Dëshirojmë të shohim që ky mision të arrijë qëllimin e tij. Erdhëm te ju në një gjendje të dobët por me paksa guxim, që të paraqesim ndihmesat tona më modeste, në rrugën e shprehjes së shërbimit tuaj të vyer.”

Në të vërtetë, me projektin e dialogut ndërfetar të bazuar në vendimet e marra në Këshillin II të Vatikanit, Gyleni, duke organizuar disa aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, ndërkohë që nga njëra anë i afronte përkrahësit pranë kulturës së krishterë, nga ana tjetër mundësoi akreditimin e kësaj organizate nga bota perëndimore. Kështu, kur Gyleni gjeti mundësinë e formimit të një baze në Pensilvani, mjaft porta të shteteve perëndimore u hapën ndaj organizatës, duke iu hapur shumë mundësi në të gjithë botën.

Pas punimeve të dialogut që vijoi prej shumë vitesh, fjalët e mëposhtme të Fetullah Gylenit, të cilat i shprehu në një ligjëratë të tij, janë një demonstrim i qartë, që tregon se deri ku ka vijuar ai:

“Nuk mund të konsiderohet si shumë e rrezikshme nëse kryqëzatorët pushtojnë shtetin tuaj. Sepse mes jush dhe atyre ka vija të kuqe të pacenueshme. Së pari, ata nuk afrohen ndaj grave dhe vajzave tuaja. Nuk afrohen ndaj tempullit tuaj.”

Është keqpërdorur ajeti 64 i sures Al-u Imran për t'i dhënë legjitimitet procesit të dialogut, në një formë të vetëdijshme është nxjerrë në plan të parë fjala e teuhidit. Si rrjedhojë, në disa fjalime Gyleni ka përdorur një shprehje në formën “E vë mbi kokë atë që thotë La ilahe il-lallah”, dhe kjo është bërë shkak që të perceptohet nga ndjekësit e tij sikur edhe nëse nuk thuhet pjesa ‘Muhammedun Rasulullah’, mund të arrihet në shpëtim. Është parashtruar absurditeti se është e mjaftueshme të thuhet pjesa e parë e fjalës së teuhidit “La ilahe il-lallah” për të qenë musliman dhe se ata që nuk i besojnë Hz. Muhammedit do të mund të hyjnë në xhennet. Si rrjedhojë, në veprën e shkruar nga një shkrimtar pjesëtar i organizatës, citoen fjalët: “Mirëpo qëllimi i Tij është që së pari të përqafojë me mëshirë dhe dhembshuri të gjithë njerëzit, si dhe të sjellë këtu të gjithë ata që thonë La ilahe il-lallah, duke u shmangur nga shprehja e pjesës së dytë të fjalës së teuhidit. Sepse Ai do të urdhëronte: “Kush thotë La ilahe il-lallah do të hyjë në xhennet.”

Siç dihet, thelbi dhe themeli i fesë Islame është besimi në Allah. Shprehja e këtij parimi dhe kushti i parë i të qenit musliman është të thuash fjalinë e dëshmisë, që ka kuptimin: “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe se Muhammedi (s.a.s.) është robi dhe i dërguari i tij” (*Muslim, Iman, 1*). Ndërsa pjesa “La ilahe il-lallah” e fjalës së teuhidit shpreh teuhidin, pjesa “Muhammedun Rasulullah” shpreh profetësinë e Hz. Pejgamberit dhe të gjitha parimet hyjnore që ai solli nga Allahu. Këto dy pjesë të fjalës së dëshmisë janë pikërisht si Islami dhe besimi, njëri përfshin tjetrin brenda vetes. Aq më tepër, kryesisht në hadithin e Xhibrilit (Buhari, Iman, 37), në mjaft transmetime, bashkë me “La ilahe il-lallah”, citohet edhe shprehja “Muhammedun Rasulullah” (*Buhari, Zekat, 1; Muslim, Iman, 116*).

Në këtë situatë, meqë kushtet janë bërë të volitshme për të injoruar tema të tilla si besimi në Pejgamber, me një qasje interesprurëse, kjo është diçka që nuk përputhet me besimin dhe thirrjen në Islam.



FETO/PDY KA ANGAZHUAR BREZAT NË VENDET E EUROAZISË ME NJË QASJE ISLAME TË PJESSHME

- 13. FETO/PDY, duke filluar kryesisht nga shteti ynë, por edhe në mjaft vende të botës, në veçanti duke përdorur marifetin e hapjes së shkollave në Azi dhe në Afrikë, është shndërruar në prijësen e një klisheje islame të paplotë/të pjesshme, ka shkatërruar shpresat dhe energjitë e muslimanëve që jetojnë në këto zona.**

FETO/PDY, në vitet nëntëdhjetë, pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, në saje të mbështetjes së drejtuesve të shtetit dhe popullit tonë, ka kryer veprimtari duke hapur shkolla me pretendimin se do të mbushin hapësirën boshe të arsimit që u shfaq pas komunizmit në shtetet e Euroazisë dhe me mbartjen e identitetit musliman të Anadollit. FETO/PDY, nën petkun e gjoja realizimit të këtyre qëllimeve, emrin e Islamit dhe të shtetit tonë, të cilin ua vunë shkollave për të marrë pas vetes mbështetjen e shoqërisë dhe qeverisë turke, i përdorën për të arritur në objektivat e tyre të fshehta. Në të vërtetë, nëpërmjet këtyre institucioneve që formoi, u shndërrua në mjetin që përjetëson qëllimet politike të forcave globale. Kështu, organizata ka depërtuar lehtësisht në rrugët e të qenit i zoti i fjalës, për të shtuar burimet financiare dhe të drejtuesve të shteteve.

FETO/PDY, duke u fshehur pas idesë se po ndihmon njerëzit e shtypur të Afrikës, të cilët kishin jetuar nën një kolonizim të rëndë fetar, kulturor dhe ekonomik; duke u fshehur pas idesë se do të përçonte arsimin islam dhe duke përfituar nga ndjenjat fetare të njerëzve bamirës të shtetit tonë, ka mbledhur ndihma në sasi të mëdha, nën emrin e zekatit, sadakasë dhe kurbanit. Në shtetet e Afrikës, ku këta shkuan me gjasë qëllimet në fjalë, Islami ose nuk u është treguar aspak, ose është përçuar një doktrinë islame boshe, e formësuar në kuadër të synimeve të fshehta, që lindën brenda organizatës dhe qëllimeve të fshehta të tyre.

Si përfundim, FETO/PDY, duke mos përçuar një konceptim të drejtë feje ndaj njerëzve që jetonin në vendet e përmendura, jo vetëm që nuk është mjaftuar me zhgënjimin e njerëzve të atyre shteteve, por as atyre që dhanë mbështetje me qëllim të mirë ndaj kësaj organizate, ua ka çuar pritshtëritë dhe shpresat dëm, ka harxhuar energjitë e tyre, duke mbajtur gjallë anën e tyre shpirtërore.

ËSHTË E NEVOJSHME TË KONSTATOHEN DËMET QË FETO/PDY SHKAKTOI NË SHTETET KU GJETI MUNDËSI PËRHAPJEJE

14. Do të konstatohet dëmi që ka shkaktuar organizata terroriste FETO/PDY në Azinë e Mesme, në Ballkan, në Afrikë dhe në Lindjen e Largët, nën emrin e vullnetarëve të arsimit si dhe të hegjemonisë që kanë ndërtuar në këto shtete, duke përdorur fenë islame dhe vlerat e saj. Konstatimet në fjalë do të mblidhen dhe do të ndahen me Kryetarët e Çështjeve Fetare të shteteve që do të marrin pjesë në Këshillin e Konsulencës së Euroazisë në muajin nëntor.

Dihet nga të gjithë se organizata në fjalë, krahas shteteve europiane, si shtetet ballkanike, ku në radhë të parë vjen Shqipëria, shtetet e Afrikës, si Maroku, Xhezairi etj., në veçanti pas shpërbërjes së shteteve sovjetike, ka ushtruar aktivitet efektiv në shtetet e Azisë, si Kirgistani, Kazakistani, Turkmenistani, Tashikistani etj. Për këtë arsye, edhe në Këshillin Konsultativ të Euroazisë, i cili do të zhvillohet pas disa muajsh, do të trajtohen ndikimet negative të organizatës në këtë gjeografi.

Në mbledhjen në fjalë planifikohet të trajtohen tema të tilla si, fakti se si dhe kur organizata ka hyrë në këto zona, si i ka rekrutuar të rinjtë, cila është gjuha dhe klishetë fetare që kanë përdorur, shkollat që kanë hapur dhe aktivitetet e tjera arsimore, botimet fetare vizive, institucionet civile dhe shtetërore ku janë strukturuar, aktivitetet ilegale, këndvështrimi i shtetit dhe popullit ndaj organizatës, ndikimi mbi perceptimin fetar në zonë, dëmi që ka shkaktuar në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe botimet e vlerësimet e publikuara pas tentativës për puç më 15 korrik.



DO TË FORMOHEN KOMISIONE TË PËRBASHKËT PËR TË KONSTATUAR DËMET QË KA SHKAKTUAR FETO/PDY NË JETESËN FETARE

15. Emergjencë përbën edhe realizimi i punimeve shkencore, nga rrethi i Kryesisë së Çështjeve Fetare dhe të Fakulteteve të Teologjisë, i cili analizon aktivitetet e keqpërdorimit të fesë nga FETO dhe struktura të ngjashme. Në këtë kuadër, edhe punimet e botimet gjoja shkencore, që lartësojnë organizatën dhe liderin e saj, do të analizohen nga institucionet në fjalë dhe do të vlerësohen në aspektin shkencor.
16. Në trupin e Këshillit të Lartë të Çështjeve Fetare do të formohet një komision i veçantë, me pjesëmarrjen edhe të akademikëve të fushave të ndryshme nga Fakultetet e Teologjisë. Ky komision, së pari do të konstatojë dëmet që ka shkaktuar FETO/PDY ndaj Islamit dhe muslimanëve, shkatërrimet që ka bërë mbi parimet themelore të Islamit, konceptimin e adhurimit dhe parimet e moralit, shtrembërimet në lidhje me konceptet themelore të Islamit dhe të gjitha këto konstatime do t'i përcillen publikut.

Me këtë qëllim do të plotësohen dy punime të ndryshme, njëri afatgjatë dhe tjetri afatshkurtër. Së pari do të formohet një komision i përbërë nga dijetarët e përgjedhur të fushave të ndryshme nga fakultetet e Teologjisë. Në mbledhjet e realizuara me anëtarët e komisionit do të përcaktohet një projekt-program dhe hartë udhërrëfyese urgjente. Anëtarët e komisionit do të analizojnë fillimisht botimet dhe publikimet vizuale të organizatës, do të hedhin me shkrim konstatime dhe analiza të mjaftueshme. Përveç kësaj, do t'i nënshtrohen vlerësimit nga komisioni edhe botime të ndryshme që kanë reklamuar dhe lartësuar këtë organizatë. Edhe në çështjen e llumit informativ në botën e medias dhe në atë virtuale, anëtarët e komisionit do të plotësojnë detyrën që u përket. Punimet që do të bëhen në këtë temë nga anëtarët, do të përcillen ndaj publikut pasi të jenë vlerësuar prej Këshillit të Lartë të Çështjeve Fetare.

Së dyti, pas kësaj përvoje të hidhur, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve të nevojshme, duhet të formojë Qendrën Studimore të Kryesisë së Çështjeve Fetare dhe Akademinë e Kryesisë së Çështjeve Fetare. Në departamentet e ndryshme që do të formohen në këtë kuadër, duke përfshirë detyrat që përcaktohen ligjërisht, në lidhje me formimet fetare, zhvillimet fetare dhe problemet fetare në Turqi dhe jashtë shtetit, duhet të ofrohen projekte të ndryshme ndaj specialistëve të fushave përkatëse dhe rezultatet e fituara duhet t'i përcillen publikut. Ndërsa në Akademinë e Kryesisë së Çështjeve Fetare duhet të zbatohen projekte dhe programe kundrejt formimit kualitativ të myftinjve, ligjëruesve, këshilltarëve, atasheve dhe pjesës tjetër të kuadrit në shërbimin e brendshëm të Kryesisë.



DO TË RISHIKOHET DHE STUDIOHET ÇDO LLOJ KONCEPTI NDAJ MËSIMDHËNIES DHE MËSIMNXËNIES FETARE NË ÇDO NIVEL

- 17. Për të mos krijuar mundësi të mëtejshme, që struktura të tilla të mashtrojnë edhe një herë shoqërinë, duhet të rivlerësohen përsëri politikat e mësimdhënies dhe të mësimnxënies fetare. Në këtë kuadër, duhet, pra, të rishikohet mësimdhënia dhe mësimnxënia fetare.**

Liria e besimit përfshin besimin e individëve ndaj një feje dhe përjetësimin e praktikimitin e këtij besimi në çdo fushë, si individuale, ashtu edhe shoqërore a publike. Një shtet duhet të zotërojë një sistem ligjor që mbron botën individuale të besimit, duke mos lejuar që individit ta ndiejë veten nën presion dhe të orientohet drejt grupeve ku besojnë se mund të zbatojnë besimet e tyre. Duke u nisur nga kjo, liria e besimit duhet të merret nën mbrojtje nga vetë shteti; në kuptimin më të gjerë, informimi fetar dhe mësimdhënia fetare duhet të bëhet në formën e informacioneve të sakta.

Kriteri më efektiv në parandalimin e orientimit ndaj grupeve fetare keqpërdoruese, ka të bëjë me faktin që individët duhet të kenë informacione të sakta dhe të mjaftueshme në fushën fetare. Në mënyrë që të mund të jepet mësimdhënie e saktë fetare në çdo nivel dhe të mund të perceptohen në formë tërësore burimet themelore si Kur’ani dhe Sunneti, duhet të bëhen ndryshimet e nevojshme në sistemin e arsimit.

Ashtu siç shihet, në hulumtimet e realizuara, shkaqet e orientimit ndaj cilitdo prej xhemaateve nuk janë fetare, por psikologjike dhe sociologjike. Si rrjedhojë, persona që japin mësim fetare, si imami, mësuesi në kurset e Kur’anit, mësues të kulturës fetare dhe ligjërues, në mënyrë që të njohin mirë strukturat psikologjike të njerëzve dhe që individët të mos orientohen ndaj grupeve keqpërdoruese, duhet të jenë të pajisur me dije të mjaftueshme ndaj nevojave në lidhje me fenë.

Edukimi i brezave, një ideal që i paraprin stilit të sjelljes së bazuar në parimet themelore që përfshihen në Kur’an dhe sunnet gjatë procesit të mësimdhënies fetare dhe që mund ta shndërrojë këtë në një stil jetese, duhet të jetë synimi kryesor dhe, në këtë kuadër,

programet e arsimit fetar dhe programi mësimor duhet të rishikohen. Po ashtu, duhet të merret si bazë që, para së gjithash, nga niveli i shkollës fillore të mbrohet pastërtia krijimore dhe të jepet një arsim i saktë dhe i fortë. Zhvillimi i personalitetit të fëmijët, dhënia e arsimit të mjaftueshëm në mënyrë që të jenë individë socialë dhe përfitimi i vlerave fetare e kombëtare është parësore. Në vend të ndërtimit të një mendjeje të bazuar në mësimin përmendësh në arsim dhe edukim, duhet t'u jepet rëndësi më shumë metodave që hetojnë dhe studiojnë, që diskutojnë dhe forcojnë aftësitë mendore e ato të gjykimit. Në të njëjtën mënyrë, duhet të përfitohet një këndvështrim që mbron marrëdhënien mes mendjes dhe ndjenjës dhe ekuilibrin mes tyre; as duhet të sakrifikohet ndjenja për hir të mendjes, dhe as mendja për hir të ndjenjës.

Një arsim fetar i bazuar vetëm në mësimin përmendësh, në vend që t'i falë liri individit, do ta zërë rob atë, madje do ta shndërrojë në robot. Sepse kjo metodë ndalon dhe pengon që ai të formojë vlerat e tij dhe të shpëtojë nga robërimi i shqisave dhe rrethit shoqëror. Individit, i cili nuk arrin lirinë në aspektin moral, do të silllet sipas atij personi, i cili ka marrë telekomandën e tij në dorë. Në qasjen e arsimit të bazuar në mësimin përmendësh, informacionet e gatshme të ofruara pranohen si "të drejta absolute të pandryshuara", nuk hetohen, nuk analizohen dhe nuk përfitohen të dhëna të reja, por mjaftohet me këto të dhëna. Të dhënat e arsimit të bazuara në mësimin përmendësh, me stilin imponues, marrin nën presion mendjen e individit dhe e shabllonizojnë.

Pranimi i të dhënave fetare pa hetuar, pa u dhënë kuptim atyre nga një person që kalon nga arsimit fetar, bëhet pengesë që të drejtat fetare të kuptohen plotësisht, që të perceptohen pasuritë dhe funksionet e tyre. Në këtë situatë, nxënësi nuk arrin t'i konkretizojë ato, nuk mund t'i përdorë këto të dhëna në jetë dhe, në fund, do të ketë mosfunksionim sidomos të vlerave të moralit.

Nuk mund të mendohet se Kur'ani, i cili thekson rëndësinë e dijes, shkencës, informacionit, të përdorimit të vazhdueshëm të mendjes, që aludon mbi nevojën e hetimit, që nxit mendimin e vazhdueshëm ndaj qenies dhe ndaj ajeteve të zbritura, që e sheh besimin si një vendim që realizohet me anë të zgjedhjes së lirë të personit, që ndalon çdo lloj shtrëngimi në fe, të miratojë një qasje edukimi të bazuar në mësimin përmendësh, e cila parashikon lidhjen verbërisht ndaj disa të dhënave.



NË MËNYRË QË TË MOS FORMOHEN MË STRUKTURA TË NGJASHME DHE QË TË MOS PËRSËRITEN GABIME TË NGJASHME, DO TË ZHVILLOHEN PUNIME TË PËRBASHKËTA ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

18. Kryesia e Çështjeve Fetare, në veçanti me aftësinë e Këshillit të Lartë të Çështjeve Fetare, bashkë me formacionet civile fetare-sociale, të cilat ofrojnë mbështetje ndaj shërbimit dhe arsimit fetar në Turqi, pa ndërhyrë në lirinë e tyre, duhet të kryejë punime të përbashkëta për të mos u ndarë nga rruga kryesore që ka krijuar qytetërime gjatë gjithë historisë, për të qëndruar larg çdo ndarjeje dhe përçarjeje, për të qenë formacione dhe struktura më transparente dhe të inspektueshme. Përveç kësaj, duhet të formohen këshillat e lartë në trupin e Kryesisë së Çështjeve Fetare për inspektim fetar dhe të dijes, por edhe për udhërrëfim.

Në shtetin tonë, ku ligjet e lirisë fetare dhe të besimit merren nën garanci, ashtu siç gjenden institucione të ndryshme zyrtare për të përballuar nevojën e informimit dhe të udhëzimit të popullit në çdo fushë, ka edhe mjaft Organizata të Shoqërisë Civile që vijojnë aktivitetet në këtë lëmi në aspekte të ndryshme. Institucione si Ministria e Arsimit dhe Kryesia e Çështjeve Fetare, të cilat kanë përgjegjësi ligjore, “rrugën e mesme” që është trashëguar nga shteti dhe populli ynë nga e shkuara deri në ditët e sotme, në mënyrë që ta kalojë në brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, duke qenë larg çdo lloj ekstremiteti dhe devijimi, duhet të ndërtojnë politika të reja arsimit, bashkë me formacione të ndryshme civile që ushtrojnë aktivitet në fushën e arsimit fetar, të formojnë metoda arsimore dhe të zhvillojnë mundësi teknologjike, të organizojnë aktivitete të përbashkëta. Në këtë kuadër, në kongreset, punimet dhe asamblëtë, formacionet zyrtare dhe civile duhet të prodhojnë plan-projekte të përbashkëta dhe t'i vënë në zbatim ato.

Për sa kohë nuk tejkalohet boshti kryesor i Kur'anit e Sunnetit, për sa kohë nuk shkaktohet dëm mbi rrugën kryesore të Islamit, komentimet dhe qasjet e ndryshme që shihen në

aktivitetet fetare dhe diturore, pa dyshim që janë pasuri dhe duhet të kihet respekt ndaj këtyre qasjeve. Mirëpo, nëse konstatohen shembuj të veçantë, si në shtypin e shkruar, ashtu edhe në atë vizual, disa devijime që nuk mund të perceptohen, madje që nuk mund as të komentohen, këta shkaktojnë konfuzion në mendjen e popullit tonë. Ja, pra, me qëllim që të zëvendësohen me informacione të sakta këto thënie dhe klishe të gabuara, që të ndriçohet populli ynë me dije, duhet t'u paraprihet konstatimeve dhe mendimeve të ndryshme të devijuara, të cilat është e pamundur të pranohen; duhet t'u ofrohet një udhërrëfyes i drejtë dhe i besueshëm njerëzve që janë në kërkim të së vërtetës. Prandaj, do të formohet një komision konsultimi i zgjeruar, i cili do të japë mbështetje në aspektin shkencor dhe ideor ndaj Këshillit të Lartë të Çështjeve Fetare.

“Komisioni Konsultativ i Zgjeruar” do të mbështesë punimet e Këshillit të Lartë të Çështjeve Fetare, si organi më i madh vendimmarrës dhe konsultativ i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë, në mënyrë që të mund të plotësojë në një formë më përfshirëse detyrat e tij të përcaktuara në ligj. Komisioni në fjalë do të realizojë plane dhe projekte si brenda, ashtu edhe jashtë shtetit. Në veçanti do të mbushë një hapësirë të rëndësishme në përballimin e problemeve, kërkesave dhe pritshmërive në organizimin vendas dhe në angazhimin nga afër me çështjet fetare rajonale në origjinën e problemeve. Ky komision planifikohet të formohet nga dijetarë dhe mendimtarë, të cilët ende punojnë ose janë pensionistë nga detyra e tyre në Kryesinë e Çështjeve Fetare, nga mësimdhënia fetare në fakultetet e teologjisë, fakultetet e tjera përkatëse, ose nga mësimdhënia tradicionale.

Përveç kësaj, në formimin e kësaj strukture, në zhvillimin dhe në ardhjen e saj në ditët e sotme, është e qartë se të gjitha shtresat e shoqërisë kanë nevojë për një vetëkritikë. Ndërkohë që kërkojmë përgjigjen e pyetjes se si u arrit në këtë pikë, në mënyrë që të mos shfaqen situata të ngjashme, po aq sa falsiteti i Gylenit, duhet të mbahet parasysh se çdo shtresë përkatëse ka neglizhime dhe mangësi. FETO/PDY ka vënë re pritshmëritë e familjeve në lidhje me fëmijët dhe duke marrë nga ata peshën e ‘edukimit’, duke keqpërdorur ndjeshmërinë e shtresës fetare, duke shndërruar në mundësi nevojën për kuadër në burokraci, është rritur dalëngadalë dhe ka përparuar deri në nivelin e ‘egërsisë’ që u pa natën e 15 korrikut. Në pikën e arritur, në rast se sillemi indiferentë ndaj përgjegjësiwe personale, familjare, shkencore, politike dhe shoqërore, do të jetë e vështirë të marrim mësimet e duhura nga përvoja e hidhur që përjetuam.



Për këtë arsye, duke filluar veçanërisht nga Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Rinisë dhe Sporteve, Institucioni i Arsimit të Lartë dhe universitetet, duhet të përpilojnë një plan-program urgjent në çështjen e përfitimit të vlerave fetare dhe kombëtare të rinjtë, në kalimin e tyre në një arsim-educim të shëndetshëm dhe të fortë, por edhe ta zbatojnë këtë plan-program. Në kushtet aktuale, ta ngarkosh faturën e bëmave ndaj grupeve, strukturave dhe, në veçanti ndaj disa personave në gjendjen ifrat (tejkalim të caktuar) dhe tefrit (prapambetjes), drejtpërdrejt mbi fenomenin 'xhemaat', pa e bazuar këtë në të dhëna dhe argumente shkencore, si një veprim ky që përfshin qasje dhe qëndrim të cekët, është një hap më se i rrezikshëm. Në këtë gjendje, të mos pasqyrohet në struktura të tjera diçka e ngjashme me atë që jetuam, është e rëndësishme që formacionet fetare-shoqërore të arrijnë në një transparencë në pikën e mendimeve-programeve-synimeve, por edhe të inspektojnë çështjet që lidhen me procedura financiare. Për këtë duhet të bëhen rregullime ligjore. Përveç kësaj, duhet të mbahen të hapura dhe të zhvillohen komunikimi dhe kanalet e kontaktit mes këtyre strukturave.

Në mënyrë që fusha e shoqërisë civile, me një rehabilitim total, të arrijë në një pozitë ku të jetë transparente, ku mund të japë llogari, në një pozitë të shëndetshme të formuar nga struktura me fushë të caktuar veprimtarie, shteti duhet të vërë menjëherë në zbatim një inspektim gjithëpërfshirës dhe objektiv. Në këtë kuadër, duhet të shmangemi edhe nga zbatimet që i hapin rrugë vartësisë së OJF-ve ndaj shtetit. Sepse kjo situatë, nga një anë ofron mundësinë e infiltrimit dhe të përkrahjes brenda shtetit mbi këta lloj formacionesh nga grupet që kanë agjendë të fshehtë dhe krijon mundësinë e shfaqjes së problemeve të tilla si korrupsioni, nga ana tjetër, njerëzit e zakonshëm i huajëzon ndaj organizatave "civile" të politizuara. Që të dy këto përfundime pengojnë funksionimin dhe zhvillimin e shëndetshëm të shoqërisë civile.

Në institucionet publike, në akademi dhe në të gjitha detyrat e tjera, duhet të vihen në funksion sidomos kritere të tilla si drejtësia, barazia, amaneti, aftësia dhe përshtatshmëria e mjaftueshmëria. Asnjë përkatësi fetare, përkatësi e medh'hebit, burimore, rajonale dhe etnike, përveç këtyre parimeve, nuk duhet të jetë kurrë arsye zgjedhjeje për emërimë në detyrë.

NË SHJETIN TONË DUHET TË VENDUSEN NË NJË BAZË TË SHËNDETSHME MARRËDHËNIET FE-SHJET-SHOQËRI

19. Për shkak se në shtetin tonë, gjatë gjithë historisë së Republikës, në proceset e prapësimit socio-politik të përjetuar ndërmjet fesë-shtetit-shoqërisë, nuk është arritur realizimi i një institucionalizimi të posaçëm dhe në nivel të mjaftueshëm e në mënyrë koherente, strukturat me bosht ushtarak të formuara në hapësirën e krijuar, herë pas here kanë arritur në përmasa që kanë dobësuar jetesën fetare të shoqërisë. Kjo situatë e bën të detyrueshëm ritrajtimin e marrëdhënieve fe-shtet-shoqëri, duke përfshirë edhe ndërtimin e bazës ligjore të nevojshme.

Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, e themeluar më 3 mars 1924, me një konceptim të ri, bashkë me Republikën, ka qenë përgjegjëse vetëm për fushat e besimit, adhurimit dhe të moralit; si një institucion shtetëror që ka drejtuar çështjet fetare, ajo ka ndritur shoqërinë në çështjen e fesë dhe ka drejtuar vendadhurimet. Ndërkaq, është realitet që Kryesia e Çështjeve Fetare, e cila u detyrua të mjaftohet vetëm me dhënien e shërbimit të namazit dhe të xhenazes, në këto periudha nuk ka mundur të japë madje as edukimin themelor fetar. Ndërkohë që kushtet ishin kaq të kufizuara, masat e shoqërisë, të cilat nuk kanë arritur ta përballojnë edukimin dhe shërbimin fetar nga institucione zyrtare dhe të kontrolluara, me kalimin e kohës kanë anuar nga disa formacione, të cilat janë shndërruar në udhërrëfyese të këtyre çështjeve. Kufizimet që vazhduan qoftë në edukimin fetar, qoftë në jetesën fetare, janë bërë shkak që këto formacione dhe veprimtari të zbresin “nëntokë”. Në Turqi, për një kohë të gjatë, nevoja e edukimit fetar dhe e udhërrëfimit ka filluar të përballohet nga këta formacione fetare.

Kryesia e Çështjeve Fetare, e cila është krijuar në të njëjtën kohë me Republikën, që nga vitet pesëdhjetë po bën përpjekje për të mbushur dhe plotësuar hapësirën ekzistente, ndërsa në vitet shtatëdhjetë-tetëdhjetë ka përjetuar zhvillime të rëndësishme në organizimin dhe strukturimin e saj. Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, e cila ka fituar



projektligjin e riorganizimit dhe ristrukturimit më 13 korrik 2010, aktualisht ka mbërritur në një nivel të tillë që të ofrojë shërbime në më shumë se njëqind shtete.

Njëra prej detyrave themelore të Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë, e përcaktuar me ligj, është që të udhëzojë shoqërinë në çështjet e fesë. Misioni thelbësor i Kryesisë, i cili nuk ka ndryshuar, është të prezantojë me të gjithë pasurinë, trashëgiminë rrënjësore që zotëron populli ynë në kuptimin e fesë dhe në pasqyrimin e mesazhit të kësaj trashëgimie në fusha të ndryshme të jetesës, si dhe të punojë për t'i forcuar këto.

Nga ana tjetër, ofrimi i informacioneve fetare ndaj shoqërisë përfshin edhe paraqitjen drejt të jetesës shkencore dhe ideore të Islamit deri në ditën e sotme, si dhe të përvojës fetare që ka kaluar nga brezi në brez, por edhe shmangien nga komentimet individuale dhe të pabaza. Kjo i ngarkon Kryesisë së Çështjeve Fetare një detyrë të dyfishtë: si të prodhojë të dhënat e shëndetshme, por edhe si ta udhëzojë shoqërinë në bazë të këtyre të dhënave. Informacion i saktë do të thotë të luftosh me besëtytshmëritë, gabimet, injorancën, bidatin dhe keqpërdorimet që bëhen në emër të fesë. Ja, pra, në këtë kuadër, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, duke marrë për bazë informacionet e shëndetshme fetare dhe dhënien e informacionit, do të vijojë detyrën e udhërrëfimit dhe të ndriçimit të shoqërisë mbi çështje të prirjeve dhe formimeve të gabuara.

Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, që nga dita kur u themelua, vepron duke respektuar liritë fetare dhe besimin e individëve. Ndërsa pikëpamjet e ndryshme të bazuara në referencat fetare i konsideron si shumëllojshmëri dhe pasuri. Megjithatë, për të penguar keqpërdorimin e fesë islame dhe shfrytëzimin e besimit a të ndjenjave të popullit nga lëvizje e struktura në dukje fetare, për të parandaluar konfliktet e mundshme fetare mes medh'hebeve dhe stileve të mënyrës së jetesës, për të vendosur dhe siguruar unitetin shoqëror, duhet të zgjerohen dhe të forcohen kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore të Kryesisë së Çështjeve Fetare.

DO TË BËHEN PUNIME PËR TË PARANDALUAR DËMET SHPIRTËRORE QË KANË PËSUAR SHTETASIT TANË, SIDOMOS TË RINJTË

20. Për të eliminuar mundësinë e rënies në depresion dhe në qorrssokak shpirtëror të mjaft shtetasve tanë, sidomos të brezave të rinj, si rezultat i këtij sulmi tradhtar që nuk shmanget nga ndotja e fesë dhe e anës shpirtërore, do të kryhen punime të veçanta dhe do të realizohen botime të ndryshme.

Me synimin që miliona të rinj, të cilët gjenden nën kurthin e botës virtuale dhe që janë të hapur ndaj çdo lloj ndikimi ilegal e të dëmshëm, të pajisen me vlera fetare, morale dhe kombëtare, të gjithë institucionet dhe qendrat kompetente, si Ministria e Arsimit, ashtu edhe Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, duhet të hedhin hapa konkretë, duke bërë plan-programe urgjente. Në këtë kuadër, ashtu si me përvojën e Bashkësisë Islame dhe Kryesisë së Çështjeve Fetare në Gjermani (DITIB), duhet të formohen "Forumet Rinore" të lidhura me këto xhami, duhet të edukohen kuadro të mjaftueshme në provinca dhe qyteza, me emrin "Udhëzues Rinorë" dhe, nëpërmjet këtyre udhërrëfyesve, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë duhet të japë mbështetjen e nevojshme në formimin e brezave idealë. Në veçanti duhet të realizojë botime audiovizuale ndaj të rinjve, në kuadër të perceptimit dhe mundësive të kohës.

Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, e cila është një institucion që duhet t'i drejtohet çdo shtrese të shoqërisë, synon ta plotësojë këtë objektiv sidomos nëpërmjet platformës web dhe ndaj botimeve që do të përgatiten për të rinjtë. Duke pasur parasysh kureshtinë, entuziazmin, hobin, fobitë dhe nevojat e të rinjve për dije e kulturë, paraqitja e këtyre projekteve të ndryshme është një nevojë urgjente. Në këtë kuadër, "Projekti i Librarisë së Rinisë", i cili vazhdon të zbatohet ende, do të plotësojë, deri diku, një hapësirë në kuadër të botimeve. Projekti që formohet nga katër seri dhe njëqind libërtha në formën e Besimit, Vetëdijes, Kulturës dhe Biografisë, me të dhënat e drejta dhe koherente, do t'u drejtohet 5-6 milionë të rinjve në periudhën e adoleshencës. Çdonjëri prej libërthave do të përgatitet dhe do të botohet me një cilësi të tillë që të tërheqë vëmendjen e të rinjve qoftë me volumin, gjuhën dhe stilin, po ashtu edhe me botimin, radhitjen, materialet vizuale dhe dizajnimin.





**VENDIMET E KËSHILLIT KONSULTATIV
FETAR TË JASHTËZAKONSHËM**